

ITINERARE KATEKUMENALE PËR JETËN MARTESORE

© 2022 – Amministrazione del Patrimonio della Sede Apostolica
e Libreria Editrice Vaticana – Città del Vaticano – All rights reserved International
Copyright handled by Libreria Editrice Vaticana 00120 Città del Vaticano
Tel. 06.698.45780
E-mail: commerciale.lev@spc.va

ISBN 978-88-266-0757-3
www.vatican.va www.libreriaeditricevaticana.va

DIKASTERI PËR LAIKËT, FAMILJEN DHE JETËN

**ITINERARE
KATEKUMENALE
PËR
JETËN MARTESORE**

Udhëzime baritore për Kishat vendore



LIBRERIA
EDITRICE
VATICANA

PARAQITJE

Nën kujdesin e Komisionit Kombëtar për Laikët, Familjen dhe Jetën të Konferencës Ipeshkvore të Shqipërisë

Dokumenti ITINERARE KATEKUMENALE PËR JETËN MARTESORE të Dikasterit për Laikët, Familjen dhe Jetën, i ofrohet tani edhe Kishës sonë në Shqipëri: barinjve ipeshkvij dhe meshtar, rregulltarëve dhe rregulltareve shoqërues/e besnikë/e dhe të zellshëm/e të udhëtimit të çdo besimtari, katekistëve ungjillëzues të përditshëm të Dashurisë së Hyjit, familjeve të krishtera djep i jetës dhe i çdo thirrjeje, djelmoshave e vajzave dhe të rinjve të korra të bollshme dhe të pjekura tashmë për të cilat Dhembshuria e Krishtit thërret vazhdimisht punëtorë të shenjtë, atyre të rinjve që duan të kremtojnë sakramentin e Martesës dhe në të e me të të jenë gjymtyrë të shenjta dhe shenjtëruese të Trupit të Krishtit që është Kisha.

Në mënyrë të veçantë, këto ITINERARE janë një thirrje për mbarë Bashkësinë e Krishterë për të qenë në shërbim të këtyre të fundit, d.m.th. të atyre të rinjve që, të thirrur për në vokacionin martesor, janë të ftuar nga Zoti për të qenë shenjtër dhe shenjtërues: siç do të kemi mundësi të lexojmë dhe studiojmë më hollësisht në Dokument, propozimi i këtyre itinerareve katekumenale për jetën martesore është të theksohet fakti se martesa e dy të rinjve të krishterë nuk është një çështje private, që ka të bëjë vetëm me ata të dy dhe familjet e tyre, por përkundrazi është një moment kishtar, i cili duhet të jetohej nga të gjitha gjymtyrët e Kishës, është një dhuratë kishtare me të cilën rritet dhe jeton i gjithë Trupi i Krishtit, është pjesë e Historisë së Shëlbimit që aktualizohet në këtu-në dhe tani-në e Kishës dhe shoqërisë sonë: prandaj nevojitet një rrugëtim në të cilin Kisha si Nënë të vihet në udhëtim me të rinjtë drejt dhuratës së sakramentit të Martesës, duke u kushtuar këtyre bijve të saj kohën e duhur të përgatitjes, e cila, në raport me vitet e shumta të martesë që do të jetojnë bashkëshortët, nuk mund të tkurret në pak takime informuese: është një padrejtësi, shkruan qartësisht Papa Françesku në Parathënien e tij.

Dokumenti, si udhëzime baritore për Kishat vendore, mbledh reflektimin që Kisha ka bërë në dy Sinodet mbi familjen dhe në vitet në vijim të ndriçuar nga Nxitja Apostolike *Amoris laetitia*. Duke u nisur nga rrafshet dhe nivelet të ndryshme, duke parë larminë e realiteteve kishtare të pranishme në botë, Dikasteri për Laikët, Familjen dhe Jetën ka përpunuar kështu dokumentin në fjalë i cili ofron:

- UDHËZIME TË PËRGJITHSHME ku vihen në dukje përgjegjësitë e secilit rreth realizimit të këtyre itinerareve

- NJË PROPOZIM KONKRET ku paraqiten në detaje etapat e ndryshme të itinerarit katekumenal

- NJË PËRFUNDIM në të cilin nënvizohet urtësisht se «një itinerar martesor i tipit katekumenal duhet të çmohet si një “mjet baritor” që duhet përdorur me dallim, urti dhe me gjykimin e shëndoshë të nevojshëm, në mënyrë që të përshtatet me fleksibilitet – për sa i përket mënyrave dhe kohëve të zbatimit – me situatat konkrete

të çifteve që kanë përballë dhe mbi bazën e mundësive konkrete të punëtorëve baritorë të Kishës vendore».

Ne ia dorëzojmë këto ITINERARE KATEKUMENALE PËR JETËN MARTESORE secilit anëtar të Kishës sonë vendore, duke i bërë jehonë fjalëve të fundit që do të lexojmë në Dokument: «Sado që ndërmarrja për të nisur një rrugëtim formues kaq afatgjatë mund të duket e porealizueshme, i nxisim Kishat vendore që të kenë guxim dhe të kenë një qëndrim të drejtë feje, duke e ditur se, siç na mëson Jezusi, veprat e Mbretërisë fillojnë gjithmonë si një farë e vogël sinapi, por me kalimin e kohës mund të bëhen një pemë e madhe që ofron strehë dhe mbrojtje për ata që janë në kërkim dhe në nevojë».

Të vetëdijshëm për bollëkun e përmbajtjeve të këtyre itinerareve, ia dorëzojmë ato zellit të të gjithë neve, të gatshëm për t'i dhënë pak nga e gjitha të gjithëve dhe dikujt të gjithën.

PARATHËNIE E ATIT TË SHENJTË FRANÇESKUT

«Kumtimi i krishterë në lidhje me familjen është me të vërtetë një lajm i mirë» (*Amoris laetitia*, 1). Ky pohim i *relatio finalis* së Sinodit të Ipeshkvijve mbi familjen meritonte të hapte Nxitjen Apostolike *Amoris laetitia*. Sepse Kisha, në çdo epokë, është e thirrur të kumtojë rishtas, veçanërisht për të rinjtë, bukurinë dhe bollëkun e hirit që përmban sakramenti i Martesës dhe jeta familjare që buron prej tij. Pesë vjet pas botimit të saj, Viti “Familja *Amoris laetitia*” deshi të rikthejë familjen në qendër, të ftojë për të reflektuar mbi temat e Nxitjes Apostolike dhe të gjallërojë mbarë Kishën në angazhimin e gëzueshëm të ungjillëzimit për familjet dhe me familjet.

Një nga frytet e këtij viti të veçantë janë edhe “Itineraret katekumenale për jetën martesore”, që tani kam kënaqësinë t’ua besoj barinjve, bashkëshortëve dhe të gjithë atyre që punojnë në baritoren familjare. Bëhet fjalë për një mjet baritor të përgatitur nga *Dikasteri për Laikët, Familjen dhe Jetën* si vijim i një treguesi që e kam shprehur vazhdimisht, domethënë «nevojën për një “katekumenat të ri” në përgatitje për martesë»; njëmend, «është urgjente të zbatohet konkretisht çka tashmë është propozuar në *Familiaris consortio* (nr. 66), pra që, ashtu si për pagëzimin e të rriturve, katekumenati është pjesë e procesit sakramental, kështu edhe përgatitja për martesën të bëhet pjesë e pandarë e gjithë procedurës sakramentale të martesës, si një antidot që ndalon shumimin e krentimeve martesore të pavlefshme [të paqena] ose të paqëndrueshme» (*Fjalim drejtuar Rotës Romake*, 21 janar 2017).

U shfaq këtu, në mënyrë të qartë, shqetësimi serioz për faktin se, prej përgatitjes tepër sipërfaqësore, çiftet përballen me rrezikun real të krentimit të një martesë të pavlefshme ose me themele aq të dobëta sa “shpërbëhen” në një kohë të shkurtër dhe nuk dinë t’i rezistojnë as krizave të para të pashmangshme. Këto dështime sjellin me vete vuajtje të mëdha dhe lënë plagë të thella te njerëzit. Ata mbeten të zhgënjyer, të hidhëruar dhe, në rastet më të dhimbshme, madje arrijnë deri aty sa të mos besojnë më në thirrjen e dashurisë, të gdhendur nga vetë Hyji në zemrën e njeriut. Prandaj, para së gjithash, është detyrë t’i shoqërojmë me një ndjenjë përgjegjësie ata që shfaqin qëllimin e tyre për t’u bashkuar në martesë, në mënyrë që të ruhen nga traumat e ndarjeve dhe të mos humbasin kurrë besimin te dashuria.

Por është edhe një ndjenjë drejtësie që duhet të na gjallërojë. Kisha është nënë dhe nëna nuk ka preferenca midis bijve të saj. Nuk i trajton në mënyrë të pabarabartë, u kushton të gjithëve të njëjtin kujdes, të njëjtën vëmendje, të njëjtën kohë. Kushtimi i kohës është shenjë dashurie: nëse nuk i kushtojmë kohë një personi, është shenjë se nuk e duam. Kjo më vjen ndërmend shumë herë kur mendoj se Kisha shpenzon shumë kohë, disa vite, për përgatitjen e kandidatëve për meshtari ose jetën rregulltare, por i kushton pak kohë, vetëm disa javë, atyre që përgatiten për martesë. Ashtu si meshtarët dhe të kushtuarit, edhe bashkëshortët janë bijë të Kishës nënë dhe të trajtohen me një ndryshim kaq të madh nuk është e drejtë. Çiftet e martuara përbëjnë shumicën dërrmuese të besimtarëve dhe shpesh përbëjnë shtyllat

e famullisë, grupeve vullnetare, të shoqatave dhe lëvizjeve. Janë mirëfilli “rojtaret e jetës”, jo vetëm sepse lindin fëmijë, i edukojnë dhe i shoqërojnë në rritjen e tyre, por edhe sepse kujdesen për të moshuarit në familje, i përkushtohen shërbimit të personave me aftësi të kufizuara dhe kaq shpesh me situata varfërie me të cilat bien në kontakt. Nga familjet lindin thirrjet për meshtari dhe jetën e kushtuar; dhe janë familjet që përbëjnë pëlhurën e shoqërisë dhe “arrijnë grisjet” me durim dhe sakrificë të përditshme. Kësisoj, është çështje drejtësie për Kishën nënë që t’i kushtojë kohë dhe energji përgatitjes së atyre që Zoti i thërret për një mision kaq të madh sa ai i familjes.

Prandaj, për ta konkretizuar këtë nevojë urgjente, «kam rekomanduar zbatimin e një katekumenati të mirëfilltë për bashkëshortët e ardhshëm, që përfshin të gjitha etapat e ecjes sakramentale: kohën e përgatitjes për martesë, kremtimin e saj dhe vitet që pasojnë menjëherë» (*Fjalimi drejtuar pjesëmarrësve në kursin mbi procesin martesor*, 25 shkurt 2017). Është ajo që propozon të bëjë Dokumenti që po paraqes këtu dhe për të cilin jam mirënjohës. Ai artikullohet në tri faza: përgatitja për martesë (e hershme, e afërt dhe e menjëhershme); kremtimi i martesës; shoqërimi gjatë viteve të para të jetës bashkëshortore. Siç do ta shihni, bëhet fjalë për të përshkuar një pjesë rruge të rëndësishme së bashku me çiftet në ecjen e jetës së tyre, edhe pas martesës, veçanërisht kur u bie të kalojnë kriza dhe momente shkurajuese. Në këtë mënyrë do të përpiqemi t’i qëndrojmë besnikë Kishës, e cila është nënë, mësuese dhe shoqëruese udhëtimi, gjithmonë përkrah nesh.

Dëshiroj fort që ky Dokument i parë të pasohet sa më shpejt nga një tjetër, në të cilin të tregohen modalitete baritore konkrete dhe itinerare të mundshme shoqëruese, kushtuar posaçërisht atyre çifteve që kanë përjetuar dështim në martesën e tyre dhe që jetojnë në një bashkim të ri ose janë rimartuar civilisht. Kisha, në të vërtetë, dëshiron të jetë afër këtyre çifteve dhe të përshkojë edhe me ta *via caritatis* (krh. *Amoris laetitia*, 306), që të mos ndihen të braktisur dhe të gjejnë te bashkësitë një vend të arritshëm dhe vëllazëror që mirëpret, që i ndihmon të bëjnë dallim dhe të përfshihen.

Ky Dokument i parë që tani po ofrohet është një dhuratë dhe një detyrë. Një dhuratë, sepse vë në duar të të gjithëve një material të bollshëm dhe stimulues, fryt i reflektimit dhe i përvojave baritore të zbatuara tashmë në dioqeza/eparki të ndryshme të botës. Dhe është gjithashtu një detyrë, sepse nuk bëhet fjalë për “formula magjike” që funksionojnë automatikisht. Është një veshje që duhet “qepur sipas masës” për personat që do ta veshin. Njëmend, bëhet fjalë për udhëzime që kërkojnë të merren, të përshtaten dhe të zbatohen në situata konkrete shoqërore, kulturore dhe kishtarë në të cilat çdo Kishë vendore përjeton. Prandaj i bëj thirrje zemrës që dëgjon, zellit dhe krijimtarisë së barinjve të Kishës dhe bashkëpunëtorëve të tyre, për ta bërë më efektive këtë vepër jetike dhe të domosdoshme të formimit, kumtimit dhe shoqërimit të familjeve, që Shpirti Shenjt na kërkon ta realizojmë në këtë moment.

«Asgjë që ishte për të mirën tuaj nuk e lashë pa jua shpallur e pa jua mësuar botërisht e nëpër shtëpi» (*Vap* 20,20). I ftoj të gjithë ata që punojnë në baritoren familjare që t’i përvetësojnë këto fjalë të Palit apostull dhe të mos shkurajohen përballë një detyre që mund të duket e vështirë, kërkuese a madje përtej mundësive

vetjake. Guxim! Le të fillojmë të hedhim hapat e parë! Le të fillojmë proceset e përtëritjes baritore! Le ta vëmë mendjen dhe zemrën tonë në shërbim të familjeve të ardhshme dhe ju siguroj se Zoti do të na mbështesë, do të na japë urti dhe forcë, do të bëjë të rritet te të gjithë ne entuziazmi dhe mbi të gjitha do të na bëjë të përjetojmë «gëzimin e ëmbël dhe ngushëllues të ungjillëzimit» (*Evangelii gaudium*, 9), ndërsa ua shpallim brezave të rinj Ungjillin e familjes.

Francisco

PARASHITRESË

Propozimi i Atit të Shenjtë Françesku për një “katekumenat martesor”

1. Ati i Shenjtë Françesku ka shprehur në disa raste merakun e tij në gjirin e Kishës për një përgatitje më të mirë dhe më të thelluar për në martesë të çifteve të reja, duke këmbëngulur rreth nevojës së një itinerari relativisht të gjerë, të frymëzuar nga katekumenati pagëzimor, që u lejon atyre ta jetojnë sakramentin e Martesës me ndërgjegjësim më të madh, duke u nisur nga një përvojë feje dhe takimi me Jezusin.¹

2. Ky dokument, duke rimarrë çka është thënë tashmë për të njëjtën temë në një dokument të Këshillit Papnor të atëhershëm për Familjen², synon të jetë një përgjigje ndaj këtij shqetësimi të Atit të Shenjtë dhe një ndihmë për Kishat vendore për mendimin ose rimendimin e itinerareve të tyre përgatitore për sakramentin e Martesës dhe shoqërimin e viteve të para të jetës martesore. Prandaj, këto “udhëzime baritore” nuk duhen kuptuar si një “kurs paramartesor” i strukturuar dhe i plotë, në formë dhe përmbajtje, tashmë gati për t’u përdorur në baritoren e zakonshme. Përkundrazi, qëllimi është të paraqesë disa parime të përgjithshme dhe një propozim baritor konkret dhe gjithëpërfshirës, që çdo Kishë vendore është e ftuar t’i marrë parasysh gjatë përpunimit të një itinerari përkatës katekumenal për jetën martesore, duke iu përgjigjur kështu në mënyrë krijuese apelit të Papës.³

3. Situata aktuale kërkon një angazhim të përtërirë baritor për të përforcuar përgatitjen për sakramentin e Martesës në dioqezat/eparkitë dhe famullitë në mbarë kontinentet. Numri gjithnjë e më i reduktuar i personave që përgjithësisht martohen, por edhe dhe, mbi të gjitha, kohëzgjatja e shkurtër e martesave, përfshirë ato sakramentale, ashtu si edhe problemi i vlefshmërisë së martesave të kremtuara, përbëjnë një sfidë urgjente, që rrezikon përmbushjen dhe lumturinë e shumë besimtarëve laikë në botë. Në zanafillë të shumë vështirësive, me të cilat përballen familjet, është brishtësia e dukshme e martesës, që shkaktohet nga një sërë faktorësh

¹ «Dëshiroj të përsëris nevojën e një “katekumenati të ri” në përgatitje për martesën, si një zgjedhje baritore për mbarë Kishën. Duke pranuar dëshirat e Etërve të Sinodit të fundit të Zakonshëm, është urgjente të zbatohet konkretisht çka tashmë është propozuar në *Familiaris consortio* (nr. 66), që do të thotë se, ashtu si për Pagëzimin e të rriturve, katekumenati është pjesë e procesit sakramental, kështu edhe përgatitja për martesë të bëhet pjesë e pandashme e gjithë procedurës sakramentale të martesës, si antidot që pengon shumimin e kremtimeve martesore të pavlefshme ose të paqëndrueshme» (FRANÇESKU, *Fjalim me rastin e Përrurimit të Vitit Gjyqësor të Gjykatës së Rotës Romake*, 21 janar 2017; krh. edhe *Fjalim me rastin e Përrurimit të Vitit Gjyqësor të Gjykatës së Rotës Romake*, 29 janar 2018; *Amoris laetitia*, 205-211).

² KËSHILLI PARNOR PËR FAMILJEN, *Përgatitje për sakramentin e martesës*, 13 maj 1996.

³ «Do të jenë bashkësitë e ndryshme që do të duhet të përpunojnë propozime më praktike dhe efektive, që marrin parasysh si mësimet e Kishës ashtu edhe nevojat dhe sfidat vendore» (*Amoris laetitia*, 199).

si: mendësia hedoniste që shtrembëron bukurinë dhe thellësinë e seksualitetit njerëzor, përqendrimi vetëm te vetvetja që e bën të vështirë marrjen përsipër të kërkesave të jetës martesore, një kuptim i kufizuar i dhuratës së sakramentit martesor, i domethënies së dashurisë martesore dhe i të qenurit të saj thirrje e njëmendtë, domethënë përgjigje ndaj thirrjes së Hyjit drejtuar burrit dhe gruas që vendosin të martohen etj. Meraku që ka Kisha-nënë ndaj këtyre bijve të saj, nevojtarë për ndihmë dhe udhëheqje, duhet të inkurajojë të investohen energji të reja në favor të çifteve «në mënyrë që përvoja e tyre e dashurisë të bëhet një sakrament, një shenjë vepruese shpëtimi»⁴.

⁴ FRANÇESKU, *Fjalim me rastin e Përrurimit të Vitit Gjyqësor të Gjykatës së Rotës Romake*, 21 janar 2017.

I.

TREGUES TË PËRGJITHSHËM

Përse një katekumenat

4. Ideja për përpilimin e *itinerareve katekumenale për martesë* nuk është risi në reflektimin kishtar.¹ Pas dy Sinodeve mbi familjen në vitin 2014 dhe 2015, Papa Françesku e ka propozuar këtë në disa raste në magjsterin e tij të zakonshëm dhe gradualisht mori formë në reflektimin e tij baritor, duke caktuar linjat e rrugëtimeve të ripërtërira të shoqërimit drejt martesës.²

5. Në Kishën e hershme – sipas bindjes së përbashkët të Etërve – krenimit të sakramentit duhej t'i paraprinte një udhëzim i qartë i krishterë i jetës. «Fillimisht është e nevojshme të bëhemi dishepuj të Zotit dhe më pas të pranoemi në Pagëzimin e shenjtë», thotë shën Bazili.³ Shenja të sigurta të orientimit të ri të jetës ishin feja dhe kthimi. Njëmend, katekumenati i lashtë ishte koha në të cilën formoheshin kandidatët për Pagëzim, duke ushqyer tek ata fenë dhe duke i inkurajuar të ktheheshin. Feja u hapte zemrën dhe mendjen ndaj Hyjit dhe veprës shpëtimtare të Jezu Krishtit, kthimi synonte ndreqjen e sjelljeve, zakoneve, praktikave jetësore të papajtueshme me ekzistencën e re të krishterë që katekumenët do të përqafonin.

Në mënyrë analoge me atë që ndodhte me Pagëzimin në Kishën e hershme, sot, në funksion të krenimit të martesës⁴, do të ishin një ndihmesë e madhe një formim

¹ Shprehja shfaqet në studime të ndryshme mbi këtë temë, midis të cilëve F. COUDREAU, në *Verkündigung und Glaube. Festgabe für F.X. Arnold*, Freiburg 1958 dhe B. HÄRING, *Sociologia della famiglia*, Romë 1962. Duke nisur nga vitet '60, disa konferenca ipeshkvore e kanë propozuar edhe në disa dokumente kombëtare dhe rajonale. Për më tepër, Nxitja apostolike *Familiaris consortio*, nisur nga analogjia me katekumenatin pagëzimit, tashmë shënon fazat e itinerarit për përgatitjen drejt martesës: e hershme, e afërt, e menjëhershme dhe shoqërimi i mëpasshëm i bashkëshortëve (krh. nr. 66).

² «Dëshiroj të porosis angazhimin për një katekumenat martesor, për t'u kuptuar si një itinerar i domosdoshëm i të rinjve dhe çiftëve, i cili ka për qëllim të ringjallë ndërgjegjen e tyre të krishterë, mbështetur nga hiri i dy sakramenteve, Pagëzimi dhe Martesa. Siç e kam pohuar edhe herë të tjera, katekumenati në vetvete është unik, pasi është pagëzimit, domethënë i rrënjësor në Pagëzim dhe në të njëjtën kohë në jetë ka nevojë për karakterin e përhershëm, duke qenë se hiri i sakramentit martesor është i përhershëm» (FRANÇESKU, *Fjalim me rastin e Përrurimit të Vitit Gjyqësor të Gjykatës së Rotës Romake*, 29 janar 2018).

³ BAZILI I CEZARESË, *De baptismo* I,1.

⁴ «Është e nevojshme [...] që itineraret e përgatitjes për sakramentin e Martesës të bëhen gjithnjë e më efektive, jo vetëm për rritjen njerëzore, por mbi të gjitha të fesë së të fejuarve. Qëllimi thelbësor i takimeve është të ndihmojë çiftet e fejuara që të arrijnë një përfshirje progresive në misterin e Krishtit, në Kishë dhe me Kishën. Kjo kërkon një pjekje progresive të fesë, nëpërmjet kumtimit të Fjalës së Hyjit, aderimit dhe ndjekjes së pakursyer të Krishtit» (FRANÇESKU, *Fjalim me rastin e Përrurimit të Vitit Gjyqësor të Gjykatës së Rotës Romake*, 21 janar, 2017).

në fe dhe një shoqërim në përvetësimin e një stili jetese të krishterë, veçanërisht drejtuar çifteve. Katekumenati, në të vërtetë, mund të frymëzojë në çdo epokë rrugë të reja të ripërtëritjes së fesë, sepse parashtron një stil shoqërimi të personave – pedagogjik, gradual, me rite – që ruan gjithmonë efikasitetin e vet. Katekumenati martesor, specifikisht, nuk synon të jetë thjesht një katekezë, as të përçojë një doktrinë. Ai synon rikumbimin e misterit të hirit sakramental midis bashkëshortëve, që u përket atyre në sajë të sakramentit: të bëjë të jetojë prania e Krishtit me ta dhe mes tyre.⁵ Për këtë arsye është e nevojshme, përkundrajt atyre që synojnë të martohen, të tejkalohej stili i formimit vetëm intelektual, teorik dhe i përgjithshëm (alfabetizimi fetar). Është e nevojshme që të përshkohet, bashkë me ta, rruga që i çon te takimi me Krishtin, ose në thellimin e kësaj marrëdhënieje dhe të bëhet një shqyrtim autentik i thirrjes së tyre martesore, si në nivelin personal ashtu edhe në çift.⁶

Kujt i takon kjo detyrë

6. Përpunimi i një itinerari përgatitor për martesë i tipit katekumenal dhe shoqërimi konkret i çifteve përgjatë këtij rrugëtimi, është një detyrë që i takon të gjithë bashkësisë kishtarë, në një ecje të përbashkët mes meshtarëve, bashkëshortëve të krishterë, rregulltarëve dhe punëtorëve baritorë, të cilët duhet të bashkëpunojnë midis tyre dhe në marrëveshje me ipeshkvin e tyre. Martesa nuk është vetëm një fakt shoqëror, por për të krishterët është një fakt “kishtar”. Prandaj e gjithë Kisha, si trup i Krishtit, e merr mbi vete dhe ndien nevojën për t’u vënë në shërbim të familjeve të ardhshme.⁷

7. Bindja nga e cila duhet nisur, si për çiftet që përgatiten për t’u martuar, ashtu edhe për punëtorët baritorë që i shoqërojnë ato, është që martesa nuk është një pikë mbërritjeje: është një thirrje, është një ecje shenjtërie që rrok krejt jetën e personave.⁸ Për më tepër, në sajë të pjesëmarrjes së tyre në priftërinë profetike dhe mbretërore të Krishtit, edhe besimtarët laikë marrin me sakramentin e martesës një mision kishtar

⁵ «Hyji që i thirri bashkëshortët “për” Martesë vazhdon t’i thërrasë “në” Martesë» (*Familiaris consortio*, 51).

⁶ «Nuk bëhet fjalë për t’u dhënë atyre gjithë Katekizmin, as për t’i mbushur me argumente të shumta. Në të vërtetë, edhe në këtë rast vlen ajo se jo dija e shumtë e ngin dhe e kënaq shpirtin, por të ndierit dhe të shijuarit e gjërave përbrenda. Vlen më shumë cilësia se sasia, dhe duhet t’u japim përparësi – së bashku me një kumtim të përtërirë të *kerigmës* – atyre përmbajtjeve që, të përçuar në mënyrë tërheqëse e të përzemërt, t’i ndihmojnë që të angazhohen në një rrugëtim të krejt jetës me shpirtmadhësi dhe lirshmëri» (*Amoris laetitia*, 207).

⁷ «Vetë bashkësia e krishterë është e thirrur të përfshihet në përgatitjen e çiftit për martesë, që është një mision kishtar. Bashkëshortët, në të vërtetë, mund të kontribuojnë në përtëritjen e organizmit të mbarë trupit kishtar» (*Amoris laetitia*, 207).

⁸ «[...] të fejuarit të mos e shohin kremtimin e martesës si fundin e rrugëtimit, por ta marrin martesën si një thirrje që i çon përpara, me vendimin e prerë dhe realist për të kapërcyer së bashku të gjitha sprovat dhe momentet e vështira» (*Amoris laetitia*, 211).

specifik për të cilin kanë nevojë që të përgatiten dhe të shoqërohen.⁹ Prandaj, ashtu si Kisha kujdeset për t'i përgatitur në mënyrën më të mirë meshtarët dhe rregulltarët për ta jetuar thirrjen dhe misionin e tyre duke u kushtuar atyre vite të gjata formimi, në të njëjtën mënyrë është detyrë e Kishës t'i përgatisë në mënyrë të përshtatshme besimtarët laikë, që ndihen të thirrur për këtë gjë, për ta pranuar thirrjen martesore dhe për të qenë të qëndrueshëm në të për gjithë jetën, duke e kryer misionin që u përket atyre.¹⁰ Sakramenti i Urdhrit, kushtimi rregulltar dhe sakramenti i Martesës meritojnë të njëjtin kujdes, pasi Zoti i thërret me të njëjtën energji dhe me të njëjtën dashuri burrat dhe gratë në një thirrje a në një tjetër.

8. Për të zbatuar në mënyrë efektive një baritore të ripërtërirë të jetës bashkëshortore është tashmë e domosdoshme që, si çiftet shoqëruese, në famulli dhe në lëvizjet familjare, ashtu edhe presbiterët, që nga formimi në seminar, si rregulltarët dhe të kushtuarit, të jenë të formuar dhe të përgatitur në mënyrë të përshtatshme për plotësimin e ndërsjellë dhe bashkëpërgjegjësinë kishtarë.¹¹ Ky bashkim i natyrshëm në apostullim mes të martuarve dhe personave të kushtuar me celibat ka qenë i pranishëm në jetën kishtarë që në fillimet e saj, siç tregon shembulli i Palit i përkrahur në ungjillëzim nga Akuila dhe Prishila,¹² por që sot duhet të rizbulohet dhe të jetohet plotësisht në famulli dhe në nivel dioqezan, pasi diversiteti i stilit dhe i gjuhës, shumëllojshmëria e përvojave jetësore, shumëllojshmëria e karizmave dhe dhuratave shpirtërore përkatëse për çdo thirrje dhe gjendje të jetës janë një pasurim i madh për përçimin e fesë te çiftet e reja dhe në hyrjen e tyre për në jetën bashkëshortore.

9. Ata që janë përgjegjës për veprimin baritor – famullitarët, rregulltarët, ipeshkvijtë – kryejnë një detyrë të rëndësishme gjallërimi dhe koordinimi.¹³ Meshtarët dhe famullitarët, në veçanti, duke qenë se janë rregullisht të parët që marrin kërkesën e të rinjve për t'u martuar në Kishë, kanë përgjegjësinë e madhe për t'i mirëpritur, inkurajuar dhe mirëdrejtuar çiftet, duke bërë që menjëherë të shfaqet dimensionin e thellë fetar i përfshirë në martesën e krishterë, shumë më i lartë se thjesht një "rit civil" ose "çështje zakoni".¹⁴

⁹ «Në sajë të sakramentit, [bashkëshortët] vishen me një mision të mirëfilltë, në mënyrë që, duke u nisur nga gjërat e thjeshta, të zakonshme, ta bëjnë të dukshme dashurinë me të cilën Krishti e do Kishën e vet, duke vazhduar ta dhurojë jetën për të» (*Amoris laetitia*, 121).

¹⁰ «Nuk mund të përkufizohen si "përgatitje për martesë" tri ose katër konferenca që bëhen në famulli. Përgatitja duhet të përqendrohet dhe kjo gjë kërkon kohë. Nuk është një akt formal: është një sakrament. Por duhet të përgatitet me një katekumenat të vërtetë» (FRANÇESKU, *Katekezë mbi Urdhërimet*, 11/A: *Mos bëj kurorëthyerje*, 24 tetor 2018).

¹¹ Krh. *Amoris laetitia*, 203; KATEKIZMI I KISHËS KATOLIKE, 1632.

¹² Krh. *Vap* 18,1-3; 18, 18-19; 18,26; *Rom* 16,3-5; *1 Kor* 16,19.

¹³ «Ju famullitarëve, bashkëpunëtorëve të domosdoshëm të ipeshkvijve, ju besohet kryesisht një katekumenat i tillë. Ju inkurajoj ta zbatoni pavarësisht vështirësive që mund të hasni (FRANÇESKU, *Fjalim drejtuar pjesëmarrësve në kursin mbi procesin martesor*, 25 shkurt 2017).

¹⁴ «Meshtarët, veçanërisht famullitarët, janë bashkëbiseduesit e parë të të rinjve që dëshirojnë të

10. Përkrah meshtarëve dhe rregulltarëve, një rol parësor duhet të luajnë çiftet e martuara. Përgatitja e çifteve për martesë është një vepër e mirëfilltë ungjillëzimi¹⁵ dhe besimtarët laikë, veçanërisht të martuarit, janë të thirrur, në mënyrë të barabartë me rregulltarët dhe mbarështuesit e urdhëruar, që të marrin pjesë në misionin ungjillëzues të Kishës: janë subjekt baritor.¹⁶ Në sajë të përvojës së tyre specifike, do të jenë në gjendje t'i japin konkretizim rrugëtimeve të shoqërimit, para martesës dhe gjatë martesës, duke ndërhyrë si dëshmitarë dhe shoqërues të çifteve në lidhje me shumë aspekte të jetës së tyre martesore (afektive, seksuale, bashkëbiseduese, shpirtërore) dhe familjare (punët e shtëpisë dhe kujdeset, hapja ndaj jetës, dhurimi i ndërsjellë, edukimi i fëmijëve, mbështetja në mundimet e përditshme, në vështirësi dhe sëmundje). Bashkëshortët që vihen në dispozicion për këtë shërbim të çmuar shoqërimi, marrin vetë ata përfitime të mëdha prej tij: njëmend, kryerja e një angazhimi baritor së bashku dhe kumtimi i “Ungjillit të martesës”, përbën një faktor të rëndësishëm bashkimi shpirtëror dhe pasurimi personal dhe si çift. Megjithatë, do të jetë e nevojshme të shmanget rreziku që laikët dhe në veçanti bashkëshortët, në të jetuarit e këtij protagonizmi kishtar, të zënë vendin e meshtarit, duke marrë role dhe funksione që nuk u përkasin atyre. Meshtarët dhe rregulltarët, nga ana e tyre, do të kujdesen që prania e laikëve të mos zvogëlohet në dëshmitarë të thjeshtë, pasi atyre u takon një hapësirë bashkëpërgjegjësie konkrete. Prandaj, meshtarët dhe rregulltarët do të përpiqen të vihen në qëndrim dëgjimi të vazhdueshëm dhe verifikimi të ecjes së bashku me çiftet që bashkëpunojnë me ta dhe që e jetojnë me përfshirje dimensionin familjar, duke shmangur të qenurit të vetmit aktorë ose e kundërta, të bëjnë kërkesa të tepërta dhe të delegojnë shumë, duke rrezikuar “të lodhin familjet”.

krijojnë një familje të re dhe të martohen me sakramentin e Martesës. Shoqërimi prej mbarështuesit të urdhëruar do t'i ndihmojë bashkëshortët e ardhshëm të kuptojnë se martesë midis një burri dhe një gruaje është shenjë e bashkimit martesor midis Krishtit dhe Kishës, duke i bërë të vetëdijshëm për domethënien e thellë të hapit që po ndër marrin» (FRANÇESKU, *Fjalimi për pjesëmarrësit në kursin dioqezan të formimit rreth martesës dhe familjes, promovuar nga Gjykata e Rotës Romake*, 27 shtator 2018).

¹⁵ «Sot më shumë se kurrë, kjo përgatitje paraqitet si një rast i mirëfilltë për ungjillëzimin e të rriturve dhe, shpesh, të të ashtuquajturve të largët. Njëmend, janë të shumtë të rinjtë për të cilët afrimi i martesës përbën një mundësi për t'u takuar sërish me fenë që prej kohësh e kanë lënë mënjanë jetës së tyre; për më tepër, ata e gjejnë veten në një moment të veçantë, shpeshherë të karakterizuar edhe nga gatishmëria për ta rishikuar dhe ndryshuar orientimin e ekzistencës. Kësisoj, mund të jetë një kohë e favorshme për të ripërtërirë takimin e tyre me personin e Jezu Krishtit, me mesazhin e Ungjillit dhe me doktrinën e Kishës» (FRANÇESKU, *Fjalim me rastin e Përrurimit të Vitit Gjyqësor të Gjykatës së Rotës Romake*, 21 janar 2017).

¹⁶ «Çiftet e shenjta të krishtera [...] janë vepër e Shpirtit Shenjt, i cili është protagonist i misionit, gjithmonë, dhe tashmë janë të pranishme në bashkësitë tona territoriale. [...] Le të mendojmë për punën baritore në katekumenatin paramartesor dhe pasmartesor: janë këto çifte që duhet ta bëjnë dhe ta çojnë përpara» (FRANÇESKU, *Fjalim me rastin e Përrurimit të Vitit Gjyqësor të Gjykatës së Rotës Romake*, 25 janar 2020).

Për një baritore të përtërirë të jetës bashkëshortore

11. Prandaj, ripërtëritja baritore e dëshiruar nga Papa Françesku që nga fillimi i pontifikatit të tij¹⁷ duhet të përfshijë edhe baritoren e jetës bashkëshortore. Në këtë rrafsh, rruga e përtëritjes mund të tregohet duke u nisur nga tre “shënime” specifike: tërthortësia, sinodaliteti dhe vazhdimësia.

12. “Tërthortësi” do të thotë që baritorja e jetës bashkëshortore nuk kufizohet në sferën e kufizuar të “takimeve për të fejuarit”, por “përshkon” nëpër shumë sfera të tjera baritore dhe në to mbahet gjithmonë e pranishme. Në këtë mënyrë, shmanget një farë ndarjeje e baritores në “hapësira të mbyllura” gjë që ul efektivitetin e vet. Në të vërtetë, baritorja e fëmijëve, baritorja rinore dhe ajo e familjes kanë nevojë të ecin së bashku, në sinergji. Duhet të jenë reciprokisht të vetëdijshme për rrugëtimet dhe objektivat baritore që synojnë, për të përfutur një proces rritjeje lineare dhe një thellim gradual të fesë. Në këtë kuptim, famullitari duhet të luajë një rol të rëndësishëm koordinues për t’u bashkëndarë me ekipin baritor. Për më tepër, do të ishte shumë e dobishme nëse në këto tri fusha do të ishte gjithmonë e pranishme *perspektiva thirrrore* që unifikon dhe i jep koherencë rrugëtimit të fesë dhe jetës së personave. Madje edhe *baritorja sociale* duhet të integrohet me atë familjare, pasi nuk mund të kuptohet sot një baritore sociale e përshtatshme, pa e “dëgjuar” familjen, ashtu siç nuk mund të kuptohen familjet pa marrë parasysh se si sot janë të ndikuara nga realiteti social.

13. “Sinodaliteti” përcakton *modus vivendi et operandi* specifike të Kishës. Kisha është bashkim dhe realizon konkretisht të qenurit e saj bashkim në ecjen së bashku, në koordinimin e të gjitha fushave baritore dhe në pjesëmarrjen aktive të të gjithë anëtarëve të saj në misionin e vet ungjillëzues.¹⁸ Në këtë stil sinodal duhet jetuar edhe baritorja e jetës bashkëshortore, që duhet të “merret” me përgjegjshmëri të përbashkët nga të gjithë në Kishë, duhet të përqafojë të gjitha fushat baritore dhe duhet të ecë paralelisht me ecjen e përbashkët të Kishës në çdo epokë historike, duke u rritur me të, duke u përditësuar dhe përtërirë me të.

14. “Vazhdimësia” i referohet karakterit jo “episodik” por “të zgjatur në kohë” – mund të thuhet edhe “i përhershëm” – i baritores së jetës bashkëshortore. Në këtë mënyrë është e mundur të vendosen itinerare pedagogjike, të cilat në fazat e ndryshme të rritjes – njerëzore dhe fetare –, t’i shoqërojnë fëmijët dhe të rinjtë në zbulimin gradual të thirrjes së tyre: qoftë martesë, meshtaria apo jeta rregulltare. Prandaj, është e nevojshme rrënjësia e thirrjes martesore në ecjen e hyrjes së

¹⁷ «Baritorja nga pikëpamja misionare kërkon që të heqim dorë nga kriteri baritor i tipit “gjithmonë është bërë kështu”. I ftoj të gjithë të jenë të guximshëm dhe krijues në këtë detyrë të rimendimit të objektivave, strukturave, stilit dhe metodave ungjillëzuese të bashkësive përkatëse. Një identifikim i qëllimeve pa një kërkim të përshtatshëm bashkësior të mjeteve për t’i arritur ato është i dënuar të përkthehet në fantazi të kotë» (*Evangelii gaudium*, 33).

¹⁸ KOMISIONI TEOLOGJIK NDËRKOMBËTAR, *Sinodaliteti në jetën dhe misionin e Kishës*, 2 mars 2018, 6.

krishterë në fe që në fëmijëri.¹⁹

15. Nën dritën e asaj që sapo u tha, është i nevojshëm një rimendim serioz i mënyrës me të cilën Kisha shoqëron rritjen njerëzore dhe shpirtërore të personave. Njëmend, jo në pak vende, në jetën dhe veprimtarinë e zakonshme të famullive, verifikohen periudha të gjata të “braktisjes baritore” së disa fazave të jetës së personave dhe familjeve, të cilat fatkeqësisht janë shkaku i largimit nga bashkësia dhe shpeshherë edhe nga feja: të mendojmë, për shembull, për prindërit pas katekezës për Pagëzimin e fëmijëve ose për fëmijët pas Kungimit të parë. Pikërisht për të mbushur këto “boshllëqe baritore” është me vend të mendohet për rrugëtime thirrrore specifike si vazhdimësi e formimit kateketik bazë dhe për rrugëtime të tjera shoqërimi, derisa prindërit të mund ta ndjekin rritjen shpirtërore të fëmijëve të tyre gjatë fëmijërisë dhe adoleshencës dhe të ndihen të mbështetur në një pikësynim të tillë nga një bashkësi me të cilën mund të bashkëndajnë reflektimet dhe përvojën.²⁰

¹⁹ *Amoris laetitia*, 206.

²⁰ «Familja dhe të rinjtë nuk mund të jenë dy sektorë paralelë të baritores së bashkësive tona, por duhet të ecin së bashku ngushtësisht, sepse shumë shpesh të rinjtë janë ajo çka u ka dhënë familja në periudhën e rritjes. Kjo perspektivë ribashkon në unitet një baritore thirrrore të kujdesshme për të shprehur fytyrën e Jezusit në shumë aspekte të saj» (FRANÇESKU, *Fjalimi në takimin me besimtarët gjatë vizitës në Loreto*, 25 mars 2019).

II. NJË PROPOZIM KONKRET

16. Papa Françesku ka «rekomanduar zbatimin e një katekumenati të mirëfilltë të bashkëshortëve të ardhshëm, që përfshin të gjitha etapat e ecjes sakramentale: kohën e përgatitjes për martesë, kremtimin dhe vitet që pasojnë».¹ Siç është thënë tashmë, është detyrë e çdo dioqeze/eparkie të përpunojë ose të rimendojë itinerarin përkatës të përgatitjes për martesë të frymëzuar nga katekumenati para-pagëzimor. Natyrisht kjo do të bëhet duke marrë parasysh mundësitë dhe kufijtë e përcaktuar nga vetë konteksti gjeografik, kulturor dhe baritor, duke u nxitur nga këto udhëzime në mënyrë të lakueshme dhe krijuese.

Në përpunimin e të këtij projekti, duhen pasur parasysh disa rekuizite:

– të zgjasë për një kohë mjaftueshmërisht të gjatë për t’ua mundësuar çifteve një reflektim dhe pjekuri të vërtetë;

– që, megjithëse duke u nisur nga përvoja konkrete e dashurisë njerëzore, të vihet në qendër të përgatitjes për martesë feja dhe takimi me Krishtin;

– të ndahet në etapa, të shënjuara – aty ku është e mundur dhe me vend – me rite kalimi që kremtohen brenda bashkësisë;

– që të përfshijë të gjitha këto elemente (pa përjashtuar asnjë): formim, reflektim, ballafaqim, dialog, liturgji, bashkësi, lutje, festë.

Sidoqoftë, është e rëndësishme të theksohet se edhe kur një dioqezë/eparki e ka përpunuar itinerarin përkatës të përgatitjes për martesë, ky “mjet baritor” nuk mund të “imponohet” pa u thelluar më tej si të ishte rruga e vetme për t’u përgatitur për martesë, por përkundrazi do të përdoret për të bërë dallim dhe duke peshuar si duhet, duke e ditur mirë se ka raste kur nuk do të jetë e mundur ose nuk duhet të ndiqet katekumenati martesor, por duhen gjetur modalitete dhe forma të tjera përgatitjeje në funksion të martesës.

Modaliteti

17. Do të jetë e përshtatshme që dioqeza/eparkia, pasi të ketë përpunuar itinerarin e vet të katekumenatit martesor, t’ia nënshtrojë programin një periudhe eksperimentimi dhe sprove nëpërmjet një “projekti pilot”, për t’u nisur, në fillim, në të gjitha ose vetëm në disa famulli (në varësi të realitetit baritor). Pas këtij eksperimentimi të parë, do të jetë e nevojshme të mblidhen mendimet dhe vlerësimet, si të punonjësve baritorë ashtu edhe të çifteve pjesëmarrëse, të reflektohet së bashku mbi të mirat dhe defektet e konstatuara dhe të vazhdohet rrjedhimisht me përmirësimet e nevojshme.

18. Përballë shumëllojshmërisë së situatave personale, dioqeza/eparkia mund të

¹ FRANÇESKU, *Fjalimi drejtuar pjesëmarrësve gjatë kursit rreth procesit martesor*, 25 shkurt 2017.

parashikojë një formë të përbashkët të itinerarit katekumenal, duke vlerësuar më pas mënyrën e personalizimit të ecjes sipas çifteve. Krijimtaria baritore do të jetë thelbësore, ashtu si dhe fleksibiliteti në lidhje me situatën konkrete të çifteve të ndryshme: praktika fetare, motivimet sociale dhe ekonomike, moshë, bashkëjetesa, prania e fëmijëve dhe faktorë të tjerë që lidhen me vendimin për t'u martuar.

19. Riti i hyrjes në jetën e krishterë për të rriturit mund të përbëjë një kornizë referimi të përgjithshëm tek i cili të merret frymëzimi. Do të jetë veçanërisht e rëndësishme të theksohet çka paraprin dhe pason katekumenatin (përkatësisht ungjillëzimi i parë dhe mistagogjia); të veprohet në atë mënyrë që kalimet nga një kohë në tjetrën të shënjojnë nga një shoshitje, nga simbole dhe rite (aty ku nuk është e shkëshillueshme për arsye kulturore); që të ketë një lidhje të qartë midis sakramenteve të tjera (Pagëzimi, Eukaristia, Përforcimi) dhe Martesës. E gjithë kjo, duke pasur parasysh se pedagogjia e fesë nënkupton takimin personal me Krishtin, kthimin e zemrës dhe jetën praktike dhe përvojën e Shpirtit në bashkësinë kishtarë.

20. Është e nevojshme që të gjithë ata që shoqërojnë – çiftet, presbiterët dhe në përgjithësi punëtorët baritorë – të zotërojnë një formim dhe një stil shoqërimi të përshtatshëm për rrugëtimin katekumenal. Siç është theksuar tashmë, nuk bëhet fjalë aq për të përçuar nocione apo për të fituar aftësi, sa për të udhëhequr, ndihmuar dhe për t'u qenë pranë çifteve në një ecje që duhet përshkuar së bashku. Katekumenati martesor nuk është një përgatitje për një "provim që duhet kaluar" por për një "jetë për t'u jetuar". Prandaj, prioritet është formimi dhe përditësimi i vazhdueshëm i presbiterëve dhe rregulltarëve, që shpeshherë përdorin një gjuhë "të largët" nga realiteti konkret i familjeve dhe të pakuptueshëm për ta, edhe për përmbajtjet tepër abstrakte në mënyrën se si paraqiten. E njëjta gjë mund të thuhet për "tonin" e përgjithshëm që duhet përdorur në këtë rrugëtim katekumenal, që do duhej të shkonte përtej "apelit moralist" e përkundrazi, të jetë propozues, bindës, inkurajues dhe i orientuar drejt së mirës dhe së bukurës që mund të jetojë në martesë. Në fund të fundit, plotësia, saktësia e përmbajtjes dhe stili i shoqërimit duhet të synojnë të nxjerrin në pah dinjitetin dhe vlerën e çdo personi dhe, në të njëjtën kohë, dinjitetin dhe vlerën e thirrjes në të cilin janë thirrur, gjithmonë e zbritur në një realitet konkret. Kjo vëmendje ndaj stilit është veçanërisht e rëndësishme, sot, nën dritën e faktit se shumë çifte të fejuarish jetojnë në situata komplekse bashkëjetese, në të cilat e kanë të vështirë të kuptojnë rëndësinë sakramentale të zgjedhjes që janë duke bërë dhe "kthimin" që kjo zgjedhje bashkëmbart, edhe pse "shohin vagëllimthi" misterin më të madh të sakramentit krahasuar me bashkëjetesën e thjeshtë. Ndaj do të jenë të nevojshme gradualiteti, mikpritja dhe mbështetja, por edhe dëshmia e bashkëshortëve të tjerë të krishterë që mirëpresin dhe "janë të pranishëm" gjatë ecjes. Për këtë arsye është e rëndësishme që në bashkësi t'i jepet më shumë hapësirë pranisë aktive të bashkëshortëve si bashkëshortë, si veprues të baritores martesore dhe jo vetëm si besimtarë individualë. Janë për t'u fuqizuar përvojat e "personalizuara" në grupe pune,

dëgjimi dhe përgatitjeje – nëse është e nevojshme edhe me secilën palë veç e veç – derisa çiftet të ndiqen nga afër nga shoqëruesit e martuar të cilët mund të kontribuojnë në krijimin e një klime miqësie dhe mirëbesimi. Të përdoret edhe shtëpia për t'i bërë të ndihen të mirëpritur dhe sa më mirë.

21. Ekipi i shoqëruesve që udhëheq rrugëtimin mund të formohet nga disa çifte të martuara mbështetur nga një meshtar dhe nga ekspertë të tjerë të baritores familjare, si dhe nga rregulltarë/e dhe eventualisht edhe të ndarë, të cilët i kanë qëndruar besnikë sakramentit, që mund të ofrojnë dëshminë dhe përvojën e tyre thirrrore në një mënyrë gjithnjë konstruktive, duke ndihmuar kështu në dëftimin e fytyrës së një Kishe pranuese, që zbret plotësisht në realitet dhe që vihet përkrah të gjithëve. Të kihet kujdes që kjo detyrë të mos i caktohet vetëm një çifti të vetëm, por çifteve të ndryshme, mundësisht të moshave të ndryshme, dhe të mos caktohet i njëjti ekip për shumë vite, duke siguruar kështu një shkëmbim të përshtatshëm. Është i domosdoshëm edhe bashkëpunimi ndërmjet famullive dhe/ose zonave baritore për të favorizuar shumëllojshmërinë e rrugëtimeve dhe mundësinë për t'i ofruar të gjithëve një ecje formimi.

22. Disa tematika komplekse që i përkasin seksualitetit martesor ose hapjes ndaj jetës (të tilla si prindërimi i përgjegjshëm, fekondimi artificial, diagnoza e paralindjes dhe çështje të tjera bioetike) kanë implikime të forta etike, marrëdhënore dhe shpirtërore për bashkëshortët, dhe sot kërkojnë formim specifik dhe qartësi të ideve. Aq më tepër meqenëse disa mënyra të trajtimit të këtyre tematikave paraqesin aspekte morale problematike. Vetë shoqëruesit nuk janë gjithmonë në gjendje t'i trajtojnë këto çështje, të cilat janë tejmë të përhapura. Përfshirja e personave më ekspertë, në këto raste, është si asnjëherë me vend.²

23. Gjatë itinerarit, ritet kanë funksionin e miratimit të përmbjlljes së një etape dhe fillimit të fazës vijuese dhe mund të jenë vendi i duhur për të shprehur lirisht vullnetin për të vazhduar itinerarin, duke shkallëzuar kështu thellimin gradual të rrugëtimit. Ndër të tjera, Riti shënjon ndërthurjen graduale mes rritjes në fe dhe rritjes në dashurinë e të fejuarve. Ndër ritet që duhen marrë në konsideratë, përpara se të arrihet në vetë ritin e mirëfilltë të martesës, mund të jenë: dorëzimi i Biblës çifteve, paraqitja para bashkësisë, bekimi i unazave të fejesës, dorëzimi i një "lutjeje të çiftit" që do t'i shoqërojë në rrugëtimin e tyre. Nëse diçka e tillë është me vend apo jo, do të vlerësohet sipas realitetit kishtar vendor. Secili prej këtyre riteve mund të shoqërohet me një tërheqje shpirtërore, e cila mund të jetë një rast për të bërë dallim dhe për të vendosur nëse do të vazhdohet apo jo drejt etapës tjetër, në dialog shpirtëror me ekipin e personave shoqërues. Në vitet e para të jetës martesore, nga ana tjetër, mund të sugjerohet fronëzimi i një "altari familjar", pra një vend në shtëpi ku bashkëshortët dhe fëmijët bashkohen në lutje.

² Khr. *Amoris laetitia*, 204.

Faza dhe etapa

24. Nga një këndvështrim baritor afatgjatë, do të ishte mirë që itinerari katekumenal i mirëfilltë të paraprihej nga një fazë para-katekumenale: kjo gjë, në praktikë, do të përkonte me periudhën e gjatë të “përgatitjes së hershme” për martesë, e cila fillon që në fëmijëri. Faza e mirëfilltë katekumenale përbëhet nga tri etapa të dallueshme: përgatitja e afërt, përgatitja e menjëhershme dhe shoqërimi i viteve të para të jetës martesore. Midis fazës para-katekumenale dhe fazës së mirëfilltë katekumenale, mund të parashikohet një fazë e ndërmjetme, në të cilën pranohen kandidatët, që mund të përmbillet me një rit të hyrjes në katekumenatin martesor. Duke përmbledhur në mënyrë skematike çka do të shtjelohet më vonë, kjo mund të jetë vazhdimësia e fazave dhe etapave të ndryshme, me disa nga ritet dhe tërheqjet shpirtërore që shkallëzojnë pasazhet:

A. Faza para-katekumenale: përgatitja e hershme

- Baritorja e fëmijërisë
- Baritorja rinore

B. Faza e ndërmjetme (disa javë): koha e pranimit të kandidatëve

- Riti i hyrjes në katekumenat (në fund të fazës së pranimit)

C. Faza katekumenale

- Etapa e parë: përgatitja e afërt (rreth një vit)
Riti i fejesës (në fund të përgatitjes së afërt)
Tërheqje [shpirtërore] e shkurtër hyrëse për përgatitjen e menjëhershme
- Etapa e dytë: përgatitja e menjëhershme (disa muaj)
Tërheqje shpirtërore e shkurtër në përgatitje për martesën (disa ditë para kremtimit)
- Etapa e tretë: vitet e para të jetës martesore (2-3 vjet)

Dy saktësime

25. Përvoja baritore në pjesën më të madhe të botës tregon tashmë praninë e vazhdueshme dhe të përhapur të “kërkesave të reja” për përgatitje për martesën sakramentale nga ana e çifteve që tashmë bashkëjetojnë, kanë kremtuar një martesë civile dhe kanë fëmijë. Këto kërkesa nuk mund të shmangen më nga Kisha, as të rrafshohen brenda rrugëtimeve të gjurmuara për ata që vijnë nga një ecje minimale feje; përkundrazi kërkojnë forma të personalizuar shoqërimi, ose në grupe të vogla, që synojnë një pjekje personale dhe në çift drejt martesës së krishterë, nëpërmjet rizbulimit të fesë duke nisur nga Pagëzimi dhe kuptimi gradual i domethënies së ritit dhe sakramentit të Martesës. Për çifte të tilla, Kishat vendore mund të mendojnë për rrugëtime katekumenale jashtë baritores zhvillimore të rinisë dhe të fejesës – siç

është propozuar në këtë dokument – që, edhe pse çojnë në të njëjtin ndërjegjësim thirror dhe sakramental, nisen posaçërisht nga përvoja e tyre konkrete e jetës. Në këtë mënyrë do t'i jepej formë një propozimi të ri për t'iu përgjigjur nevojave të një realiteti familjar bashkëkohor, të ndryshëm nga ai që mbizotëronte dekada më parë, por sidoqoftë me dëshirën për t'iu afruar më shumë Kishës dhe “misterit të madh” të Martesës.

26. Në përshkrimin që vijon, itinerari paraqet edhe disa “rite”. Është mirë t'i kushtohet vëmendje mënyrës se si zhvillohen këto rite dhe mbi të gjitha se si perceptohen. Njëmend, megjithëse pranimi nga çiftet që marrin pjesë në këtë rrugëtim formues është përgjithësisht shumë pozitiv, përvoja ka treguar gjithashtu se mund të ketë rreziqe të mundshme, veçanërisht në disa vende, për shkak të një kulture dhe një mentaliteti veçanërisht të ndjeshëm ndaj gjesteve rituale dhe rëndësisë së tyre sociale. Është konstatuar, në të vërtetë, se një “ekspozim” i tepruar publik i të fejuarve, me pjesëmarrje në ritet e ndryshme të itinerarit katekumenal të familjeve dhe të mbarë bashkësisë së famullisë, ka bërë që këto rite të perceptoheshin pothuajse si “hershim” i martesës, duke krijuar pritshmëri të rreme dhe presion të panevojshëm psikologjik te çifti i fejuar. Është e qartë se e gjithë kjo mund të ndikojë negativisht në procesin e dallimit të të fejuarve dhe të kufizojë lirinë e tyre, duke krijuar kështu kushtet paraprake për një kremtim të pavlefshëm të martesës. Kësisoj, rekomandohet maturia e nevojshme dhe vlerësimi i kujdesshëm se si të parashtrohen këto rite, sipas kontekstit social në të cilin veprohet. Në disa raste, për shembull, mund të preferohet që këto rite të zhvillohen vetëm brenda grupit të çifteve që ndjekin itinerarin, pa përfshirë familjet apo persona të tjerë. Në raste të tjera, preferohet që ato të shmangen tërësisht.

A. Faza para-katekumenale: përgatitja e hershme

27. Përgatitja e hershme i paraprin itinerarit të mirëfilltë katekumenal. Ajo synon, që nga fëmijëria, të “përgatitë terrenin” në të cilin do të mund të shartohen filizat e thirrjes së ardhshme për në jetën bashkëshortore. “Terreni” përgatitet më së miri nëse fëmijëve u rrënjohet vlerësimi për çdo vlerë autentike njerëzore, nëse kultivohet çmuarja e vetes dhe e të tjerëve, nëse mësohet sundimi i vetvetes edhe në gjërat e vogla, përdorimi i drejtë i prirjeve, respekti për njerëzit e seksit tjetër dhe dinjiteti i çdo qenieje njerëzore në përgjithësi.³

³ «Përgatitja e hershme fillon që në fëmijëri, në atë pedagogji të urtë familjare, që synon t'i çojë fëmijët të zbulojnë vetveten si qenie të pajisura me një psikologji të pasur dhe komplekse dhe një personalitet të veçantë me pikat e veta të forta e të dobëta. Është periudha në të cilën rrënjohet vlerësimi për çdo vlerë autentike njerëzore, si në marrëdhëniet ndërpersonale ashtu edhe në ato shoqërore, me atë çka do të thotë për formimin e karakterit, për sundimin dhe përdorimin e drejtë të vetë prirjeve, për mënyrën e çmuarjes dhe takimit të njerëzve të seksit tjetër [...]. Për më tepër, kërkohet, veçanërisht për të krishterët, një formim i qëndrueshëm shpirtëror dhe kateketik, që di të shquajë te martesë një thirrje dhe mision të vërtetë [...]. Mbi këtë bazë, në vijim do të qaset, në një mënyrë të gjerë, përgatitja e

28. Kisha, me kujdes të zellshëm amnor, do të kërkojë mënyrën më të përshtatshme për t'u "rrëfyer" fëmijëve planin e dashurisë që Hyji ka për çdo person, shenjë e të cilit është martesë dhe që, edhe në rastin e tyre, do dëftohet si një thirrje vokacionale. Aty luhet lumturia e brezave të tërë. Në fund të fundit, thirrja familjare ka të bëjë me pjesën më të madhe të njerëzve në botë. Për këtë qëllim, do të jetë e nevojshme që të formohet që në fëmijëri një antropologji e krishterë e shëndoshë – duke përfshirë elementet e para të seksualitetit njerëzor dhe teologjinë e trupit⁴ – dhe të zhvillohet identiteti i tyre pagëzimor në një perspektivë thirrërore, si për në martesë ashtu edhe për në jetën rregulltare.

29. Rrugëtimi formues i filluar me fëmijët mund të vazhdohet e të thellohet tek adoleshentët dhe të rinjtë, në mënyrë që të mos arrijnë te vendimi për t'u martuar pothuajse rastësisht dhe pas një adoleshence të shënuar nga përvoja afektive dhe seksuale të dhimbshme për jetën e tyre shpirtërore. Përvoja të tilla mund të shkaktojnë plagë të thella emocionale, të cilat do të lënë gjurmë në jetën e tyre seksuale dhe martesore si të rritur. Përballë tyre, ekipi baritor duhet të jetë në gjendje të ofrojë ndihmën e ekspertëve që, në nivel personal, mund t'i shoqërojnë këta të rinj. Për më tepër, shumë prej tyre, për arsye të ndryshme, në sajë të kontekstit familjar, social apo kulturor, i afrohen moshës madhore pa asnjë përgatitje për jetën martesore dhe po ashtu nuk e kanë menduar kurrë martesën si një thirrje dhe prandaj mjaftohen me bashkëjetesën. Shumicën e herëve kjo nuk ndodh nga një kundërshti e shpërfaqur ndaj dimensionit fetar, por nga mosnjohja e pasurisë së pamasë që përmban hiri sakramental i Martesës së krishterë, ose për arsye të tjera shoqërore ose kulturore.⁵ Prandaj, do të jetë e rëndësishme të përgatiten punëtorët baritorë, që të dinë të përdorin një gjuhë të përshtatshme dhe të dinë ta parashtrajnë Fjalën në mënyrë të kuptueshme për të rinjtë, të zbritur në realitetin e tyre, në gjendje për të ngjallur tek ata një interes të vërtetë.

30. Ka dy rreziqe për të rinjtë: nga njëra anë, përhapja e një mendësie hedoniste dhe konsumiste që u heq atyre aftësinë për të kuptuar domethënien e bukur e të thellë të seksualitetit njerëzor. Nga ana tjetër, ndarja mes seksualitetit dhe "përgjithmonë"-s së martesës. Rrugëtimet e edukimit lidhur me afektivitetin dhe

ardhshme» (*Familiaris consortio*, 66); krh. edhe KËSHILLI PARNOR PËR FAMILJEN, *Përgatitje për sakramentin e martesës*, nr. 22.

⁴ Ndihmë e madhe për këtë detyrë është mjeti ndihmës baritor i përpunuar nga KËSHILLI PARNOR PËR FAMILJEN, *Seksualiteti njerëzor: e vërteta dhe domethënia. Udhëzime edukative në familje*, 8 dhjetor 1995.

⁵ «Zgjedhja e martesës civile ose, në disa raste, thjeshtë e bashkëjetesës, shpesh nuk është e motivuar nga paragjykime apo rezistenca ndaj bashkimit sakramental, por nga situata kulturore apo rrethanore. [...] Bashkëjetesa e thjeshtë zgjidhet shpesh për shkak të mentalitetit të përgjithshëm në kundërshtim me institucionet dhe angazhimet vendimtare, por edhe për shkak të pritjes së një sigurie ekzistenciale (punë dhe pagë fikse). Së fundi, në vende të tjera bashkimet faktike janë të shumta, jo vetëm për shkak të refuzimit të vlerave të familjes dhe martesës, por mbi të gjitha për faktin se martesë perceptohet si një luks, për arsye të kushteve shoqërore, kështu që mjerimi material i shtyn njerëzit të jetojnë bashkime faktike» (*Amoris laetitia*, 294).

seksualitetin – në horizontin e “një edukimi seksual pozitiv dhe të kujdesshëm” – që u propozohen të rinjve “me rritjen në moshë”⁶ nuk duhet të kufizohen vetëm në horizontin e dashurisë *tout court*, meqenëse kjo gjë, në interpretimin kulturor mbizotërues, kuptohet kryesisht si dashuri romantike, por duhet të përfshihen në një vizion të qartë bashkëshortor të dashurisë, e kuptuar kjo si dhurim i ndërsjellët i bashkëshortëve, si aftësi për të dashur e për të lejuar që të jesh i dashur, si një shkëmbim i ndërsjellët për zemërsie dhe pranimit pa kushte, si aftësi për të gëzuar dhe për të vuajtur për tjetrin.⁷ Është veçanërisht urgjente krijimi ose forcimi i rrugëtimeve baritore drejtuar mbi të gjitha të rinjve në moshën e pubertetit dhe adoleshencës. Nisur nga sfidat e sotme, në të vërtetë, familja nuk mund dhe nuk arrin të jetë i vetmi vend edukimi rreth afektivitetit. Kësisoj, ka nevojë për ndihmën e Kishës. Për këtë qëllim, është e rëndësishme që të merren masa për një formim të përshtatshëm të formuesve që shoqërojnë të rinjtë e moshës së lartpërmendur në edukimin e seksualitetit dhe afektivitetit, duke përfshirë ekspertë dhe duke krijuar sinergji, për shembull, me këshilluesit me frymëzim të krishterë ose me planet baritore të edukimit rreth afektivitetit të miratuar dhe njohur nga dioqeza/eparkia ose nga konferenca ipeshkvore.

31. Si faza e fëmijërisë, ashtu edhe ajo e adoleshencës dhe rinisë së hershme, janë pjesë e një rrugëtimi të vetëm edukues, pa shkëputje të vazhdimësisë, i cili bazohet në dy të vërteta themelore; «E para është që njeriu është i thirrur të jetojë në të vërtetën dhe dashurinë; e dyta është që çdo njeri realizohet përmes dhurimit të singertë të vetvetes»⁸ në një thirrje. Ndriçimi i të rinjve mbi marrëdhënien që dashuria ka me të vërtetën do t'i ndihmojë ata që të mos e druajnë në mënyrë fataliste ndryshimin e ndjenjave dhe provën e kohës.⁹

32. Rrugëtimi edukativ i përgatitjes së hershme duhet mbajtur parasysh në qasjen baritore të çdo famullie apo realiteti tjetër kishtar. Në veçanti, duhet të shpallet në mënyrë të hapur në fushën e baritores rinore (duke përfshirë grupet e adoleshentëve) dhe të propozohet si një kohë e favorshme për të filluar pjekjen e

⁶ FRANÇESKU, *Amoris laetitia*, 280, cit. *Gravissimum educationis*, 1.

⁷ «Për martesë duhet përgatitje dhe kjo kërkon edukimin e vetvetes, zhvillimin e virtyeteve më të mira, veçanërisht dashurinë, durimin, aftësinë për dialog dhe shërbim. Nënkupton edhe edukimin e seksualitetit vetjak, në mënyrë që të jetë gjithnjë e më pak një mjet për të përdorur të tjerët dhe gjithnjë e më shumë një aftësi për t'iu dhuruar plotësisht një personi në një mënyrë ekskluzive dhe bujare» (FRANÇESKU, *Christus vivit*, 265).

⁸ GJON PALI II, *Letër drejtuar familjeve. Gratissimam sane*, 16.

⁹ «Vetëm për aq sa është e bazuar në të vërtetën, dashuria mund të zgjasë në kohë, të kapërcejë çastin kalimtar dhe të mbetet e palëkundur për të mbështetur një rrugëtim të përbashkët. Nëse dashuria nuk ka lidhje me të vërtetën, i nënshtrohet ndryshimeve të ndjenjave dhe nuk i qëndron provës së kohës. Dashuria e vërtetë, përkundrazi, bashkon të gjithë elementët e personit tonë dhe bëhet një dritë e re drejt një jete të madhe dhe të plotë. Pa të vërtetën, dashuria nuk mund të ofrojë një lidhje të fortë, nuk mund ta çojë “un”-in përtej izolimit të vet, as ta çlirojë atë nga çasti kalimtar për të ndërtuar jetën dhe për të dhënë fryte» (FRANÇESKU, *Lumen fidei*, 27).

thirrjes martesore.¹⁰ Do të ishte e volitshme të fillohej një bashkëpunim me shoqata dhe lëvizje laikale për të vënë në jetë ndërhyrjet baritore në sinergji dhe me një shpirt bashkimi kishtar.¹¹

33. Çka i ndihmon shumë të rinjtë është një shoqërim plot afërsi dhe dëshmi. Ngjall gjithmonë interes të madh te të rinjtë kur dëgjojnë drejtpërdrejt bashkëshortët që tregojnë historinë e tyre si çift duke dhënë arsyet e “Po”-së së tyre, ose dëshminë e të fejuarve – edhe të atyre që nuk kanë vendosur ende të martohen – që përpiqen ta jetojnë si të krishterë fejesën, si një kohë e rëndësishme dallimi dhe verifikimi, duke përfshirë ata që kanë bërë zgjedhjen e dëlirësisë përpara martesës dhe që u tregojnë të rinjve arsyet e zgjedhjes së tyre dhe frytet shpirtërore që rrjedhin prej kësaj zgjedhjeje.¹²

34. Të rinjtë kanë nevojë edhe për momente të personalizuar, kushtuar secilit individualisht,¹³ për të ndriçuar dyshimet dhe hutimet, për të përballur frikën dhe pasigurinë, për t’i ndihmuar që të reflektojnë mbi papjekuri të mundshme, për të mësuar se si ta kapërcejnë mbylljen e unit dhe hapjen ndaj dashurisë konkrete ndaj një personi tjetër.¹⁴

35. Shumë të rinj nuk e kuptojnë lidhjen e ngushtë që ekziston midis jetës së fesë dhe jetës afektive. Kultivimi i një dashurie njerëzore, të vërtetë dhe të sinqertë, parapërgatit për takimin me dashurinë më të madhe të Hyjit dhe lehtëson zbulimin ose (rizbulimin) e fesë. Në të njëjtën kohë, të takosh dashurinë e Hyjit dhe të zbulosh (ose të rizbulosh) fenë i jep një kuptim të ri dhe të thellë përvojës së dashurisë njerëzore.¹⁵ Vetë feja zotëron një formë njohjeje të vetën, që vjen nga dashuria dhe

¹⁰ Krh. FRANÇESKU, *Christus vivit*, 242.

¹¹ Khr. FRANÇESKU, *Christus vivit*, 206.

¹² «Është e nevojshme të kujtojmë rëndësinë e virtyteve. Midis tyre, dëlirësia rezulton si gjendje e vyer për rritjen e njëmendtë të dashurisë ndërpersonale. Në lidhje me këtë nevojë, Etërit sinodalë qenë njëmendjeje kur theksuan nevojën për një përfshirje më të madhe të të gjithë bashkësisë» (*Amoris laetitia*, 206).

¹³ Krh. *Lk* 4,40: «E Jezusi i shëronte duke vënë duart mbi secilin prej tyre».

¹⁴ «Është gjithashtu e volitshme të gjenden mënyra, përmes familjeve misionare, familjeve të të fejuarve dhe burimeve të ndryshme baritore, për të ofruar një përgatitje e hershme që e bën dashurinë e tyre të piqet me një shoqërim plot afërsi dhe dëshmi. Shpesh janë shumë të dobishme grupet e të fejuarve [madje edhe ata që nuk kanë vendosur ende të martohen] dhe propozimet e konferencave fakultative rreth një sërë temash që vërtet u interesojnë të rinjve. Megjithatë, janë të domosdoshme disa momente të personalizuar, pasi qëllimi kryesor është të ndihmohet secili që të mësojë të dojë personin konkret me të cilin dëshiron të bashkëndajë gjithë jetën. Të mësosh të duash dikë nuk është diçka që improvizohet, as nuk mund të jetë qëllimi i një kursi të shkurtër para kremtimit të martesës. Njëmend, çdo person përgatitet për martesë që nga lindja. [...] Të gjitha veprimet baritore që synojnë të ndihmojnë bashkëshortët për t’u rritur në dashuri dhe për ta jetuar Ungjillin në familje janë një ndihmë e paçmuar që fëmijët e tyre të përgatiten për jetën e ardhshme martesore» (*Amoris laetitia*, 208).

¹⁵ «Dashuria besnike e Krishtit është drita për të jetuar bukurinë e afektivitetit njerëzor. Në të vërtetë, dimensionin ynë afektiv është një thirrje ndaj dashurisë, e cila dëftohet në besnikëri, në praninë dhe

hapet ndaj dashurisë.¹⁶ Prandaj, të rinjtë, në këtë fazë të hershme, kanë nevojë të udhëhiqen në një rritje harmonike, që bashkon dimensionin njerëzor dhe atë shpirtëror të dashurisë, veçanërisht tek ata që i qasen përgatitjes për martesë me një përvojë shumë të vogullt feje dhe pa marrë pjesë në mënyrë aktive në jetën kishtarë.

36. Për ta përmbledhur, pikësynimet e përgatitjes së hershme janë: a) edukimi i fëmijëve për të vlerësuar veten dhe të tjerët, për ta njohur dinjitetin e tyre dhe respektuar atë të të tjerëve; b) t'u paraqitet fëmijëve antropologjia e krishterë dhe perspektiva thirrore që ndryhet në Pagëzim e që çon në martesë ose në jetën e kushtuar; c) edukimi i adoleshentëve që të priren ndaj afektivitetit dhe seksualitetit në parapamje të thirrjes së ardhshme për një dashuri bujare, ekskluzive dhe besnike (qoftë në martesë, qoftë në meshtari apo në jetën e kushtuar); d) t'u parashtrohet të rinjve një ecje rritjeje njerëzore dhe shpirtërore për të kapërcyer papjekuritë, frikën dhe rezistencat ndaj hapjes kundrejt marrëdhënieve të miqësisë dhe dashurisë, jo posesive apo narcistike, por të lira, bujare dhe dhuruese.

B. Faza e ndërmjetme: pranimi i kandidatëve

37. Faza e ndërmjetme e pranimit mund të ketë kohëzgjatje të ndryshueshme: disa javë për ata që tashmë vijnë nga një ecje formimi të krishterë, disa muaj për ata që, përveçse bëjnë shohitjen e parë në fejesë, kanë nevojë të thellojnë identitetin e vet pagëzimor. Një fazë pranimi mund të ofrohet edhe për çiftet që e fillojnë itinerarin duke u bashkuar me vonesë krahasuar me çiftet e tjera.

38. Momenti i pranimit nuk duhet të kufizohet në një takim formal prezantimi të ndërsjellë dhe në kryerjen e formaliteteve burokratike, por duhet jetuar si kohë takimi dhe njohjeje të personalizuar. Stili i marrëdhënies dhe mirëseardhja që tregohet nga ekipi baritor do të jetë vendimtar. Kjo vlen si për ata që vijnë nga një periudhë formimi të hershëm – dhe për rrjedhojë nga një jetë feje dhe pjesëmarrjeje kishtarë tashmë të konsoliduar –, si për ata që i afrohen bashkësisë së famullisë për herë të parë.¹⁷ Në rastin e dytë, veçanërisht kur bëhet fjalë për njerëzit larg praktikës fetare dhe shpesh edhe nga çfarëdolloj diskutimi fetar, është e rëndësishme që momenti i pranimit të bëhet kumtim i *kerygmës*, në mënyrë që dashuria e

mëshirë» (FRANÇESKU, *Katekezë rreth Urdhërimeve*, 11/B: *Në Krishtin gjen plotësi thirrja jonë bashkëshortore*, 31 tetor 2018).

¹⁶ «Feja shndërron tërë personin, pikërisht për atë që ai është i hapur ndaj dashurisë. Në këtë ndërthurje të fesë me dashurinë kuptohet forma vetjake e njohjes së fesë, forca e saj bindëse, aftësia e saj për të ndriçuar hapat tanë. Feja njihet për atë që është e lidhur me dashurinë, pasi vetë dashuria sjell një dritë. Kuptimi i fesë është ai që lind kur marrim dashurinë e madhe të Hyjit, i cili na shndërron së brendshmi dhe na jep sy të rinj për të parë realitetin» (FRANÇESKU, *Lumen fidei*, 26).

¹⁷ «Bashkëpunëtorët dhe përgjegjësit [...] si edukatorë, duhet të kenë edhe aftësinë për të mirëpritur të fejuarit, pavarësisht prejardhjes së tyre social-kulturore, formimit intelektual dhe aftësive të tyre konkrete» (KËSHILLI PAPANOR PËR FAMILJEN, *Përgatitja për sakramentin e martesës*, 43).

mëshirshme e Krishtit të përbëjë “vendin shpirtëror” autentik ku mirëpritet çifti.¹⁸

39. Jo vetëm “shpallja e parë” e fesë ka karakter *kerigmatik*, por është me rëndësi që vetë sakramenti i Martesës të bëhet objekt i një shpalljeje të vërtetë nga vetë Kisha, veçanërisht ndaj njerëzve të cilëve u mungon një përvojë e pjekur feje dhe përfshirjeje kishtarë. Ata duhet të mund ta shohin te çiftet tashmë të martuara, dhe ta përjetojnë vetë ata, se jeta bashkëshortore është përgjigjja e pritshmërive më të thella të personit njerëzor në dëshirën e tij për reciprocitet, bashkim dhe frytshmëri, fizike dhe shpirtërore.¹⁹ Kësisoj, propozimi kateketik, do të përpiket të nxjerrë në pah natyrën bashkëshortore dhe familjare të dashurisë dhe do të nxjerrë në dritë të gjitha karakteristikat e veçanta: tërësinë, përplotësinë, unicitetin, karakterin përfundimtar, besnikërinë, frytshmërinë, karakterin publik. “Kumtimi ungjillor” mbi martesën do të tregojë se këto janë karakteristika që burojnë nga dinamizmi i brendshëm i dashurisë njerëzore. Kjo do të thotë se besnikëria, uniciteti, karakteri përfundimtar, frytshmëria, tërësia, janë në fund “dimensionet thelbësore” të çdo lidhjeje dashurie autentike, të kuptuar, të dëshiruar dhe të jetuar në mënyrë koherente nga një burrë dhe një grua dhe jo vetëm “notat karakteristike” të martesës “katolike”. Për rrjedhojë, sakramenti i Martesës mund t’u paraqitet çifteve jo thjesht si një detyrim moral ose ligjor për t’iu nënshtruar, por si një dhuratë, një hir i ofruar, një ndihmë që Hyji e vë në dispozicion të tyre pikërisht për të përmbushur nevojat e dashurisë autentike. Si përfundim, baritorja bashkëshortore duhet të ketë gjithmonë një ton të gëzueshëm dhe *kerigmatik* – energjik dhe në të njëjtën kohë propozues – në linjë me çka sugjerohej nga Gjon Pali II dhe Françesku.²⁰ Dëshmia, bukuria dhe forca tërheqëse e familjeve të krishtera mund t’u vijnë në ndihmë barinjve përballë këtyre sfidave.²¹

40. Në këtë moment kur bëhen të njohur çiftet që mund të ftohen në katekumenatin e martesës, vëmendje e veçantë do t’u kushtohet të gjithë atyre që kanë preferuar të bashkëjetojnë pa u martuar, të cilët, megjithatë, mbeten të hapur ndaj mendimit fetar dhe janë të gatshëm për t’iu afruar Kishës. Me një vështrim mirëkuptimi,²² është e udhës që të mirëpritën me ngrohtësi dhe pa legalizëm, duke

¹⁸ «Në gojën e katekistit të kumbojë kurdoherë shpallja e parë: “Jezu Krishti të do, dha jetën e vet për të të shpëtuar dhe tani është i gjallë pranë teje çdo ditë, për të të ndriçuar, për të të forcuar, për të të liruar”. [...] I gjithë formimi i krishterë është para së gjithash thellimi i *kerigmës* që shkon duke u bërë mish gjithnjë e më shumë e më mirë, që nuk pushon kurrë së ndriçuari përkushtimin kateketik dhe që lejon kuptimin si duhet të domethënies së çdo teme që zhvillohet në katekezë. Është shpallja që i përgjigjet mallit për të pafundmen që gjendet në zemrën e çdo njeriu» (FRANÇESKU, *Eoangelii gaudium*, 164-165).

¹⁹ Krh. *Amoris laetitia*, 201.

²⁰ Krh. GJON PALI II, *Familiaris consortio*, 68; FRANÇESKU, *Amoris laetitia*, 1, 59, 200-201.

²¹ «Dëshmia më bindëse e bekimit të martesës së krishterë është jeta e mirë e bashkëshortëve të krishterë dhe e familjes. Nuk ka mënyrë më të mirë për të shprehur bukurinë e sakramentit!» (FRANÇESKU, *Audienca e përgjithshme. Familja - 12. Martesa (I)*, 29 prill 2015).

²² Në këtë përpjekje për mirëkuptim, është e dobishme të merren parasysh vështirësitë subjektive dhe objektive të njerëzve, “vështirësitë për të kuptuar” dhe “vështirësitë për të jetuar” çka propozon

vlerësuar “dëshirën e tyre për të krijuar familje”, duke shmangur ushtrimin e çdo presioni ndaj tyre, por thjesht duke i ftuar për momente dëgjimi dhe reflektimi, duke qartësuar se çdo vendim për kremtimin e Martesës sakramentale do të merret prej tyre, në mënyrë autonome dhe prej bindjes personale, si fryt i kësaj kohe dallimi.²³

41. Mirëpritja mund të bëhet nga një çift i martuar, i shoqëruar, kur është e mundur, nga meshtari. Mund të përbëhet nga disa takime, gjatë të cilave, në një atmosferë të rehatshme dhe vëllazërore, do të bëhet përpjekja për të kuptuar, së bashku me çiftin, arsyet e vërteta pse ata kërkojnë të përgatiten për martesë, ose, gjithsesi, të bëjnë një ecje dallimi. Kjo është koha e përshtatshme për një pastrim nga motivimet e paqarta që mund të jenë në bazë të kërkesës për t’u martuar në Kishë dhe, në rastin e personave që janë larguar nga praktika fetare, për një shpallje të parë të fesë. Çiftit do t’i jepet kohë për t’u menduar së bashku, për të vendosur dhe për të bërë një zgjedhje të vetëdijshme. Kështu, është mirë që dialogu me kandidatët të zhvillohet në disa momente. Për të orientuar dhe për t’i dhënë konkretësi punës introspektive të çiftit, mund të jetë e dobishme të lihet një gjurmë reflektimi në funksion të takimeve të mëvonshme.

42. Si për ata që tashmë jetojnë dimensionin fetar dhe kishtar, ashtu edhe për ata të cilëve u mungon përvoja e fesë, është e rëndësishme që të kenë gatishmërinë e brendshme për të filluar, me anë të katekumenatit të martesës, një ecje feje-kthimi. Vetëm kur çiftet ta kenë pjekur vendimin e tyre për ta vazhduar ecjen e fesë, do të kalohet te faza tjetër.

43. Siç është thënë më lart, prania e shumë në numër sot e personave të pagëzuar, që kërkojnë të martohen në Kishë pa një përvojë të pjekur feje dhe përfshirjeje kishtarë, kërkon një qëndrim baritor me një vëmendje më të madhe ndaj tyre krahasuar me sa është bërë deri tani.²⁴ Do të kihet çdo kujdes i nevojshëm për t’i përballuar këto situata me qëndrimin e duhur, duke shmangur propozimet sipërfaqësore dhe të nxituara, duke parë në to përkundrazi një mundësi të vyer kumtimi dhe afrimi me vëllezërit “e vegjël në fe”, të cilët duhet të shoqërohen drejt plotësisë së jetës së krishterë dhe drejt plotësisë së sakramentit të Martesës²⁵, në atë

Kisha, nën dritën e kriterëve të treguara në *Amoris laetitia*, 301- 303.

²³ «Në të njëjtën kohë, me stilin e Ungjillit, jini të afërm në takimin dhe mirëpritjen e atyre të rinjve që preferojnë të bashkëjetojnë pa u martuar. Ata, në planin shpirtëror dhe moral, janë ndër të varfrit dhe të vegjlit, ndaj të cilëve Kisha, nën gjurmët e Mësuesit dhe Zotit të vet, dëshiron të jetë një nënë që nuk braktis, por afrohet dhe kujdeset. Edhe këta njerëz janë të dashur nga zemra e Krishtit. Kini një vështrim të butë dhe të dhembshur ndaj tyre» (FRANÇESKU, *Fjalimi për pjesëmarrësit në kursin e procesit martesor*, 25 shkurt 2017).

²⁴ Mbi këtë aspekt themelor, i cili nuk mund të anashkalohet për një ripërtëritje të përshtatshme të baritores për përgatitjen për martesë, është shumë e dobishme t’i referohemi dokumentit *Reciprociteti ndërmjet fesë dhe sakramenteve në ekonominë sakramentale* të Komisionit Teologjik Ndërkombëtar, që ka marrë pëlqimin e Atit të Shenjtë më 19 dhjetor 2019.

²⁵ «Të gjitha këto situata duhen përballuar në mënyrë konstruktive, duke u përpjekur që të shndërrohen në mundësi për një ecje drejt plotësisë së martesës dhe të familjes në dritën e Ungjillit.

mënyrë që «çdo burrë dhe grua që martohet, ta kremtojë sakramentin e Martesës jo vetëm në mënyrë të vlefshme, por edhe të frytshme».²⁶

44. Personave të pagëzuar jo-praktikantë, me pak ose aspak përvojë feje, do të jetë më shumë se kurrë e nevojshme t'u drejtohet një ftesë e hapur për të përshkuar një itinerar katekumenal, që synon pranimin e *kerygmës*, formimin e mendjes dhe zemrës sipas mësimëve të Jezusit dhe një përfshirje në jetën e Kishës. Magjisteri i tre Papëve të fundit, në të vërtetë, ka theksuar dhe ripohuar marrëdhënien mes fesë dhe sakramentit të Martesës.²⁷ Prania e një feje të gjallë dhe të shpërfaqur te çiftet është padyshim situata ideale për të mbërritur te martesë me një qëllim të qartë dhe të vetëdijshëm për të kremtuar një martesë të vërtetë: të pazgjidhshme dhe ekskluzive, që synon të mirën e bashkëshortëve dhe hapjen për pasardhësi. Megjithatë, kushti i domosdoshëm për marrjen e sakramentit të Martesës dhe për vlefshmërinë e tij mbetet, jo njëfarë “niveli minimal feje” nga ana e çifteve afër martesës, i përcaktuar a priori,²⁸ por qëllimi i tyre për të bërë atë që Kisha synon të kryejë kur kremtohet martesë me të pagëzuarve.²⁹

Bëhet fjalë për t'i mirëpritur dhe shoqëruar me durim dhe delikatesë. Sikurse bëri Jezusi me gruan samaritane (krh. *Gjn* 4,1-26): i drejtoi një fjalë dëshirës së saj për dashuri të vërtetë, për ta liruar nga gjithçka që ia errësonte jetën dhe për ta udhëhequr kah gëzimi i plotë i Ungjillit» (*Amoris laetitia*, 294).

²⁶ GJON PALI II, *Familiaris consortio*, 68.

²⁷ Krh. GJON PALI II, *Fjalim me rastin e përrurimit të vitit gjyqësor të Gjykatës së Rotës Romake*, 30 janar 2003; BENEDIKTI XVI, *Fjalim me rastin e përrurimit të vitit gjyqësor të Gjykatës së Rotës Romake*, 26 janar 2013; FRANÇESKU, *Fjalim me rastin e përrurimit të vitit gjyqësor të Gjykatës së Rotës Romake*, 23 janar 2015.

²⁸ «Është mirë të përsëritet qartë se cilësia e fesë nuk është kushti thelbësor i pëlqimit martesor, që, sipas doktrinës së gjithmonshme, mund të cenohet vetëm në nivel natyror (krh. *CIC*, kan. 1055 § 1 dhe 2). Njëmend, *habitus fidei* zbrazet në momentin e Pagëzimit dhe vazhdon të ketë një ndikim të mistershëm në shpirt, edhe kur feja nuk është zhvilluar dhe psikologjikisht duket se mungon. Nuk është e pazakontë që personat në prag të kurorëzimit, të shtyrë drejt martesës së vërtetë nga *instinctus naturae*, në momentin e kremtimit, të kenë një vetëdije të kufizuar për plotësinë e planit të Hyjit dhe vetëm më vonë, në jetën familjare, të zbulojnë gjithçka që Hyji Krijues dhe Shëlbues, ka caktuar për ta. Mungesat e formimit në fe, dhe, edhe gabimi në lidhje me unitetin, pazgjidhshmërinë dhe dinjitetin sakramental të martesës e dëmtojnë pëlqimin martesor vetëm nëse përcaktojnë vullnetin (krh. *CIC*, kan. 1099). Pikërisht për këtë arsye, gabimet në lidhje me anën sakramentale të martesës duhen vlerësuar me shumë kujdes» (FRANÇESKU, *Fjalim me rastin e përrurimit të Vitit Gjyqësor të Gjykatës së Rotës Romake*, 22 janar 2016).

²⁹ «I përket doktrinës tradicionale të sakramenteve bindja se, për të dhënë një sakrament, është i nevojshëm të paktën qëllimi për të bërë çka bën Kisha. Të gjitha këto sakramente përbëhen nga tri elemente: nga gjërat që përbëjnë materien, nga fjalët që janë forma dhe nga personi i mbarështuesit që jep sakramentin, me qëllimin për të bërë çka bën Kisha (*cum intentione faciendi, quod facit Ecclesia*). Nëse mungon njëri nga këto elemente, nuk kemi sakrament. Sipas mendimit të përbashkët të teologjisë latine, mbarështuesit e sakramentit të Martesës janë bashkëshortët, të cilët e lidhin reciprokisht martesën. Në rastin e Martesës sakramentale, kërkohet të paktën qëllimi për të realizuar një martesë natyrore. Tani, martesë natyrore, siç kuptohet nga Kisha, përfshin si veçori thelbësore pazgjidhshmërinë, besnikërinë dhe duhet të dojë të mirën e bashkëshortëve dhe pranimin e fëmijëve. Prandaj, nëse qëllimi për të lidhur martesë nuk i përfshin këto veçori, të paktën në mënyrë të heshtur, ekziston një defekt i rëndë në qëllim, në gjendje për të vënë në dyshim vetë ekzistencën e martesës

45. Në nivel baritor, duhen vlerësuar me kujdes situatat e ndryshme në të cilat gjenden ata të pagëzuar që tregojnë një gatishmëri të pamjaftueshme për të besuar.

Në rast se ata refuzojnë në mënyrë të hapur dhe formale çka Kisha synon të kryejë kur kremtohet Martesa, çifti afër kurorëzimit nuk mund të pranohet në kremtimin e sakramentit.³⁰ Ndonjëherë ndodh që ky refuzim të jetë realisht i pranishëm në mendjet dhe zemrat e çiftit në prag të martesës pa qenë edhe ata vetë plotësisht të vetëdijshëm ose pa e shfaqur hapur. Prandaj, është detyrë madhore e punëtorëve baritorë që të nxjerrin në pah qëllimet e njëmendta të çiftit, në mënyrë që ata vetë të ndërjegjësohen për to dhe t'ua shfaqin sinqerisht shoqëruesve të tyre, për të shmangur që përgatitja dhe kremtimi i martesës të reduktohet thjesht në akte të jashtme.

Nëse, përkundrazi, pa mohuar çka Kisha synon të kryejë, ekziston një gatishmëri e papërsosur nga ana e çiftit në prag të martesës, pranimi i tyre në kremtimin e sakramentit nuk duhet të përjashtohet. Punëtorët baritorë duhet ta shfrytëzojnë këtë situatë si një moment të favorshëm për çiftet për të rizbuluar fenë dhe për ta pjekur më shumë, duke u kthyer në rrënjët e Pagëzimit të tyre, duke ringjallur “farën” e jetës hyjnore që tashmë është hedhur në ta dhe duke i ftuar që të reflektojnë mbi zgjedhjen e martesës sakramentale si konsolidim, shenjtërim dhe përmbushje e plotë e dashurisë së tyre.³¹ Vetëm duke rizbuluar dhuratën e të qenurit të krishterë – krijesa të reja, bij të Hyjit, të dashur dhe të thirrur prej Tij – bëhet i mundur një dallim i qartë mbi sakramentin martesor, në vazhdimësi me identitetin përkatës pagëzimor dhe si përmbushje e një thirrjeje specifike prej Hyjit. Rizgjimi i fesë, në të vërtetë, çon natyrshëm në perceptimin e forcës së hirit sakramental të pranishëm në martesë dhe në gatishmërinë për ta pranuar atë në mënyrën më të mirë të mundshme.³²

natyrore, bazë e nevojshme për martesën sakramentale» (KOMISIONI TEOLOGJIK NDËRKOMBËTAR, *Reciprociteti midis fesë dhe sakramenteve në ekonominë sakramentale*, 168).

³⁰ «Qëllimi sakramental nuk është kurrë fryt i një automatizmi, por gjithmonë i një ndërjegjeje të ndriçuar nga feja, si rezultat i një ndërthurjeje njerëzore dhe hyjnore. Në këtë kuptim, bashkimi martesor mund të çmohet i vërtetë vetëm nëse qëllimi njerëzor i çiftit është i orientuar drejt asaj që duan Krishti dhe Kisha» (FRANÇESKU, *Fjalim me rastin e Përrurimit të Vitit Gjyqësor të Gjykatës së Rotës Romake*, 29 janar 2018); «Kur [...] pavarësisht çdo përpjekjeje të bërë, çifti pranë kurorëzimit shfaq një refuzim të qartë dhe formal të asaj çka Kisha synon të kryejë kur kremtohet Martesa e të pagëzuarve, bariu i shpirtrave nuk mund t'i pranojë ata në kremtim. Edhe pse me keqardhje, ai ka për detyrë të mbajë parasysh situatën dhe t'u bëjë të interesuarve të kuptojnë se, duke qenë punët kështu, nuk është Kisha, por janë vetë ata që e pengojnë atë kremtim, sado që vetë e kërkojnë» (*Familiaris consortio*, 68).

³¹ «Në të vërtetë, feja e atyre që i kërkojnë Kishës të martohen mund të jetë në shkallë të ndryshme dhe është detyrë parësore e barinjve ta rizbulojnë, ta ushqejnë dhe ta pjekin. Por ata duhet të kuptojnë edhe arsyet që ia këshillojnë Kishës të pranojë në kremtim edhe ata që janë të gatshëm në mënyrë të papërsosur» (*Familiaris consortio*, 68).

³² «Bashkëshortët e krishterë nuk janë naivë, i dinë problemet dhe rreziqet e jetës. Por nuk kanë frikë të marrin përgjegjësinë e tyre përpara Hyjit dhe shoqërisë. [...] Sigurisht, është e vështirë. Për këtë arsye kemi nevojë për hirin, hirin që na jep sakramenti! Sakramentet nuk shërbejnë për të zbukuar

46. Disa situata, gjithnjë e më të shpeshta në çdo krahinë të botës, meritojnë vëmendje dhe kujdes të veçantë baritor: bëhet fjalë për ato çifte në të cilat njëra palë është e krishterë dhe tjetra e një feje jo të krishterë, ose në të cilat njëra palë është katolike, ndërsa tjetra është i një konfesionit tjetër të krishterë, jo katolik. Ashtu siç mund të ketë çifte, ku të dyja palët janë katolike, por njëra prej tyre refuzon të ndjekë rrugëtimin katekumenal. Në të gjitha këto raste, do të jetë detyrë e presbiterit të vlerësojë mënyrën më të mirë për të vazhduar përgatitjen për martesë.

47. Në përfundim të fazës së pranimit, në rast se do të jetë pjekur vendimi për të hyrë në itinerarin katekumenal, çifti do të fillojë periudhën e parë të formimit për martesë (përgatitja e afërt). Ky hap mund të shprehet me një rit të hyrjes në katekumenatin e mirëfilltë. Mund të bëhet me thjeshtësi, duke ia paraqitur çiftet bashkësisë gjatë kremtimit të së dielës, me formula të shkurtra, një lutje e përshtatshme për atë qëllim dhe ndonjë gjest konkret, për shembull dorëzimi i Biblës; duke shmangur, megjithatë, që ky rit të duket në ndonjë mënyrë si “rit martesë”. Duhet të jetë e qartë për bashkësinë se këto çifte po hyjnë në rrugëtimin katekumenal, si kohë dallimi për zgjedhjen e martesës. Si alternativë, veçanërisht nëse për arsye kulturore do të ishte më e përshtatshme shmangia e një rituali “publik” dhe bashkësior, mund të ftohen çiftet në një moment lutjeje më të ngushtë, brenda grupit të katekumenëve të rinj, së bashku me ekipin e shoqëruesve dhe t’u dorëzohet atyre Bibla ose një simbol tjetër i përshtatshëm për rastin.

C. Faza katekumenale

48. Katekumenati do të jetë një kohë formimi pak a shumë e gjatë që përfshin përgatitjen e afërt, përgatitjen e menjëhershme dhe shoqërimin në vitet e para të martesës. Udhëzimet që vijojnë synojnë të jenë vetëm orientuese dhe do të zbatohen me dije baritore sipas mundësive konkrete që paraqiten në çdo Kishë vendore.

Në përgjithësi, sugjerohet që përgatitja e afërt të zgjasë afërsisht një vit, në varësi të përvojës së mëparshme të fesë dhe përfshirjes kishtare të çiftit. Si të merret vendimi për t’u martuar – moment që mund të vuloset nga riti i fejesës – mund të fillojë përgatitja e menjëhershme për martesë, që zgjat disa muaj, që duhet qasur si një hyrje e mirëfilltë drejt sakramentit të Martesës. Kohëzgjatja e këtyre etapave do të duhet të përshtatet, e përsërisim, duke marrë parasysh aspektet fetare, kulturore, sociale të ambientit ku jeton dhe madje të situatave personale të çdo çifti. Çka është thelbësore është ruajtja e ritmit të takimeve për t’i mësuar çiftet që të kujdesen me përgjegjësi për thirrjen dhe martesën e tyre.

[nga jashtë] jetën [...] hiri nuk është për të zbukuruar jetën, është për të na forcuar në jetë, për të na bërë të guximshëm, për të qenë në gjendje që të ecim përpara! [...] Të krishterët martohen duke marrë Sakramentin sepse janë të vetëdijshëm se kanë nevojë për të! Kanë nevojë për të qenë të bashkuar me njëri-tjetrin dhe për të përmbushur misionin e prindërve. “Në gëzim e në dhimbje, në shëndet të mirë dhe në sëmundje”» (FRANÇESKU, *Fjalimi drejtuar familjeve në shtegtimin në Romë në Vitin e Fesë*, 26 tetor 2013).

Etapa e parë: përgatitja e afërt

49. Katekumenati martesor në këtë etapë do të marrë karakterin e një itinerari të vërtetë feje, gjatë të cilit mesazhi i krishterë duhet të rizbulohet dhe ripropozohet në risinë dhe freskinë e vet të përhershme.³³ Së bashku me ripropozimin e një katekeze të hyrjes së krishterë në fe, do të vazhdohet me rishikimin e sakramenteve të hyrjes në jetën e krishterë – Pagëzimi, Përforcimi dhe Eukaristia – dhe të sakramentit të Pajtitimit. Si pikë referimi e vazhdueshme për çiftet do të jenë Shkrimet e Shenjta, veçanërisht Zanafilla, Profetët, Kënga e Këngëve, që përmbajnë tekste dhe simbolika bazike për sakramentin e Martesës. Për më tepër, kandidatët për martesë do të njihen gradualisht me lutjen e krishterë – individuale, bashkësiore dhe në çift – në mënyrë që të mësohen me lutjen, që do të jetë një mbështetje e madhe për jetën e ardhme bashkëshortore, veçanërisht në momentet e vështira.³⁴ Në këtë fazë, nuk duhet lënë pas dore përgatitja për misionin specifik të bashkëshortëve, pasi martesa është një sakrament për misionin.³⁵

50. Çiftet do të ndihmohen për t'u afruar me jetën kishtare dhe për të marrë pjesë në të.³⁶ Me delikatesë dhe ngrohtësi njerëzore, mund të ftohen për të marrë pjesë në momentet e lutjes, në Eukaristinë e së dielës, në Rrëfim, në tërheqjet shpirtërore, por edhe në momente feste dhe hareje të përbashkët. Propozimi do të zbatohet gradualisht (sipas përvojës konkrete të njerëzve), në mënyrë që çdo çift të ndihmohet për t'u ndjerë mirë në fushat e ndryshme të jetës së bashkësisë – si ajo e liturgjisë, bamirësisë, bashkimit – pa shtrëngime e sforcime, por, përkundrazi, duke

³³ «Në kurset e përgatitjes për martesë është e domosdoshme të rimerret *katekeza e hyrjes së krishterë në fe*, përmbajtjet e së cilës nuk duhet të merren si të mirëqena ose sikurse të ishin përvetësuar tashmë nga të fejuarit. Në fakt, të shumtën e herës, mesazhi i krishterë është i gjithi për t'u rizbuluar për ata që kanë ngelur te disa nocione elementare të katekizmit të Kungimit të parë dhe, në rastin më të mirë, të Krezmimit» (FRANÇESKU, *Fjalimi drejtuar pjesëmarrësve në kursin dioqezan të formimit për martesën dhe familjen, i promovuar nga Gjykata e Rotës Romake*, 27 shtator 2018).

³⁴ «Rrugëtimi përgatitor për martesë duhet qasur [...] duke u përqendruar edhe këtu te thelbësorja: Bibla, për t'u rizbuluar së bashku, në mënyrë të vetëdijshme; lutja, në dimensionin e vet liturgjik, por edhe në atë të "lutjes shtëpiake", për t'u jetuar në familje, sakramentet, jeta sakramentale, Rrëfimi, [...] ku Zoti vjen për të banuar në të fejuarit dhe i përgatit për ta mirëpritur me të vërtetë njëri-tjetrin "me hirin e Krishtit"» (FRANÇESKU, *Audienca e përgjithshme. Familja - 16. Fejesa*, 27 maj 2015).

³⁵ «Vendimi për t'u "martuar në Zotin" përmban edhe një dimension misionar, që do të thotë të kesh në zemër gatishmërinë për të qenë ndërmjetës të bekimit të Hyjit dhe hirit të Zotit për të gjithë. Njëmend, bashkëshortët e krishterë marrin pjesë si bashkëshortë në misionin e Kishës. [...] Kisha, për t'u ofruar të gjithëve dhuratën e fesë, të dashurisë dhe shpresës, ka nevojë edhe për besnikërinë e guximshme të bashkëshortëve ndaj hirit të sakramentit të tyre! Populli i Hyjit ka nevojë për ecjen e përditshme në fe, dashuri dhe shpresë, me të gjitha gëzimet dhe mundimet që kjo ecje bashkëmbart në martesë dhe në familje» (FRANÇESKU, *Audienca e përgjithshme. Familja - 13. Martesa (II)*, 6 maj 2015); krh. edhe *Familiaris consortio*, 50; *Amoris laetitia*, 121.

³⁶ «Po ashtu u theksua nevoja për programe të posaçme për përgatitjen e afërt për martesë që të jenë një përvojë e vërtetë pjesëmarrjeje në jetën kishtare dhe që thellojnë aspektet e ndryshme të jetës familjare» (*Amoris laetitia*, 206).

u ndier objekt i një mëshire “të pamerituar, të pakushtëzuar dhe falas”³⁷ për marrjen e thirrjes dhe dhuratën e të qenurit pjesë e familjes së madhe të dishepujve të Krishtit.

51. Përveç rimarrjes së hyrjes së krishterë në fe, përgatitja e afërt do të kujdeset edhe për një hyrje në sakramentin e Martesës. Për këtë arsye do të jetë thelbësore që në këtë etapë të përgatitet një itinerar reflektimi mbi të mirat përkatëse të martesës, në mënyrë që brezat e rinj të çifteve t’i afrohen sakramentit më me vetëdije, duke njohur shënimet thelbësore që e bëjnë të tillë, hiret që rrjedhin prej tij dhe të mirat që përfshin, duke qenë në gjendje kështu të përgatiten për t’i pranuar këto hire dhe për t’i përqaftuar këto të mira si dhuratë.³⁸

52. Në këtë fazë do të jetë e rëndësishme të thellohet gjithçka që lidhet me marrëdhënien në çift dhe dinamikat ndërpersonale që ajo bashkëmbart, me “rregullat” e veta, ligjet e rritjes, elementet që e forcojnë dhe ato që e dobësojnë. Do të jetë shumë e dobishme të njihen më në thellësi prirjet e ndryshme psikologjike dhe afektive tipike të burrit dhe gruas, ndjeshmëria e ndryshme e tyre, mënyra e ndryshme e krijimit dhe e kultivimit të marrëdhënies, “nuancat” tipike të shpirtit mashkullor dhe femëror që hyjnë në lojë në çdo marrëdhënie dyshe.³⁹ Realiteti antropologjik i personit njerëzor në përgjithësi, dhe i dy sekseve në veçanti, krijuar dhe dashur nga Hyji, duhet të njihet dhe të kuptohet mirë, sepse përbën “materialin njerëzor” që shërben si bazë e marrëdhënies bashkëshortore. Ekziston një “e vërtetë” e personit njerëzor, ashtu si dhe një “e vërtetë” specifike e të qenurit burrë dhe grua, që duhen njohur dhe pranuar, pasi gjithçka që shkon kundër këtyre “të vërtetave” dhe i shkel ato, edhe brenda martesës, përfton shqetësim dhe vuajtje.⁴⁰

53. Ka edhe shumë aspekte të tjera që lidhen me realitetin njerëzor të personit dhe çiftit që duhen thelluar në mënyrën e duhur: dinamikat njerëzore të seksualitetit bashkëshortor, konceptimi i drejtë i atësisë-mëmësisë së përgjegjshme, edukimi i fëmijëve. Katekeza dhe mësimet e krishtera do të kontribuojnë në konsolidimin e

³⁷ *Amoris laetitia*, 296-297.

³⁸ «Ka disa mënyra legjitime të organizimit të përgatitjes për martesë dhe secila Kishë vendore do të bëjë dallim se cila është më e mirë, duke marrë masa për një formim të përshtatshëm që në të njëjtën kohë nuk i largon të rinjtë nga sakramenti. [...] Bëhet fjalë për një lloj “hyrjeje” për në sakramentin e Martesës, e cila u ofron atyre elementet e nevojshme për të qenë në gjendje që ta pranojnë me gatishmërinë më të mirë dhe ta fillojnë me një farë baze të shëndoshë jetën familjare». (*Amoris laetitia*, 207).

³⁹ «Fejesa [...] është koha në të cilën të dy janë të thirrur të bëjnë një punë të mirë për dashurinë, një punë pjesëmarrëse dhe e bashkëndarë, që shkon në thellësi. Dalëngadalë zbulohet njëri-tjetri, pra burri “mëson” si është gruaja duke njohur këtë grua, e fejuara e tij; dhe gruaja “mëson” si është burri duke njohur këtë burrë, i fejuari i saj. Të mos e nënvlerësojmë rëndësinë e këtij mësimi: është një angazhim i bukur dhe vetë dashuria e kërkon këtë gjë» (FRANÇESKU, *Audienca e përgjithshme. Familja - 16. Fejesa*, 27 maj 2015).

⁴⁰ Krh. *Amoris laetitia*, 133-141.

njohjes së të vërtetës që lidhet me martesën dhe formimin e ndërgjegjes personale.⁴¹ Në këtë fazë, do të jetë me vlerë të çmohet përvoja e bashkëshortëve që tashmë kanë disa vite martesë mbi shptatulla.

54. I përket kësaj pune thellimi të realitetit njerëzor të personit dhe çiftit, ndërgjegjësimi për çdo mangësi psikologjike dhe/ose afektive të mundshme që mund të dobësojnë apo edhe të zbehin plotësisht angazhimin e dhurimit dhe të dashurisë së ndërsjellë që bashkëshortët i premtojnë njëri-tjetrit. Megjithatë, zbulimi i mangësive të mundshme personale nuk duhet patjetër të zgjidhet me braktisjen e zgjedhjes së jetës martesore, por mund të jetë stimuli për të filluar një proces më serioz rritjeje që përgatit për të arritur një konditë të mjaftueshme lirie të brendshme dhe pjekurie psikologjike për të përqaftuar me gëzim dhe qetësi jetën bashkëshortore.⁴²

55. Objektivi specifik i kësaj etape është të finalizojë dallimin e çdo çifti rreth thirrjes së tyre martesore. Kjo gjë mund të çojë në vendimin e lirë, të përgjegjshëm dhe të mirëpeshuar për të lidhur martesë, ose mund të çojë në vendimin, po aq të lirë dhe të mirëpeshuar, për t'i dhënë fund marrëdhënies dhe për të mos u martuar. Për t'i ofruar çiftit "materialin" shoshitës, në këtë etapë do të thellohet jo vetëm teologjia e martesës, por edhe shumë aspekte të tjera që lidhen me "praktikimin" e jetës martesore: synimet në lidhje me vullnetin për t'u përkushtuar për gjithë jetën dhe në lidhje me pasardhësinë, papërputhshmëritë e mundshme, pritshmëritë dhe vizionin personal që ka secili për dashurinë dhe jetën bashkëshortore. Bëhet fjalë për t'i bërë që ta kuptojnë ndryshimin midis "përgatitjes për ditën e dasmës" (*preparation of a wedding*) dhe "përgatitjes për jetën martesore" (*preparation to a marriage*).

Bashkëshortët e ardhshëm do të ftohen të dallojnë me realizëm dhe sinqeritet – secili më vete dhe së bashku – nëse ecja martesore përkon me atë që ata dëshirojnë dhe për të cilën Zoti i thërret.⁴³ Ky dallim, që duhet zhvilluar edhe në kuadrin e

⁴¹ «Përgatitja e afërt, e cila - nga mosha e duhur dhe me një katekezë të përshtatshme, si në një ecje katekumenale - përfshin një përgatitje më të posaçme për sakramentet, pothuajse një rizbulim të tyre. Kjo katekezë e përtërirë e atyre që përgatiten për martesën e krishterë është patjetër e nevojshme që sakramenti të kremtohet dhe të jetohet me gatishmërinë e duhur morale dhe shpirtërore. Formimi fetar i të rinjve duhet të integrohet, në kohën e përshtatshme dhe sipas nevojave të ndryshme konkrete, me një përgatitje për jetën dyshe, e cila, duke e paraqitur martesën si një marrëdhënie ndërpersonale të burrit dhe gruas që duhet zhvilluar vazhdimisht, i nxit për të thelluar problemet e seksualitetit bashkëshortor dhe atësisë së përgjegjshme, me njohuritë thelbësore mjeko-biologjike që lidhen me të, dhe që çon në një familjaritet me metodat e drejta të rritjes së fëmijëve, duke favorizuar përvetësimin e elementeve bazë për një qasje të rregullt të familjes» (*Familiaris consortio*, 66); krh. edhe KËSHILLI PARNOR PËR FAMILJEN, *Përgatitja për sakramentin e martesës*, 35.

⁴² Krh. KËSHILLI PARNOR PËR FAMILJEN, *Përgatitje për sakramentin e martesës*, 36.

⁴³ «Përgatitja e atyre që kanë zyrtarizuar tashmë fejesën, kur bashkësia famullitare arrin t'i ndjekë që me kohë, duhet t'u japë edhe mundësinë e njohjes së papajtueshmërive dhe rreziqeve. Në këtë mënyrë mund të kuptojnë se nuk është e arsyeshme fokusimi tek ajo marrëdhënie, që të mos ekspozohen ndaj një dështimi të parashikueshëm që do të ketë pasoja shumë të dhimbshme. Problemi është se lëbyrja fillestare çon në përpjekjen për të fshehur apo relativizuar shumë gjëra;

dialogut shpirtëror, personal dhe në çift, nuk duhet nënvlerësuar, duke qenë se përvoja e gjykatave kishtare tregon brishtësinë ekstreme të çifteve që, pavarësisht fesë dhe entuziazmit fillestar, u mungojnë rekuizitat bazë që do të kishin qenë të nevojshme për të lidhur martesën: aftësia dhe vullneti.⁴⁴

56. Çdo person do të shoqërohet në ecjen e vet të reflektimit, kthimit dhe kuptimit të domethënies së jetës martesore, duke ndjekur gjithmonë logjikën e respektit, durimit dhe mëshirës.⁴⁵ Mirëpo, logjika e mëshirës nuk çon kurrë në errësimin e «kërkesave të së vërtetës dhe dashurisë së Ungjillit të propozuara nga Kisha»,⁴⁶ dhe nuk duhet hequr askurrë dorë së propozuari, në gjithë bukurinë dhe madhështinë e vet, plani hyjnor mbi dashurinë njerëzore dhe martesën.⁴⁷ Idealet më të larta dhe më fisnike mund të duken kërkuese dhe të mundimshme, por janë gjithashtu ato që e tërheqin më fuqishëm shpirtin njerëzor, e stimulojnë të tejkalojë vetveten dhe i japin vlerë dhe dinjitet ekzistencës sonë tokësore.

57. Në lidhje me këtë gjë, Kishës nuk duhet t'i mungojë kurrë guximi për të

shmangen divergjencat dhe kështu vështirësitë veçse përcillen përpara. Të fejuarit duhet të stimulohen dhe të ndihmohen që të jenë në gjendje të shprehin çka secili pret nga një martesë e mundshme, mënyrën e tyre të të kuptuarit se çfarë është dashuria dhe angazhimi, çfarë pret nga tjetri, mënyrën e jetesës së përbashkët që do të donin të planifikonin. Këto biseda mund të ndihmojnë për të parë se në realitet pikat e kontaktit janë të pakta dhe se vetëm tërheqja e ndërsjellë nuk do të mjaftojë për të mbështetur bashkimin. Asgjë nuk është më e paqëndrueshme, e pasigurtë dhe e paparashikueshme se dëshira, dhe nuk duhet nxitur kurrë vendimi për t'u lidhur në martesë nëse nuk janë thelluar arsye të tjera që i japin atij pakti mundësi reale stabiliteti» (*Amoris laetitia*, 209).

⁴⁴ *Ius connubii* (e drejta e martesës) nuk përbën «një pretendim subjektiv që duhet të plotësohet nga barinjët përmes njohjes së thjeshtë formale, pavarësisht nga përmbajtja konkrete e bashkimit. E drejta për t'u lidhur në martesë kërkon si kusht paraprak që ajo të mund dhe të synohet për t'u kremtuar përnjëmend, pra, në të vërtetën e thelbit të saj siç mëson Kisha. Askush nuk mund ta pretendojë të drejtën e një ceremonie martesore. *Ius connubii*, në të vërtetë, i referohet të drejtës për të kremtuar një martesë autentike. Kësisoj, nuk mohohet *i us connubii* aty ku është e qartë se nuk janë të pranishme premiset për ushtrimin e saj, nëse mungon, domethënë, qartësisht aftësia e kërkuar për t'u martuar, ose vullnetit t'i vendoset një qëllim që është në kontrast me realitetin natyror të martesës» (BENEDIKTI XVI, *Fjalimi me rastin e përvurimit të Vitit Gjyqësor të Gjykatës së Rotës Romake*, 22 janar 2011).

⁴⁵ «Duke shoqëruar me mëshirë dhe durim etapat e mundshme të rritjes së personave që po ndërtohen dita-ditës [duke i lënë hapësirë] mëshirës së Zotit që na nxit të bëjmë të mirën e mundshme» (*Amoris laetitia*, 308); krh. edhe *Amoris laetitia*, 295.

⁴⁶ *Amoris laetitia*, 300.

⁴⁷ «Kisha në asnjë mënyrë nuk duhet të heqë dorë nga propozimi i idealit të plotë të martesës, i planit të Hyjit në gjithë madhështinë e tij: të rinjtë e pagëzuar duhen inkurajuar që të mos ngurrojnë përballë visarit që sakramenti i Martesës u ofron atyre për planet e tyre të dashurisë, të forcuar nga mbështetja që marrin nga hiri i Krishtit dhe mundësia për të marrë pjesë plotësisht në jetën e Kishës. Vaktësia, çdo formë relativizmi, apo respekti i tepruar te momenti i propozimit, do të ishte mungesë besnikërie ndaj Ungjillit dhe gjithashtu mungesë dashurie e Kishës ndaj vetë të rinjve. Të kuptuarit e situatave të jashtëzakonshme nuk nënkupton kurrë fshehjen e dritës së idealit më të plotë ose të propozohet më pak se ajo që Jezusi i ofron qenies njerëzore. Sot, më e rëndësishme se kujdesi baritor ndaj dështimeve është përpjekja baritore për të konsoliduar martesat dhe për të parandaluar kështu ndarjet» (*Amoris laetitia*, 307).

propozuar virtytin e çmuar të dëlirësisë,⁴⁸ pavarësisht se kjo tashmë është në kontrast të drejtpërdrejtë me mendësinë e përbashkët. Dëlirësia duhet paraqitur si një “aleate autentike e dashurisë”, jo si mohim i saj. Njëmend, është mënyra e privilegjuar për të mësuar se si respektohet individualiteti dhe dinjiteti i tjetrit, pa e nënshtruar ndaj dëshirave vetjake. Dëlirësia u mëson çifteve që duan të martohen kohët dhe mënyrat e dashurisë së vërtetë, delikate dhe bujare dhe i përgatit për dhurimin autentik të vetvetes për ta jetuar pastaj për gjithë jetën në martesë.⁴⁹ Prandaj, është e rëndësishme të tregohet se virtyti i dëlirësisë nuk ka vetëm një dimension negativ [mohues] që i kërkon gjithsecilit, sipas gjendjes së tij të jetës, të përmbahet nga një përdorim i çrregullt i seksualitetit, por përmban edhe një dimension pozitiv shumë të rëndësishëm të lirisë nga të zotëruarit e tjetrit – nga pikëpamja fizike, morale dhe shpirtërore – që, në rastin e thirrjes për martesë, ka një rëndësi themelore për orientimin dhe ushqyerjen e dashurisë bashkëshortore, duke e ruajtur atë nga çdo manipulim. Në analizë të fundit, dëlirësia na mëson, në çdo gjendje të jetës, të jemi besnikë ndaj së vërtetës së dashurisë sonë. Për të fejuarit kjo gjë do të thotë ta jetojnë dëlirësinë në përkore dhe, si të martohen, ta jetojnë intimitetin bashkëshortor me drejtësi morale.⁵⁰

Dëlirësia e jetuar në përkore lejon që marrëdhënia të piqet gradualisht dhe në një mënyrë të thelluar. Kur, në të vërtetë, siç ndodh shpesh, dimension i seksual-gjenital bëhet elementi kryesor, në mos i vetmi, që e mban të bashkuar një çift, të gjitha aspektet e tjera kalojnë, në mënyrë të pashmangshme, në plan të dytë ose errësohen dhe marrëdhënia nuk përparon. Përkundrazi, dëlirësia e jetuar në përkore, lehtëson njohjen e ndërsjellët mes të fejuarve, sepse duke shmangur që marrëdhënia të fiksohet te shfrytëzimi fizik i tjetrit, mundëson një dialog më të thelluar, një shfaqje më të lirë të zemrës dhe shfaqjen e të gjitha aspekteve të personalitetit përkatës –

⁴⁸ «Duhet të kujtojmë rëndësinë e virtyteve. Midis tyre, dëlirësia është një kusht i çmuar për rritjen e njëmendtë të dashurisë ndërpersonale» (*Amoris laetitia*, 206); «Dëlirësia është liri prej zotërimit në të gjitha fushat e jetës. Vetëm kur një dashuri është e dëlirë është dashuri e vërtetë. Dashuria që dëshiron të zotërojë në fund bëhet gjithmonë e rrezikshme, burgos, mbytur, sjell palumturi. Vetë Hyji e deshi njeriun me dashuri të dëlirë, duke e lënë gjithashtu të lirë të gabojë dhe të vihet kundër Tij. Logjika e dashurisë është gjithmonë një logjikë lirie» (*Patris corde*, 7).

⁴⁹ «Në këtë periudhë nuk mund të mungojë edukimi i drejtë dhe i guximshëm për dëlirësinë, për dashurinë si dhurim i vetvetes. Dëlirësia nuk është mohim i dashurisë, por kusht i dashurisë autentike. Njëmend, nëse thirrja për dashurinë bashkëshortore është thirrja e dhurimit të vetvetes në martesë, është e nevojshme të arrihet zotërimi i vetvetes për t’u dhuruar me të vërtetë» (KËSHILLI PAPANOR PËR FAMILJEN, *Përgatitja për Sakramentin e Martesës*, 24).

⁵⁰ «Dëlirësia duhet t’i dallojë personat në gjendjet e tyre të ndryshme të jetës: disa në virgjërinë ose në celibatin e kushtuar, një mënyrë e shquar kjo për t’iu kushtuar më lehtë vetëm Hyjit, me zemër të pandarë; të tjerët në mënyrën që është caktuar për të gjithë nga ligji moral, qofshin ata të martuar apo beqarë. Personat e martuar janë të thirrur të jetojnë dëlirësinë bashkëshortore; të tjerët praktikojnë dëlirësinë në përkore [...] Të fejuarit janë të thirrur ta jetojnë dëlirësinë në përkore. Të vënë kështu në provë, ata do të zbulojnë respektin reciprok, do të stërviten në besnikërinë dhe në shpresën që do ta marrin njëri-tjetrin prej Hyjit. Shfaqjet e ëmbla, që janë tipike të dashurisë bashkëshortore, do t’i ruajnë për kohën e martesës. Ata do ta ndihmojnë reciprokisht njëri-tjetrin që të rriten në dëlirësi» (KATEKIZMI I KISHËS KATOLIKE, 2349-2350).

njerëzore dhe shpirtërore, intelektuale dhe emocionuese – në mënyrë të tillë që të lejojë rritjen e vërtetë në marrëdhënie, në bashkimin personal, në zbulimin e pasurisë dhe limiteve të tjetrit: dhe në këtë qëndron qëllimi i vërtetë i kohës së fejesës.⁵¹

Edhe në rastin kur u flasim çifteve që bashkëjetojnë, nuk është kurrë e kotë të flasim për virtytin e dëlirësisë. Ky virtyt i mëson çdo të pagëzuari, në çdo gjendje të jetës, që ta ushtrojë drejt seksualitetin e vet dhe për këtë arsye, edhe në jetën si të martuar, është jashtëzakonisht i dobishëm. Njëmend, si bashkëshortë, shfaqet edhe më dukshëm rëndësia e atyre vlerave dhe kujdeseve që virtyti i dëlirësisë mëson: respektin për tjetrin, kujdesin për të mos e nënshtruar atë askurrë ndaj dëshirave vetjake, durimin dhe butësinë me bashkëshortin/en në momente vështirësie, fizike dhe shpirtërore, forcën dhe vetë-sundimin e nevojshëm në kohë mungese a sëmundjeje të njërit prej bashkëshortëve etj.⁵² Edhe në një kontekst të tillë, përvoja e bashkëshortëve të krishterë do të jetë e rëndësishme për të shpjeguar rëndësinë e këtij virtyti brenda martesës dhe familjes.

58. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet metodës shpirtërore që duhet ndjekur gjatë kësaj etape të përgatitjes së afërt. Në këtë kohë formimi dhe hyrjeje, është e nevojshme që përcimi i përmbajtjeve teorike të shoqërohet me propozimin e një ecjeje shpirtërore që parashikon përvoja lutjeje (personale, bashkësiore dhe në çift), kremtimin e sakramenteve, tërheqje shpirtërore, momente adhurimi eukaristik, përvoja misionare, aktivitete bamirësie (në varësi të konteksteve baritore).

59. Në mbarim të kësaj etape dhe si shenjë e hyrjes në etapën tjetër të përgatitjes së menjëhershme, mund të bëhet riti i fejesës. Ky rit – me bekimin e të fejuarve dhe unazave të fejesës (aty ku përdoret ky zakon) – merr kuptimin e vet të plotë vetëm kur kremtohet dhe jetohet në fe, pasi në atë moment i kërkohen Zotit ato hire të nevojshme për t'u rritur në dashuri dhe për t'u përgatitur denjësisht për sakramentin e Martesës.⁵³ Zgjedhja e momentit më të përshtatshëm për kremtimin e këtij riti do të jetë e personalizuar, pas bisedimit me anëtarët e ekipit të shoqëruesve dhe mbarështuesin e urdhëruar.

60. Riti i fejesës, në vlerën e vet personale dhe kishtare, duhet patjetër të rivlerësohet si një moment domethënës në ecjen e fesë drejt sakramentit të Martesës. Në këtë rit Kisha “u dorëzon” çifteve misionin e fejesës, që qëndron te dallimi. Duke ritualizuar këtë moment, çiftet ndërjegjësohen më shumë për faktin se në muajt në vijim janë të thirrur që të arrijnë një siguri të brendshme lidhur me vendimin për t'u

⁵¹ «Po, shumë çifte qëndrojnë së bashku për një kohë të gjatë, ndoshta edhe në intimitet, ndonjëherë duke bashkëjetuar, por nuk njihen me të vërtetë. Duket e çuditshme, por përvoja tregon se kështu është. Për këtë arsye, duhet të rivlerësohet fejesa si një kohë njohjeje e ndërsjellët dhe e bashkëndarjes së një plani» (FRANÇESKU, *Audienca e përgjithshme. Familja - 16. Fejesa*, 27 maj 2015).

⁵² Krh. KATEKIZMI I KISHËS KATOLIKE, 2348-2350.

⁵³ Krh. BENEDIZIONALE. RITUALE ROMANO, 614, 625.

martuar dhe lidhur me personin me të cilin do të martohen. Nën dritën e gjykimit të matur njerëzor dhe nën dritën e fesë, secili duhet të arrijë të formulojë në zemrën e vet këtë përfundim mbi bashkëshortin e ardhshëm: ai/ajo është partneri/ja që do të jetojë me mua një marrëdhënie dashurie autentike, besnike dhe të qëndrueshme dhe me të cilin/ën të ndërtojmë së bashku familjen tonë të ardhshme; është shoku/shoqja që Zoti më ka dhuruar për të përshkuar së bashku ecjen e shenjtërisë, që do të jetë babai/nëna me mua e fëmijëve që Ai do të na dhurojë dhe me të cilin/cilën do të jetoj për gjithë jetën “misionin” e martesës sonë. Të arrish në këtë siguri është “misioni” i dallimit që Kisha ua beson përgjegjësisë së çifteve, duke i ftuar që ta mirëpresin me seriozitetin e duhur.

61. Riti i fejesës kuptohet edhe si “premtim martese”.⁵⁴ Megjithatë, nga ky premtim, nuk buron aspak detyrimi ligjor për të lidhur martesën dhe ruhet gjithmonë liria e palës në shprehjen e pëlqimit martesor. Për më tepër, kremtimi i ritit nuk duhet të ngatërrohet në asnjë mënyrë me martesën: për këtë arsye rekomandohet që të mos bashkohet kurrë premtimi i martesës apo bekimi i posaçëm i të fejuarve në kremtimin e Meshës.⁵⁵ Skema e kremtimit është mirë të jetë e thjeshtë dhe e përmbajtur: ritet fillestare, shpallja e Fjalës së Hyjit, lutja e besimtarëve, çdo “shenjë e mundshme angazhimi” (p.sh. shkëmbimi i unazave të fejesës), lutja e bekimit dhe mbarimi i ritit. Është e rëndësishme të rikujtojmë në mënyrë të qartë temën e thirrjes martesore dhe që leximet biblike dhe lutjet për çiftet të përqendrohen në dashurinë bashkëshortore, e pastruar, e forcuar, e bërë e qëndrueshme dhe bujare nga e njëjta dashuri e Hyjit e zbrazur në zemrat njerëzore.

62. Fakti që në këtë fazë të itinerarit zyrtarizohet në një farë mënyrë “statusi” i të fejuarve merr një rëndësi të konsiderueshme dhe duhet kuptuar edhe në rëndësinë e vet shoqërore dhe kishtarë. Për bashkëjetuesit, për shembull, mund të jetë një ndihmë për të “objektivizuar” marrëdhënien e tyre – ndoshta e perceptuar nga disa prej tyre vetëm në këndvështrimin personal dhe “privat” – duke i dhënë asaj një frymëmarrje publike, që mund t’i bëjë të ndihen pjesë e një bashkësie mikpritëse, që i shoqëron dhe e ka për zemër bashkimin e tyre. Për të gjithë, është një ftesë për të kuptuar se gjendja e ardhshme e “bashkëshortëve”, për të cilën po përgatiten, shkon përtej një marrëdhënieje afektive, e kufizuar në sferën private të përvojave emocionale dhe do t’i japë jetë një realiteti të ri, familjes, e cila ka një rol shoqëror dhe kishtar themelor.⁵⁶

⁵⁴ « Premtimi i martesës, [...] i quajtur fejesë, rregullohet nga e drejta e veçantë e Konferencës Ipeshkvore, në përputhje me çdo zakon a ligj civil» (CIC, kan. 1062).

⁵⁵ Krh. BENEDIZIONALE. RITUALE ROMANO, 610.

⁵⁶ «Familja po përjeton një krizë të thellë kulturore, ashtu si të gjitha komunitetet dhe lidhjet shoqërore. Në rastin e familjes, dobësimi i këtyre lidhjeve bëhet shumë serioz sepse familja është qeliza themelore e shoqërisë, ku ne mësojmë të jetojmë me të tjerët, pavarësisht nga ndryshimet tona dhe gjithashtu t’i përkasim njëri-tjetrit. Ajo është gjithashtu vendi ku prindërit u përcjellin fenë fëmijëve të tyre. Martesa tani priret që të shihet si një formë e një kënaqjeje emocionale që mund të

63. Duke përmbledhur, synimet e përgatitjes së afërt janë: a) të ripropozohet një katekezë e hyrjes në fenë e krishterë dhe afrim në jetën kishtare; b) të përjetohet një hyrje e posaçme për në sakramentin e Martesës dhe të arrihet në një ndërgjegjësim të qartë të elementeve thelbësore të saj; c) thellimi i temave që lidhen me marrëdhënien në çift dhe ndërgjegjësimi për mangësitë përkatëse psikologjike dhe afektive; d) përfundimi i fazës së parë të dallimit të çiftit në lidhje me thirrjen martesore; e) vazhdimi me më shumë vendosmëri i ecjes shpirtërore.⁵⁷

Etapa e dytë: përgatitja e menjëhershme

64. Në muajt para kremtimit të martesës, zë vend përgatitja e menjëhershme për martesë.⁵⁸ Fillimi i kësaj etape të re mund të shënjohej nga një tërheqje e shkurtër shpirtërore dhe dorëzimi i një objekti simbolik, për shembull një lutje që çiftet do ta lusin së bashku kur të takohen.

65. Do të jetë me vend të rikujtohen përmbajtjet kryesore të ecjes përgatitore të përshkuara deri në atë moment: do të këmbëngulet në kushtet e domosdoshme të lirisë (në çift dhe të çiftit) dhe ndërgjegjësimi i plotë për sa i përket angazhimeve që do të marrin përsipër me zgjedhjen që do të bëjnë lidhur me karakteristikat thelbësore të martesës (pazgjidhshmëria, uniteti, besnikëria, frytshmëria) dhe që do të jenë objekti specifik i bisedimeve kanonike të parashikuara me famullitarin.⁵⁹

Në të njëjtën kohë, do të rikujtohen aspektet doktrimore, morale dhe shpirtërore

ndërtohet në çfarëdo mënyre apo të modifikohet sipas ndjeshmërisë së secilit. Por kontributi i domosdoshëm i martesës ndaj shoqërisë i tejkalon ndjenjat dhe nevojat momentale të çiftit. Sikurse kanë mësuar ipeshkvijtë francezë, nuk lind nga “ndjenja e dashurisë, kalimtare për përkufizim, por nga thellësia e detyrimeve që kanë marrë bashkëshortët duke pranuar një bashkim të plotë jete» (*Evangelii gaudium*, 66).

⁵⁷ Krh. KËSHILLI PARNOR PËR FAMILJEN, *Përgatitje për sakramentin e martesës*, 45-46.

⁵⁸ «Përgatitja e menjëhershme për kremtimin e martesës duhet të zhvillohet në muajt e fundit dhe javët që paraprijnë martesën» (*Familiaris consortio*, 66).

⁵⁹ Është mirë që përmbajtjet e këtyre bisedimeve të bëhen objekt i një katekeze të qartë, në mënyrë që, kur të ndodhin, të mos përjetohej nga çiftet si formalitet e asgjë më shumë, por si një moment i rëndësishëm i pranimit të lirë të angazhimeve martesore dhe marrjes së plotë të përgjegjësisë. Në këtë drejtim, është mirë të kemi parasysh fjalët e Benediktit XVI: «Ndër mjetet për të konstatuar se plani i çiftit është vërtet martesë, spikat shqyrtimi paramartesor. Ky shqyrtim ka një qëllim kryesor juridik: të konstatohet se asgjë nuk e kundërshton kremtimin e vlefshëm dhe të ligjshëm të martesës. Mirëpo, juridik nuk do të thotë formalist, sikur të ishte një hap burokratik që qëndron në plotësimin e një formulari të bazuar në pyetje rituale. Përkundrazi, bëhet fjalë për një rast baritor unik – për t’u vlerësuar me gjithë seriozitetin dhe vëmendjen që kërkon – në të cilin, përmes një dialogu plot respekt dhe përzemërsi, bariu përpiqet të ndihmojë personin që të vihet seriozisht përpara së vërtetës për veten dhe për thirrjen e vet njerëzore dhe të krishterë për martesë. Në këtë kuptim, dialogu i zhvilluar gjithmonë veçmas me secilin nga dy të fejuarit – pa e zvogëluar dobishmërinë e bisedave të tjera me çiftin – kërkon një klimë sinqeriteti të plotë, ku duhet mëshuar mbi faktin se vetë pajtimtarët janë palët e para të përfshira dhe të parët të detyruar në ndërgjegje për të kremtuar një martesë të vlefshme» (BENEDIKTI XVI, *Fjalimi me rastin e Përrurimit të Vitit Gjqësor të Gjykatës së Rotës Romake*, 22 janar 2011).

të martesës. Në këtë mënyrë do të mundësohet rikthimi në mënyrë të dobishme të pikat thelbësore të hyrjes në sakramentin e Martesës të kryer tashmë në fazën e mëparshme të përgatitjes së afërme, ose do të jetë e mundur të paraqitet mirëfilli si një “kumtim i Ungjillit të martesës” për çiftet që nuk vijnë nga një rrugëtim i tillë i mëparshëm.⁶⁰ Për rrethana të ndryshme, në të vërtetë, ka mundësi që disa çifte të përfshihen vetëm tani në itinerarin katekumenal dhe përgatitja e menjëhershme të përbëjë për ta të vetmen mundësi konkrete që të marrin një minimum formimi në funksion të kremtimit të sakramentit të Martesës. Për ta do të ishte e përshtatshme që të parashikoheshin disa takime të personalizuar me ekipin baritor të përgatitjes për martesë ashtu që ta ndiejnë kujdesin dhe vëmendjen, për të thelluar së bashku disa aspekte më personale të zgjedhjes së martesës, sipas realitetit të çiftit (që ndoshta mund të ketë fëmijë dhe bashkëjeton prej kohësh), ashtu që të lindë një marrëdhënie feje, përzemërsie dhe miqësie me çiftet shoqëruese. Në të njëjtën kohë, është e përshtatshme të përfshihen çiftet “e reja” – që nuk kanë bërë ecjen e përgatitjes së afërt – edhe në takime në grup, në mënyrë që të ndihen të mirëpritura dhe të përfshira në kontekstin kishtar në një kohë relativisht të shkurtër.

66. Do të rijetohen, pra, përvojat shpirtërore posaçërisht të menduara për çiftet (dëgjimi i Fjalës, kremtimi i sakramenteve, momente lutjeje personale dhe bashkësore) për të vënë kurdoherë në qendër takimin me Zotin si burim i tërë jetës së krishterë. Njëmend, është gjithmonë e nevojshme për t’u ngritur mbi një vizion të thjeshtë sociologjik të martesës në mënyrë që bashkëshortët ta kuptojnë misterin e hirit që përfshihet në të dhe, më përgjithësisht, për ta kuptuar gjithë dinamikën shpirtërore të jetës së krishterë që qëndron në themel të saj.

67. Kësisoj, do të jetë e dobishme të riformulohet kumtimi *kerigmatik* i shëlbimit të Krishtit, që na shpëton nga realiteti i mëkatit, që gjithmonë i kanoset jetës së njeriut. Bashkëshortët nuk duhet të harrojnë kurrë se mëkati është, në fund të fundit, kërcënimi i vërtetë i dashurisë së tyre.⁶¹ Shumë më e rëndë se çdo mangësi psikologjike, apo se çdo dinamikë e papërsosur ndërpersonale, është largimi nga Hyji, i cili përfiton në zemrën e njeriut një spirale mbylljeje dhe egoizmi që pengon dashurinë e vërtetë, sepse pengon hapjen, respektin, bujarinë ndaj tjetrit. Prandaj, për t’u rritur çdo ditë në dashurinë e ndërsjellë, është e domosdoshme të mbizotërohet, me ndihmën e hirit, mëkati që “struket” pas derës së zemrës (*Zan 4,7*) dhe, për më tepër, të kërkohet falja e Hyjit, i cili, në sakramentin e Pajtimit, e dhuron bujarisht dashurinë e tij që është më e fuqishme se çdo mëkat.⁶²

⁶⁰ Krh. *Amoris laetitia*, 59-66.

⁶¹ Krh. KATEKIZMI I KISHËS KATOLIKE, 1606-1608.

⁶² «Kremtimi i këtij sakramenti merr një kuptim të veçantë për jetën familjare: ndërsa në fe zbulojnë se si mëkati bie ndesh jo vetëm me besëlidhjen me Hyjin, por edhe me besëlidhjen e bashkëshortëve dhe me bashkimin e familjes, bashkëshortët dhe të gjithë anëtarët e familjes drejtohen kah takimi me “Hyjin e pasur me mëshirë” (*Ef 2,4*), i cili, duke e dhuruar bujarisht dashurinë e tij që është më e pushtetshme se mëkati, rindërton dhe përsos besëlidhjen bashkëshortore dhe bashkimin familjar» (*Familiaris consortio*, 58).

68. Duke iu afruar ditës së martesës, do të jetë mirë që çiftet të ndërjegjësohen se nuk janë spektatorë, por, në emër të Krishtit, mbarështues të kremtimit të Martesës së tyre. Prandaj, nga kjo vjen edhe rëndësia e kushtimit të një hapësire të bollshme për përgatitjen liturgjike të çifteve, domethënë për të kuptuar plotësisht gjestet dhe domethënien përkatëse të ritit të martesës.⁶³ Rituali për liturgjinë martesore ka në vetvete një itinerar pedagogjik, që përfshin pasurinë e dimensionit antropologjik (jeta e njerëzve), biblik (plani i Hyjit për familjen), kishtar (misioni i familjes në Kishë dhe në botë), shpirtëror (ecja e kthimit dhe e përgjigjes ndaj veprimit të Shpirtit), e që përbën ravijëzimin e rrugëtimit për këtë etapë. Çiftet do të ndriçohen për vlerën e jashtëzakonshme të “shenjës sakramentale” që jeta e tyre bashkëshortore do të marrë: me ritin e martesës do të bëhen një sakrament i përhershëm i Krishtit që e do Kishën. Ashtu si mbarështuesit e urdhëruar janë të thirrur të bëhen “ikona të gjalla” të Krishtit meshtar, në të njëjtën mënyrë bashkëshortët e krishterë janë të thirrur të bëhen “ikona të gjalla” të Krishtit dhëndër. Më shumë se fjalët, është vetë mënyra e të jetuarit dhe e marrëdhënias mes bashkëshortëve që do duhet t’ia tregojë botës dashurinë bujare dhe të plotë me të cilën Krishti e do Kishën dhe gjithë njerëzimin.⁶⁴ Dhe në të vërtetë kjo është dëshmia e jashtëzakonshme që shumë bashkëshortë të krishterë i japin botës: aftësia e tyre për përkushtim të ndërsjellët dhe ndaj fëmijëve, aftësia e tyre për besnikëri, durim, falje dhe dhembshuri janë të tilla që bën të perceptohet një “burim i mbinatyrshëm” në bazën e marrëdhënies së tyre, një “më shumë”, e pashpjegueshme nga ana njerëzore, që ushqen pandërprerë dashurinë e tyre, deri në atë pikë sa e bën të duket pothuajse heroike.⁶⁵

69. Në funksion të kremtimit të martesës, do të tregohet kujdes që të përfshihen

⁶³ «Në përgatitjen më të afërt është e rëndësishme të formohen bashkëshortët që ta jetojnë me thellësi të madhe kremtimin liturgjik, duke i ndihmuar që ta kuptojnë dhe ta jetojnë domethënien e secilit gjest. Le të kujtojmë se një angazhim kaq i madh si ai që shpreh po-ja e martesës, dhe bashkimi i trupave që konsumon martesën, kur bëhet fjalë për dy të pagëzuar, mund të interpretohen vetëm si shenja të dashurisë së Birit të Hyjit të bërë njeri dhe të bashkuar me Kishën e vet në besëlidhje dashurie. Në të pagëzuarit, fjalët dhe gjestet shndërrohen në një gjuhë që dëfton fenë. [...] Nganjëherë të fejuarit nuk e perceptojnë peshën teologjike dhe shpirtërore të pëlqimit martesor, që ndriçon domethënien e të gjitha gjesteve të mëtejshme. Është e nevojshme të vihet në dukje se ato fjalë nuk mund të kufizohen në të tashmen; ato përbajnë një tërësi që përfshin të ardhmen» (*Amoris laetitia*, 213-214).

⁶⁴ «Sakramenti nuk është një “gjë” apo një “forcë”, sepse në të vërtetë vetë Krishti vjen për t’i takuar bashkëshortët e krishterë [...]. Martesa e krishterë është një shenjë që jo vetëm tregon se sa shumë Krishti e deshi Kishën e tij në Besëlidhjen e vulosur në Kryq, por edhe e bën këtë dashuri të pranishme në bashkimin e bashkëshortëve. Duke u bashkuar në një mish të vetëm ata përfaqësojnë martesën e Birit të Hyjit me natyrën njerëzore. [...] Edhe pse analogjia mes çiftit burrë-grua dhe asaj Krisht-Kishë është një analogji e papërsosur, ajo na fton të thërrasim Zotin për ta përhapur dashurinë e tij brenda limiteve të marrëdhënieve bashkëshortore» (*Amoris laetitia*, 73).

⁶⁵ «Më vjen ndërmend mrekullia e shumimit të bukëve: edhe për ju, Zoti mund ta shumojë dashurinë tuaj dhe t’jua dhurojë atë të freskët dhe të mirë çdo ditë. Ka rezerva pafund! Ai ju jep dashurinë që është në themel të bashkimit tuaj dhe e ripërtërin atë çdo ditë, e forcon. Dhe e bën edhe më të madhe kur familja rritet me fëmijë» (FRANÇESKU, *Fjalim për të fejuarit që përgatiten për martesë*, 14 shkurt 2014).

bashkëshortët në zgjedhjen e leximeve për Meshën dhe ndoshta edhe për opsionet e parashikuara për pjesët e tjera të ritit (për shembull modalitetet e ndryshme të ritit të hyrjes, momenti i bekimit martesor, formulat e lutjes së besimtarëve, këngët etj.). Një aspekt që duhet theksuar më shumë është ndërjegjësimi i një zbrazjeje të re të Shpirtit Shenjt gjatë ritit të martesës, e cila, duke zënë vend në dinamizmin e hirit të nisur në Pagëzim, i jep një konotacion të ri dashurisë hyjnore të rrënjësuar në ne duke filluar nga vetë Pagëzimi dhe që tani merr tiparet e “dashurisë bashkëshortore”. Me këtë dhurim të ri të Shpirtit, zemrat e bashkëshortëve ripërtërihen dhe dashuria e tyre bashkëshortore orientohet e shndërrohet në një dashuri që ka në vetvete thellësinë dhe forcën e pashtershme të dashurisë hyjnore, që është pikërisht “dashuria bashkëshortore”.⁶⁶

Edhe shenjtërit e thirrur në litani ndërmjetsojnë në funksion të kësaj përhapjeje. Do të ishte ndihmë e madhe për çiftin që martohet thirrja e shenjtërve/të lumëve të kohës sonë, që kanë përjetuar tashmë përvojën e të qenurit bashkëshortë e bashkëshorte, baballarë e nëna, si dhe shenjtërit ndërmjetës, të rëndësishëm për çiftin, në mënyrë që të vlerësohet dinjiteti i gjendjes së jetës bashkëshortore në bashkësinë kishtare dhe të gjejnë ndihmën për të kuptuar bukurinë dhe forcën e këtij sakramenti në ekonominë e shpëtimit.

70. Pak ditë para martesës është shumë e dobishme të bëhet një tërheqje shpirtërore një/dy ditëshe. Edhe pse kjo mund të duket joreale, duke pasur parasysh angazhimet e shumta për shkak të organizimit të dasmës, megjithatë aty ku është realizuar ka treguar përfitime të mëdha. Pikërisht stërlodhja për shkak të shumë detyrave praktike të lidhura me festën e afërt, në të vërtetë, mund të shpërqendrojë shpirtin e bashkëshortëve nga ajo që ka më shumë rëndësi: kremtimi i sakramentit dhe takimi me Zotin që vjen për të “banuar” te dashuria e tyre njerëzore, duke e mbushur me dashurinë e tij hyjnore. Ankthi i tepërt për “gjërat për t’u bërë” mund

⁶⁶ Krh. KATEKIZMI I KISHËS KATOLIKE, nr. 1624: «Në epiklezën e këtij sakramenti, dhëndri dhe nusja marrin Shpirtin Shenjt si bashkim dashurie të Krishtit me Kishën. Ai është vula e besëlidhjes së tyre, burimi përherë i ofruar i dashurisë së tyre, forca me të cilën do të ripërtërihet besnikëria e tyre»; krh. edhe *Amoris laetitia*, 120. Ka disa epikleza të pranishme në ritin e martesës, po citojmë disa prej tyre (sipas versionit italian të *editio typica altera* të *Ordo celebrandi Matrimonium* të miratuar nga Kongregata për Kultin Hyjnor dhe Disiplinën e Sakramenteve me dekret Prot. nr. 874/02 / L e 29 prill 2004); lutja në fund të thirrjeve të shenjtërve: «Zbraze, o Zot, Shpirtin e dashurisë sate mbi E. dhe E., që të bëhen një zemër dhe një shpirt i vetëm: asgjë të mos i ndajë këta bashkëshortë që Ti ke bashkuar dhe, të mbushur me bekimin tënd, asgjë mos i pikëlloftë. Për Krishtin, Zotin tonë»; epikleza në brendësi të lutjes së bekimit të bashkëshortëve (formula e parë): «Shiko tani me mirësi këta bijtë e tu, të cilët të bashkuar në lidhjen e Martesës kërkojnë ndihmën e bekimit tënd: zbraze mbi ta hirin e Shpirtit Shenjt që, me forcën e dashurisë Sate të përhapur në zemrat e tyre, të qëndrojnë besnikë ndaj paktit bashkëshortor»; në lutjen e bekimit të bashkëshortëve (formula e dytë): «O Hyj, shtrije dorën mbi E. dhe E. dhe zbraze në zemrat e tyre fuqinë e Shpirtit Shenjt. Bëj, o Zot, që në bashkimin e shenjtëruar prej Teje, të bashkëndajnë dhuratat e dashurisë sate dhe, duke u bërë shenjë e pranisë sate për njëri-tjetrin, të jenë një zemër dhe një shpirt i vetëm».

të shkaktojë shpërqendrim dhe rrezikon të kalojë në vend të dytë gjithë përgatitjen shpirtërore që është kryer prej muajsh. Në këtë kuptim, një tërheqje shpirtërore e shkurtër në afërsi të martesës mund të ndihmojë për t'u ripërqendruar në çka është thelbësore, për ta shkëputur shikimin nga gjërat dytësore dhe për ta rikthyer drejt Zotit, i cili u vjen në takim bashkëshortëve dhe çon në përmbushje thirrjen për të cilën i ka thirrur. Aty ku është e pamundur një tërheqje shpirtërore e mirëfilltë, edhe një moment më i shkurtër lutjeje (për shembull një takim në mbrëmje, si një "vigjilje lutjeje") mund të jetë i dobishëm për këtë qëllim. Sidoqoftë, në propozimin konkret të kihen parasysh angazhimet konkrete jetësore të çiftëve në fjalë dhe mundësitë e tyre reale për të parashikuar këtë kohë tërheqjeje para kremtimit të dasmës, në mënyrë që propozimi të mos jetë i parealizueshëm.

71. Me afrimin e dasmës – në kontekstin e tërheqjes shpirtërore të lartpërmendur ose "të vigjiljes së lutjes" apo edhe në një kontekst tjetër – ka rëndësi të madhe kremtimi i sakramentit të Pajtit.⁶⁷ Përvoja tregon se marrja e faljes nga Hyji – nëse është rasti, edhe përmes një rrëfimi më të thelluar të jetës së kaluar – i përgatit bashkëshortët më mirë se çdo gjë tjetër për të pranuar hirin që Hyji ka ruajtur për ta në sakramentin e Martesës, meqenëse largon ndjenjat e fajit të thellë që "tërhiqen pas vetes" nga e kaluara, jep paqen e brendshme, e drejton shpirtin drejt hirit dhe mëshirës së Hyjit dhe drejt gjithçkaje që ka vërtet rëndësi, duke e larguar vëmendjen nga aspektet vetëm materiale të dasmës. Për më tepër, rrëfimi me rastin e martesës, ndonjëherë pas vitesh "arratisjeje" nga sakramenti i Pajtit, për shumëkënd është një moment kthimi në praktikën sakramentale. Aty ku është e mundur, mund të mendohet edhe një kremtim bashkësior i sakramentit të Pajtit, duke përfshirë familjet e çiftit që po martohet, dëshmitarët dhe të tjerët që do të duan të marrin pjesë, në mënyrë që dhurata e mëshirës hyjnore të zbrazet edhe mbi familjet e të fejuarve, kurdoherë nevojtare për t'u pajtuar së brendshmi dhe kurdoherë nevojtare për t'u ndërtuar në bashkim. Në këtë mënyrë, të gjithë ata që marrin pjesë në martesë, do të ndihmohen për ta jetuar këtë moment me gatishmërinë e duhur shpirtëror.

72. Përfshirja e prindërve, dëshmitarëve dhe anëtarëve më të afërt të familjes në një moment lutjeje përpara martesës, qoftë edhe jashtë kremtimit të Rrëfimit, mund të jetë një rast shumë i bukur për të gjithë, për t'u bashkuar përreth çiftit të ri; për çiftin, për të marrë bekimin e prindërve të tyre, siç është traditë në Bibël (krh. *Tb* 10,11-13; 11,17), për të afërmit dhe miqtë, për ta kuptuar se ata përfaqësojnë dhe bëjnë të dukshme bashkësinë kishtarë, që mirëpret familjen e re brenda familjes më të madhe të Kishës dhe që ndien përgjegjësinë për të mbështetur çiftin.

73. Si përmbledhje, qëllimet e përgatitjes së afërt janë: a) të rikujtohen aspektet doktrinale, morale dhe shpirtërore të martesës (duke bërë të qartë edhe përmbajtjet

⁶⁷ Krh. KATEKIZMI I KISHËS KATOLIKE, nr. 1622; KËSHILLI PAPNOR PËR FAMILJEN, *Përgatitje për sakramentin e martesës*, 53.

e bisedave kanonikisht të përshkruara); b) përjetimi i përvojave shpirtërore takimi me Zotin; c) përgatitja për një pjesëmarrje të vetëdijshme dhe të frytshme në liturgjinë martesore.⁶⁸

Etapa e tretë: shoqërimi në vitet e para të martesës

74. Itinerari katekumenal nuk përfundon me kremtimin e martesës. Në të vërtetë, më shumë se një akt i izoluar, ky duhet parë si një hyrje në një “gjendje të përhershme”, e cila për rrjedhojë kërkon “një formim të përhershëm” të posaçëm, të përbërë nga reflektime, bashkëbisedime dhe ndihma nga ana e Kishës.⁶⁹ Për këtë arsye, është e nevojshme të “shoqërohen” të paktën vitet e para të jetës bashkëshortore⁷⁰ dhe të mos lihen në vetmi të porsamartuarit.⁷¹

75. Të sapomartuarit duhet sensibilizohen për faktin se kremtimi i martesës është fillimi i një ecjeje dhe se çifti përbën përherë një “plan të hapur”, jo një “punë të përfunduar”.⁷² Kësisoj, është mirë që të sapomartuarit të ndihmohen në këtë fazë të parë në të cilën fillojnë të vënë në praktikë “planin e jetës” që është i brendashkruar në martesë, por ende i parealizuar plotësisht. Njëmend, hiri që përmban sakramenti nuk vepron automatikisht, por kërkon që bashkëshortët të bashkëpunojnë me të, duke marrë përsipër me përgjegjësi detyrat dhe sfidat që paraqet jeta bashkëshortore.⁷³

⁶⁸ Krh. KËSHILLI PAPANOR PËR FAMILJEN, *Përgatitje për sakramentin e martesës*, 50-58.

⁶⁹ «Përgatitja për martesën e krishterë mund të cilësohet si një itinerar feje, i cili nuk përfundon me kremtimin e martesës, por që vazhdon gjatë gjithë jetës familjare, ndaj këndvështrimi ynë nuk përfundon me martesën si akt, në momentin e kremtimit, por si status i përhershëm» (KËSHILLI PAPANOR PËR FAMILJEN, *Përgatitja për Sakramentin e Martesës*, 16).

⁷⁰ «Efikasiteti më i madh i baritores arrihet aty ku *shoqërimi* nuk përfundon me kremtimin e martesës, por “përcjell” të paktën vitet e para të jetës bashkëshortore. Nëpërmjet bisedave me vetë çiftin dhe me momentet bashkësiore, bashkëshortët e rinj ndihmohen që të marrin mjetet dhe mbështetjen për ta jetuar thirrjen e tyre. Dhe kjo gjë mund të ndodhë vetëm përmes një rrugëtimi rritjeje në fenë e vetë çifteve» (FRANÇESKU, *Fjalimi drejtuar pjesëmarrësve në kursin dioqezan të formimit mbi martesën dhe familjen, i promovuar nga Gjykata e Rotës Romake*, 27 shtator 2018).

⁷¹ Është «e domosdoshme që bashkëshortët, në vitet e para të jetës martesore, të shoqërohen për të pasuruar dhe thelluar vendimin e vetëdijshëm dhe të lirë për t’i përkatur njëri-tjetrin dhe për ta dashur njëri-tjetrin deri në fund. Shumë herë koha e fejesës nuk është e mjaftueshme, vendimi për t’u martuar përshpejtohet për arsye të ndryshme, ndërsa, si të mos mjaftonte, pjekja e të rinjve është vonuar. Pra, bashkëshortëve të rinj u duhet të plotësojnë atë rrugëtim që do të ishte dashur të realizohej gjatë fejesës» (*Amoris laetitia*, 217).

⁷² «Besëlidhja e dashurisë midis burrit dhe gruas, një besëlidhje për jetën, nuk improvizohet, nuk bëhet nga sot nesër [...], duhet punuar mbi dashurinë, duhet ecur. Besëlidhja e dashurisë së burrit dhe gruas mësohet dhe përsoset. Marr guximin të them se është një besëlidhje artizanale. Të bësh që dy jetë të jenë një jetë e vetme është, gjithashtu, pothuajse një mrekulli, një mrekulli i lirisë dhe e zemrës, që i është besuar fesë» (FRANÇESKU, *Audienca e përgjithshme. Familja - 16. Fejesa*, 27 maj 2015).

⁷³ «Bashkimi është real, është i pakthyeshëm dhe është miratuar e shenjtëruar nga sakramenti i Martesës. Por duke u bashkuar, bashkëshortët bëhen [me Jezusin të pranishëm në mesin e tyre],

76. Për t'i realizuar të gjitha këto, çifteve do t'u propozohet vazhdimi i itinerarit katekumenal, me takime periodike – mundësisht mujore ose në intervale të tjera, sipas gjykimit të ekipit shoqërues dhe sipas mundësive të çifteve – dhe momente të tjera, qofshin bashkësiore a në çift.⁷⁴ Nëse çifti pas martesës ndryshon vendbanimin dhe famullinë, do të jetë mirë që të integrohet në famullinë e re dhe të ftohet prej kësaj në itineraret shoqëruese të bashkëshortëve të bashkësisë së re.

77. Është koha e duhur për një “mistagogji martesore” të mirëfilltë. Me termin “mistagogji” nënkuptohet “hyrja në mister”, pra, një lloj i veçantë katekeze që barinjtë e Kishës, në shekujt e parë, ua drejtonin të sapopagëzuarve me synimin për ta kuptuar atë çfarë kishte ndodhur në Pagëzimin e marrë gjatë Vigjiljes solemne të Pashkëve.⁷⁵ Katekeza mistagogjike, në të vërtetë, shpeshherë shënjohej nga pyetje retorike si: «A e dini se çfarë keni marrë?», «A e dini se çfarë ka kryer Zoti në ju?» Një katekezë e tillë pas kremtimit të Pagëzimit, prandaj, kishte për qëllim që të shpinte pak nga pak në të kuptuarit e plotë, mbi të gjitha ritual dhe simbolik – nëpërmjet shpjegimit të përmbajtjes shpirtërore të çdo aspekti të ritit – por edhe në pasojat e veta morale dhe ekzistenciale, në kuptimin që personi ndriçohet mbi përfshirjen e jetës konkrete të asaj çka ishte kremtuar.

Ky stil i katekezës mistagogjike mund të zbatohet për martesën. Duke rimarrë momentet e ndryshme të ritit të martesës, mund të thellohet kuptimi i tyre i pasur simbolik dhe shpirtëror dhe pasojat konkrete në jetën bashkëshortore: pëlqimi i shkëmbyer (vullneti për t'u bashkuar, dhe jo një ndjenjë kalimtare, në bazë të martesës, vullnet për t'u forcuar gjithmonë),⁷⁶ bekimi i shenjave që kujtojnë martesën, për shembull unazat (premtimi i besnikërisë për t'u ripërtërirë gjithmonë),⁷⁷ bekimi solemn i bashkëshortëve (hiri i Hyjit që zbret në marrëdhëniet njerëzore, e merr dhe e shenjtëron, ndaj të cilit duhet të qëndrohet gjithmonë të hapur),⁷⁸ kujtimi i bashkëshortëve në zemrën e lutjes eukaristike (të zhytet gjithmonë dashuria bashkëshortore në misterin pashkor të Krishtit për ta rigjallëruar dhe thelluar atë).⁷⁹ Si përfundim, me katekezën mistagogjike martesore, njëlloj me atë të

protagonistë, zotër të historisë së tyre dhe krijues të një plani që duhet ta çojnë përpara së bashku. [...] “Po”-ja që kanë shkëmbyer është fillimi i një rrugëtimi, me një objektiv që arrin të kapërcejë atë çka mund të parashtrajnë rrethanat apo pengesat që mund të dalin përpara. Bekimi i marrë është një hir dhe një shtytje për këtë ecje gjithnjë të hapur. Shpesh është mirë që të ulen e të dialogojnë për të përpunuar planin e tyre konkret në objektivat e tij, në mjetet e tij, në hollësitë e tij» (*Amoris laetitia*, 218).

⁷⁴ «Është e dëshirueshme që çiftet e reja të shoqërohen në mënyrë të përshtatshme, veçanërisht në pesë vitet e para të jetës bashkëshortore, nga kurse pasmartesore, të cilat mund të mbahen në famulli ose dekanat» (KËSHILLI PAPANOR PËR FAMILJEN, *Përgatitje për sakramentin e martesës*, 73).

⁷⁵ Krh. Për shembull Cirili i Jerusalemit – Gjoni i Jerusalemit, *Katekezë mistagogjike*; Ambrozi i Milanos, *De Sacramentis*; *De Mysteriis*.

⁷⁶ Krh. *Amoris laetitia*, 133-135; 143-146; 163-164; 321-323.

⁷⁷ Krh. *Amoris laetitia*, 125; 147-152; 319-320.

⁷⁸ Krh. *Amoris laetitia*, 77; 120-124.

⁷⁹ Krh. *Amoris laetitia*, 72-75; 317-318.

pagëzimit, ftesa që drejtohet është: «Bëhuni çka jeni! Tani jeni të martuar, prandaj jetoni gjithnjë e më shumë si bashkëshortë! Zoti e ka bekuar dhe “mbushur” me hir bashkimin tuaj, prandaj bëni që ky hir të japë fryte!». Me këtë qëllim, është e rëndësishme që bashkëshortët ta perceptojnë praninë e Krishtit, jo vetëm në sakramentet e tjera, por në vetë sakramentin e Martesës. Krishti është i pranishëm mes tyre si bashkëshortë: Ai e ushqen marrëdhënien e tyre çdo ditë dhe Atij mund t’i drejtohen së bashku në lutje. Hiri i sakramentit vepron midis tyre dhe dëftohet në jetën konkrete. Prandaj, bashkëshortët duhet të ndihmohen që t’i përshquajnë “shenjat” e pranisë së Krishtit në bashkimin e tyre.⁸⁰

Shumë herë ndodh që vëmendja e bashkëshortëve të rinj të përqendrohet te nevoja për të fituar dhe te fëmijët, duke mos punuar për cilësinë e marrëdhënies së ndërsjellë dhe duke harruar praninë e Hyjit në dashurinë e tyre. Ia vlen të ndihmohen bashkëshortët e rinj që të dinë të gjejnë kohën për ta thelluar miqësinë e tyre dhe për ta mirëpritur hirin e Hyjit. Patjetër që dëlirësia paramartesore e favorizon këtë rrugëtim, sepse u jep kohë bashkëshortëve të rinj të qëndrojnë bashkë, të njihen më mirë, pa menduar menjëherë për prokrijimin [lindjen e fëmijëve] dhe rritjen e fëmijëve.

78. Që në fillimet e jetës martesore, është e rëndësishme që të merret ndihmë konkrete për të jetuar qetësisht marrëdhëniet ndërpersonale. Gjërat e reja për t’u mësuar janë të shumta: të pranohet diversiteti i tjetrit që shfaqet menjëherë;⁸¹ të mos kihen pritshmëri jorealiste për jetën në çift dhe të çmohen si një ecje rritjeje;⁸² të menaxhohen konfliktet që lindin në mënyrë të pashmangshme;⁸³ të njihen fazat e ndryshme nëpër të cilat kalon çdo marrëdhënie dashurie;⁸⁴ të dialogohet për të

⁸⁰ «E gjithë jeta e përbashkët e bashkëshortëve, i gjithë rrjeti i marrëdhënieve që do të krijojnë së bashku, me bijtë e tyre dhe me botën, do të jetë e mbushur dhe e forcuar prej hirit të sakramentit që buron prej misterit të Mishërimit dhe të Pashkëve, në të cilin Hyji e ka shprehur gjithë dashurinë e vet për njerëzimin dhe është bashkuar ngushtë me të. Nuk do të jenë kurrë vetëm me forcat e tyre për të përballuar sfidat që paraqiten. Ata janë të thirrur që t’i përgjigjen dhuratës së Hyjit me angazhimin e tyre, krijimtarinë e tyre, qëndrueshmërinë e tyre dhe luftën e përditshme, por edhe do të mund ta thërrasin gjithmonë Shpirtin Shenjt që e ka shuguruar bashkimin e tyre, që hiri të cilin e kanë marrë të dëftohet përsëri në çdo situatë të re» (*Amoris laetitia*, 74).

⁸¹ «Vështrimi drejtohet nga e ardhmja që duhet ndërtuar ditë pas dite me hirin e Hyjit, dhe pikërisht për këtë fakt nuk pretendohet prej bashkëshortit/es që të jetë i/e përsosur. Duhet lënë mënjanë iluzionet dhe të pranohet ashtu siç është: i papërkryer, i thirrur të rritet, në ecje. Kur vështrimi drejt bashkëshortit/es është vazhdimisht kritik, kjo tregon se martesë nuk është marrë përsipër edhe si një projekt që duhet ndërtuar së bashku, me durim, mirëkuptim, tolerancë dhe zemërgjerësi. Kjo bën që dashuria të zëvendësohet pak nga pak prej një vështrimi zhbirues dhe të egër, prej kontrollit të meritave e të drejtave të secilit, prej protestave, prej garës dhe prej vetëmbrojtjes. Kështu bëhen të paafte që ta mbështesin njëri-tjetrin për pjekurinë e të dyve dhe për rritjen e bashkimit. Bashkëshortëve të rinj është e nevojshme t’u paraqitet kjo gjë me qartësi realiste që prej fillimit, në mënyrë që të ndërgjegjësohen për faktin se janë duke filluar» (*Amoris laetitia*, 218).

⁸² Khr. *Amoris laetitia*, 221.

⁸³ Krh. *Amoris laetitia*, 106; 163; 210; 232-234; 240.

⁸⁴ «Ecje do të thotë të kalosh nëpër etapa të ndryshme që të thërrasin të dhurohesh me zemërgjerësi: prej efektit fillestar të karakterizuar nga një tërheqje shumë shqisore, kalon në nevojën për tjetrin, të

kërkuar një ekuilibër midis nevojave personale dhe atyre të çiftit dhe familjes;⁸⁵ të fitohen zakone të shëndetshme të përditshme;⁸⁶ të vendoset menjëherë një marrëdhënie e duhur me familjet e origjinës;⁸⁷ të fillohet kultivimi i një përshtirërie martesore të bashkëndarë;⁸⁸ dhe ende shumë të tjera. Ndër propozimet e ndryshme të mundshme, mund t'u sugjerohet bashkëshortëve që të mbajnë një "Ditar martesë", për një lloj verifikimi periodik të bashkimit bashkëshortor, ku të shënohen gëzimet, vuajtjet dhe gjithçka që përbën përvojën konkrete të jetës së bashkëshortëve. Një lloj "shkrimi i shenjt", për të kujtuar çdo moment të rëndësishëm të jetës, të prekur nga hiri i Shpirtit Shenjt dhe që mund të bëhet një mjet për të përçarur fenë në familje: një "përkujtim" i hirit të Shpirtit Shenjt që vepron në familje.

79. Janë të shumta aspektet e jetës bashkëshortore dhe familjare që mund të bëhen objekt dialogu dhe katekeze në këto vite. Për shembull, është themelore ndriçimi i çifteve për temën delikate të seksualitetit brenda martesës⁸⁹ dhe për temat që lidhen me të, pra, përçimin e jetës dhe rregullimin e lindjeve, dhe për çështje të tjera morale dhe bioetike.⁹⁰ Një fushë tjetër që nuk duhet anashkaluar është edukimi i fëmijëve, njerëzor dhe i krishterë, që përbën një përgjegjësi të madhe për prindërit dhe për të cilën çiftet duhet të ndërgjegjësohen dhe të formohen në mënyrën e duhur, duke pasur parasysh tendencën gjithnjë e më të përhapur për t'u përçarë mbi këtë temë, ose për të mos u marrë me edukimin e fëmijëve, duke ia deleguar këtë gjë të tjerëve.⁹¹ Duke iu referuar këtyre temave, mësimi i Kishës u vë në dispozicion bashkëshortëve një visar urtie, i cili, kur u paraqitet mirë, vlerësohet dhe mirëpritet shumë nga bashkëshortët.

80. Bëhet fjalë, pra, për një fazë "nxënieje" gjatë së cilës afërsia dhe sugjerimet

ndier si pjesë e jetës tënde. Prej aty kalon në dëshirën për përkatësinë e ndërsjellë, pastaj në kuptimin e krejt jetës si plan i të dyve, në aftësinë për ta vënë lumturinë e tjetrit mbi nevojën tënde, dhe në gëzimin që jep fakti se e sheh martesën tënde si një të mirë për shoqërinë» (*Amoris laetitia*, 220).

⁸⁵ «Pjekuria e dashurisë kërkon edhe që të mësosh se si "të negociosh". Nuk është një qëndrim me interes apo një lojë e tipit komercial, por në fund të fundit një ushtrim i dashurisë së ndërsjellë, sepse ky negociim është një gërshetim ofertash të ndërsjella dhe vetëmohimesh për të mirën e familjes. Në çdo etapë të re të jetës martesore, duhet që bashkëshortët të ulen dhe të negociojnë përsëri në lidhje me marrëveshjet, në mënyrë që të mos ketë fitimtarë dhe të humbur, por që të fitojnë të dy» (*Amoris laetitia*, 220).

⁸⁶ «Bashkëshortët e rinj duhet edhe të nxiten që të krijojnë disa zakone të vetat, që japin një përshtypje të shëndoshë qëndrueshmërie e mbrojtjeje, dhe që ndërtohen me një seri ritualesh të përditshme të bashkëndara. Është gjë e mirë që ata t'i japin gjithmonë njëri-tjetrit një puthje në mëngjes, ta bekojnë njëri-tjetrin çdo natë, ta presin tjetrin kur vjen, të dalin nganjëherë së bashku, të bashkëndajnë punët e shtëpisë» (*Amoris laetitia*, 226).

⁸⁷ Krh. *Amoris laetitia*, 17-18.

⁸⁸ Krh. *Amoris laetitia*, 313v.

⁸⁹ Krh. *Amoris laetitia*, 150-157.

⁹⁰ Krh. *Amoris laetitia*, 80-83.

⁹¹ Krh. *Amoris laetitia*, 84-85; FRANÇESKU, *Audienca e përgjithshme. Familja-15. Edukimi*, 20 maj 2015.

konkrete të çifteve të martuara tashmë të pjekura do të ndihmojnë shumë, duke bashkëndarë me të rinjtë çka kanë nxënë “përgjatë ecjes”.⁹²

Gatishmëria e gjyshërve për t’u kujdesur për nipërit e mbesat e tyre është një pasuri e madhe. Kjo u lejon bashkëshortëve të gjejnë kohë për të qëndruar së bashku. Megjithatë, ndonjëherë nuk është e mundur, e bashkëshortët detyrohen të gjejnë zgjidhje alternative. Shembuj të tillë bujarie dhe ndihme ndaj bashkëshortëve të rinj janë shenja të mrekullueshme bamirësie.

81. Baritorja martesore do të jetë mbi të gjitha një baritore e lidhjes [martesore]:⁹³ do të ndihmohen çiftet, çdo herë që do të gjenden përballë vështirësive të reja, që të kenë për zemër, mbi të gjitha, mbrojtjen dhe konsolidimin e bashkimit martesor, për të mirën e tyre dhe të fëmijëve të tyre. Është e nevojshme, në takimet që do t’u propozohen, këmbëngulja mbi shenjtërinë e lidhjes bashkëshortore dhe, siç tregon përvoja, në faktin se të mirat – shpirtërore, psikologjike dhe materiale – që rrjedhin nga ruajtja e bashkimit, janë gjithmonë me përfitime shumë më të mëdha sesa ato që dikush shpreson të arrijë nga një ndarje e mundshme. Në këtë mënyrë do t’u mësohet durimi i duhur, guximi dhe matura që duhet të kihet në kohë vështirësish, duke mësuar që të mos shihet zhbërja e lidhjes martesore si një zgjidhje e shpejtë e problemeve, siç, për fat të keq, u këshillohet shpesh çifteve.

Duke mësuar që të kapërcehen momentet e vështira piqen në dashuri dhe bashkimi forcohet: çdo krizë është një moment rritjeje dhe një mundësi për të bërë një “hap cilësor” në marrëdhënie, e thirrur kjo për një thellësi të re dhe autenticitet.⁹⁴ Ashtu si në jetën e krishterë “stërvitemi” në “luftën e mirë të fesë” (1 Tim 6:12), ashtu edhe bashkëshortët, në jetën martesore, duhet të stërviten për të “mbrojtur” martesën e tyre nga të gjitha kërcënimet e brendshme dhe të jashtme, njerëzore dhe shpirtërore, sociale dhe kulturore që mund të minojnë qëndrueshmërinë dhe vetë ekzistencën. Është e rëndësishme të ritheksohet se ndihma që synohet të ofrohet duhet të përfshijë shoqërimin shpirtëror, rrugëtime praktike, strategji që rrjedhin nga përvoja dhe orientime psikologjike. Do të jetë e dobishme që çifteve t’u tregohen vende dhe persona, qendra këshillimi ose familje të gatshme, ku mund të drejtohen për të kërkuar ndihmë nëse paraqiten vështirësi.

82. Është thelbësore që rrugëtimi i çiftit të fokusohet në takimin me Krishtin: çifti

⁹² «Bashkëshortët që kanë një përvojë të mirë “praktike” në këtë kuptim mund t’u japin çifteve të tjera mjetet praktike që kanë qenë të dobishme për ta: programimi i momenteve për të qëndruar së bashku falasshmërisht, kohët e zbatimit me fëmijët, mënyrat e ndryshme për të kremtuar gjëra të rëndësishme, hapësirat e përshtetshme të bashkëndarë. Por munden edhe t’u mësojnë marifete që i ndihmojnë t’i mbushin me përmbajtje dhe domethënie këto momente, në mënyrë që të mësojnë të komunikojnë më mirë» (*Amoris laetitia*, 225).

⁹³ Krh. *Amoris laetitia*, 211.

⁹⁴ «Duhet t’i ndihmojmë njerëzit të zbulojnë se një krizë e kapërcyer nuk çon në një marrëdhënie më pak të fortë, por bën që të përmirësohet, të përpunohet dhe të piqet vera e bashkimit [...] kur martesë merret si një detyrë, që nënkupton edhe kapërcimin e pengesave, çdo krizë perceptohet si një rast për të pirë së bashku verën më të mirë» (*Amoris laetitia*, 232).

duhet të takohet vazhdimisht me Krishtin dhe të ushqehet nga prania e tij. Në veçanti, të porsamartuarit duhet ta perceptojnë, në mënyrë të veçantë, mundësinë e jashtëzakonshme që u ofrohet atyre në sakramentin e Eukaristisë dhe në sakramentin e Pajtitimit për të pasur një kontakt të gjallë me Jezusin në mënyrë që të bëhen një me të.⁹⁵ Njëmend, nga Eukaristia bashkëshortët marrin hirin për të kapërcyer mbylljet në vetvete dhe egoizmin e tyre.⁹⁶ Në sakramentin e Pajtitimit ata përjetojnë pasurinë e pafundme të mëshirës së Hyjit, që në Birin e Tij na fal gjithmonë; në këtë mënyrë, ata mësojnë të jenë të durueshëm dhe të mëshirshëm me njëri-tjetrin, sepse falja e marrë bëhet falje e dhuruar, sipas mësimit të Jezusit: «A nuk u desh edhe ti të kishe mëshirë ndaj shokut tënd, sikurse edhe unë pata mëshirë ndaj teje?» (Mt 18,33).⁹⁷ Prandaj, në takimin me Krishtin përmes sakramenteve, *identiteti martesor* specifik i bashkëshortëve të krishterë piqet gradualisht.

83. Kujdesi i vazhdueshëm dhe i përhershëm i Kishës ndaj bashkëshortëve mund të arrihet me mjete të ndryshme baritore:⁹⁸ dëgjimi i Fjalës së Hyjit, veçanërisht nëpërmjet *lectio divina*-s; takimet për reflektim mbi çështjet aktuale që kanë të bëjnë me jetën bashkëshortore dhe familjare; përfshirja e çifteve në kremtimet liturgjike të menduara posaçërisht për ta; tërheqje shpirtërore periodike për bashkëshortët; adhurimet eukaristike të organizuara për bashkëshortët me meditime të shkëputura, për shembull, nga biografite e bashkëshortëve shenjtër; biseda dhe shoqërimi shpirtërore; pjesëmarrja në grupe familjare për të zhvilluar përballjen me familjet e tjera; përfshirja në veprimtari bamirëse dhe misionare.⁹⁹ Bashkëshortët kanë nevojë që të zhvillojnë një “përshtirë bashkëshortore” të mirëfilltë që ushqen dhe mbështet ecjen specifike të shenjtërisë që ata përshkojnë në jetën martesore.¹⁰⁰

Ndër mjetet baritore për t’u privilegjuar është kremtimi i përvjetorit të martesës si pjesë e një kremtimi liturgjik bashkësior me një bekim të veçantë për bashkëshortët. Me rastin e përvjetorëve më të rëndësishëm (për shembull çdo pesë vjet), mund t’u propozohet bashkëshortëve, që festojnë në atë vit, ripërtëritjen e premtimeve martesore. Në këtë dhe në mënyra të tjera, mund të ndihmohet familja

⁹⁵ «Përshtirëria martesore [...] duhet të përfshijë një rikuperim të dinamikës sakramentale me një rol të veçantë të sakramentit të Pajtitimit dhe Eukaristisë. Sakramenti i Pajtitimit lavdëron mëshirën hyjnore ndaj mjerimit njerëzor, rrit vitalitetin e pagëzimit dhe dinamizmat përkatës të Përforcimit. Prej këtu rrjedh forcimi i pedagogjisë së dashurisë së shëlbuar që na bën të zbulojmë me mahnitje madhështinë e mëshirës së Hyjit përballë dramës së njeriut, të krijuar nga Hyji dhe të shëlbuar në mënyrë më të admirueshme. Eukaristia, duke kremtuar përkujtimin e dhurimit të Krishtit për Kishën, zhvillon dashurinë afektive, vetjake e martesës, në dhurimin e përditshëm ndaj bashkëshortit/es dhe fëmijëve, pa harruar dhe anashkaluar se “kremtimi që i jep kuptim çdo forme lutjeje dhe kulti është ajo që shprehet në ekzistencën e përditshme të familjes, nëse është një ekzistencë e përbërë nga dashuria dhe dhurimi” (EV 93)» (KËSHILLI PAPANOR PËR FAMILJEN, *Përgatitja për Sakramentin e Martesës*, 41).

⁹⁶ Krh. *Amoris laetitia*, 186; 318.

⁹⁷ Krh. *Amoris laetitia*, 105-108.

⁹⁸ Krh. *Amoris laetitia*, 227-229.

⁹⁹ Krh. FRANÇESKU, *Fjalim drejtuar Gjykatës së Rotës Romake për përrurimin e vitit gjyqësor*, 29 janar 2019.

¹⁰⁰ Krh. *Amoris laetitia*, 313-324; *Gaudete et exsultate*, 14-34.

që të ndihet pjesë përbërëse e një bashkësie kishtare që kremton, bashkëndan gëzimin dhe ecjen e bashkëshortëve, duke u bërë një “familje e familjeve”.¹⁰¹

84. Me zhvillimin e identitetit martesor, mund të thellohet vështrimi i misionit, që buron nga sakramenti.¹⁰² Prandaj, në këtë moment, duke qenë se itinerari katekumenal për jetën martesore ka mbërritur në fund, është e përshtatshme të ftohen çiftet që të bëhen pjesë e baritores familjare të zakonshme në famullitë e tyre ose në realitete të tjera kishtare me të cilat kanë krijuar lidhje. Të sapomartuarit, për shembull, mund të përfshihen gradualisht në përgatitjen katekumenale për martesë të grupeve të reja të të fejuarve dhe në jetën e bashkësisë, në baritoren e fëmijëve dhe të rinjve, duke marrë përsipër detyra të veçanta në gjallërimin e bashkësisë. Mund të formohen grupe të përshpirtërisë bashkëshortore (edhe me ndihmën e lëvizjeve të mundshme familjare) dhe të baritores martesore.

85. Si përmbledhje, qëllimet e shoqërimit në vitet e para të jetës bashkëshortore janë: a) të paraqiten, përmes një “katekeze mistagogjike martesore”, rrjedhojat shpirtërore dhe ekzistenciale, të sakramentit të kremtuar, në jetën konkrete; b) të ndihmohen çiftet, që në fillim, për të krijuar në mënyrën e duhur marrëdhënien e tyre ndërpersonale si të martuar; c) të thellohen mbi temat e seksualitetit në jetën bashkëshortore, përçimin e jetës dhe edukimin e fëmijëve; d) të rrënjohet te çiftet vullneti i fortë për të mbrojtur lidhjen martesore në çdo situatë krize që paraqitet; e) të propozohet takimi me Krishtin si burimi i domosdoshëm i ripërtëritjes së hirit martesor dhe të arrihet një përshpirtëri bashkëshortore; f) të hidhet shikimi nga vështrimi i misionit specifik të bashkëshortëve të krishterë.

86. Si pasojë e pashmangshme e këtij propozimi, nuk mund të lihet anash një sqarim mbi urgjencën e një formimi më të përshtatshëm të presbiterëve, të seminaristëve dhe të laikëve (përfshirë çiftet e martuara) për në shërbesën e shoqërimit të të rinjve për në martesë. Kujdesi për formimin dhe përditësimin e presbiterëve/rregulltarëve dhe punëtorëve baritorë në mënyrë sistematike, në funksion të katekumenatit martesor, është i domosdoshëm për kapërcimin e zakoneve të vjetra dhe formimin e një stili shoqërimi si dhe për njohjen e përmbajtjeve (teologjike, morale, bioetike dhe shpirtërore) të përshtatshme për realitetin e çifteve të sotme, që shpeshherë tashmë bashkëjetojnë dhe janë me fëmijë kur i afrohen Kishës për t’u martuar. Në shumë kontekste baritore, në veçanti, është tanimë e domosdoshme një formim i seminaristëve dhe i presbiterëve i përqendruar më shumë në sfidat e reja të baritores bashkëshortore dhe familjare, duke përfshirë çështjet lidhur me moralin seksual, bashkëshortor dhe bioetikën, që janë tashmë pjesë e jetës së përditshme të familjeve në shumë anë të botës. Me qëllimin, pastaj, të një pjesëmarrjeje efikase dhe konkrete të bashkëshortëve si punëtorë baritorë, është e

¹⁰¹ Krh. *Amoris laetitia*, 87.

¹⁰² Krh. *Amoris laetitia*, 88; 324.

domosdoshme të kuptohet lidhja e përplotësimit dhe e bashkëpërgjegjësisë kishtarë që ekziston midis *ordo sacerdotalis* dhe *ordo conjugatorum*, për të hapur veprimin e meshtarëve ndaj një bashkëpunimi më të madh me laikët dhe familjet, duke u njohur atyre role baritore domethënëse në famulli dhe në nivel dioqezan. Shpesh, çka mungon në shumë realitete vendore është pikërisht mundësia që bashkëshortët të kenë hapësirë për të vepruar në baritore, si bashkëshortë. Në të vërtetë, nuk ka dyshim se për të shprehur karakterin misionar të baritores së martesës, krahas shoqërimit specifik të barinjve, nevojitet dëshmia e familjeve dhe bashkëshortëve: në këtë kuptim, nuk është mirë të ndahet *ecclesia docens* [kisha që mëson] nga *ecclesia discens* [kisha që nxë], pikërisht në sajë të përvojës së pasur dhe konkrete të jetës martesore dhe familjare që zotërojnë bashkëshortët.

Shoqërimi i çifteve “në krizë”

87. Në historinë e çdo martese mund të ketë momente kur bashkimi bashkëshortor zbehet dhe bashkëshortët e gjejnë veten duke përjetuar periudha, ndonjëherë edhe të gjata, vuajtjesh, lodhjesh e keqkuptimesh, duke kaluar “kriza” të mirëfillta martesore. Ato janë pjesë e historisë së familjeve: janë faza të cilat, nëse kapërcehen, mund të ndihmojnë çiftin të jetë i lumtur «në një mënyrë të re, duke nisur nga mundësitë që hap një etapë e re», duke e bërë edhe më të pjekur «verën e bashkimit».¹⁰³

Mirëpo, për të shmangur përkeqësimin e situatës së krizës deri në atë pikë sa të bëhet e parikuperueshme, është e udhës që famullia ose bashkësia të ketë në gjirin e vet një shërbim baritor për të shoqëruar çiftet në krizë, tek i cili mund të drejtohen ata që mendojnë se janë në këtë situatë të veçantë; «një shërbesë kushtuar atyre të cilëve marrëdhënia martesore u është thyer, duket veçanërisht urgjente».¹⁰⁴ Parandalimi i thyerjeve të marrëdhënieve, në të vërtetë, është një faktor vendimtar sot për të shmangur ndarje, të cilat mund të përkeqësojnë dhe dëmtojnë lidhjen në mënyrë të pariparueshme.

88. Meqenëse përvoja tregon se «në situata të vështira ose kritike shumica [e njerëzve] nuk i drejtohen shoqërimit baritor, sepse nuk e ndiejnë mirëkuptues, të afërt, realist, të mishëruar»,¹⁰⁵ është e përshtatshme që – përveç bariut – të jenë bashkëshortët, veçanërisht ata që kanë përjetuar dhe kapërcyer një krizë, të bëhen “shoqërues” për çiftet në vështirësi apo tashmë të ndarë. Do të jenë ata “bashkësia që shoqëron”, e cila mund të dëshmojë dhe të shfaqë se Samaritani i Mirë është Krishti i Ngjallur, i cili i ruan plagët në trupin e tij të lavdishëm dhe pikërisht për këtë ndjen dhembshuri për njeriun e lënduar, të braktisur përgjatë rrugës.¹⁰⁶ Çiftet në vështirësi.

¹⁰³ Krh. *Amoris laetitia*, 232. Rreth sfidave të krizave bashkëshortore, krh. nr. 232-240.

¹⁰⁴ *Amoris laetitia*, 238.

¹⁰⁵ *Amoris laetitia*, 234.

¹⁰⁶ Krh. FRANÇESKU, *Audiençë pjesëtarëve të Shoqatës “Retrouvaille”*, 6 nëntor 2021.

89. Me këtë qëllim, bëhet urgjente edhe përpilimi i planeve të formimit të çifteve që do të shoqërojnë si ata që janë në krizë, ashtu edhe të ndarët, për të krijuar kushtet për një shërbim baritor që u përgjigjet nevojave të familjeve. Vëmendja duhet të jetë e dyfishtë: për bashkëshortët në vështirësi, por edhe për fëmijët, kur janë të pranishëm, të cilët duhet të shoqërohen me një dialog psikologjik dhe shpirtëror, të aftë për të kuptuar dhe mbështetur shqetësimet e tyre personale dhe familjare.

Në këtë kontekst, rikthehet rëndësia e baritores së lidhjes, e cila që në vitet e para të jetës martesore duhet të shoqërojë bashkëshortët e rinj në fazat e ndryshme të jetës së tyre së bashku. Krizat, në të vërtetë, që janë pjesë e ecjes, duhet të shndërrohen në mundësi, ndonjëherë të dhimbshme, të cilat edhe pse krijojnë plagë në zemër e në mish, i lënë hapësirë pajtimit, faljes dhe veprimit të hirit, i cili vazhdon të veprojë në lidhjen sakramentale.

90. Ekzistojnë kriza të zakonshme, që ndodhin në të gjitha martesat, të cilat shënjojnë disa etapa të jetës familjare (ardhja e fëmijës së parë, edukimi i fëmijëve, “foleja bosh”, pleqëria e prindërve); por ka edhe kriza personale, të lidhura me vështirësitë ekonomike, të punës, emocionale, sociale, shpirtërore, ose me rrethana dhe ngjarje traumatike dhe të papritura.¹⁰⁷ Në të gjitha këto raste, «arti i mundimshëm i pajtimit, që kërkon mbështetjen e hirit, ka nevojë për bashkëpunimin bujar të të afërmeve dhe miqve, e ndonjëherë edhe të një ndihme të jashtme dhe profesionale».¹⁰⁸ Bëhet fjalë për të garantuar një shoqërim jo vetëm psikologjik, por edhe shpirtëror, për të rikuperuar, me një rrugëtim mistagogjik të personalizuar gradual dhe me sakramente, kuptimin e thellë të lidhjes [sakramentale] dhe ndërjegjësimin mbi praninë e Krishtit mes bashkëshortëve. Heshtja në zemër, thirrja e emrit të Jezu Krishtit dhe dëgjimi i zërit të Tij mund t’i ndihmojë të krijojnë kushtet që Ai ta ushqejë marrëdhënien e tyre, t’i ndihmojë në vështirësi, të ndalet dhe të pijë kupën e vuajtjes me ta, të qëndrojë përkrah tyre si udhëtari me dishepujt e Emausit (krh. *Lk* 24,13).

Praktikisht, bëhet fjalë për krijimin e hapësirave dhe rrugëtimeve të afta për t’i përudhur njerëzit te arti i dallimit në jetën e përditshme për t’i njohur në kohë situatat e vuajtjeve, rastet e rrezikut për t’u shmangur, papjekuritë dhe lëndimet që duhen tejkualuar. Nxitja që mund të kumbojë në zemrat e lodhura është «qëndroni në dashurinë time» (*Gjn* 15,9).

91. Ne sugjerojmë, si shembull, një zbatim të mundshëm praktik të parimeve të paraqitura, duke propozuar një itinerar për çiftet në krizë, të frymëzuar nga udhëtimi i Jezusit me dishepujt e Emausit (krh. *Lk* 24,13 dhe 35). Pasi ky shërbim t’i jetë bërë i njohur bashkësisë famullitare siç duhet, nëse një çift kërkon dhe pranon propozimin për një ecje të përbashkët shoqërimi, mund të provohen të alternohen takimet “individuale” (me një çift) dhe “takimet në grup” (duke përfshirë çifte të

¹⁰⁷ *Amoris laetitia*, 235-236.

¹⁰⁸ *Amoris laetitia*, 236.

ndryshme). Në përmbledhje, rrugëtimi mund të ndjekë ecjen e mëposhtme:

- «Vetë Jezusi u afrua dhe po ecte me ta» (Lk 24,15) – Takimi i parë (“individual”) i mirëpritjes dhe njohjes.

Është e përshtatshme që takimi i parë të zhvillohet në një kontekst mirëbesimi dhe afërsie personale, pra i kufizuar për një çift, i cili mirëpritet dhe dëgjohet nga një çift shoqëruesh dhe nga meshtari, të cilët janë të aftë për të treguar ndjeshmëri, dashuri dhe gatishmëri të plotë mbështetjeje. Pas këtij takimi të parë vetëm “dëgjimi”, do të ndjekin të tjerë që do të nisin rrugëtimin e mirëfilltë të shoqërimit.

- «Ç’janë këto fjalë që ju po i flisni me jush udhës?» (Lk 24,17) – Disa takime (“individuale”) ku bashkëshortët t’ia thonë Hyjit dhe partnerit të vet përse-në e “trishtimit” të tyre (Lk 24,17).

Të gjitha takimet të zhvillohen gjithmonë në një atmosferë lutjeje, pasi bëhet fjalë për një ecje shpirtërore dhe jo seanca “terapie në çift” të tipit thjesht psikologjik. Çifti, pra, duke u vënë në praninë e Hyjit, do të udhëhiqet për të “hapur zemrat”, derisa secili prej dy bashkëshortëve të dijë “çfarë e bën tjetrin të vuajë”. Shoqërueshit do ta orientojnë këtë “hapje të zemrës” në mënyrë që të mos kufizohet thjesht në një shkëmbim akuzash. Kësisoj, pyetjet për t’u përgjigjur nuk do të jenë «Cilat janë gabimet tuaja?», «Çfarë duhet të ndryshoni?», etj., por më tepër: «Cila është vuajtja që mbaj përbrenda?»; «Çfarë shqetësimi përjetoj?», «Çfarë më lëndon në mënyrën se si po e jetojmë marrëdhënien tonë?». Në të vërtetë, nuk janë të rralla rastet kur çifteve u mungon komunikimi dhe dialogu për t’ia bërë të njohur njëri-tjetrit gjendjen shpirtërore dhe këndvështrimin e vet.

- «O të pamend e të ngadalshëm që të besoni gjithçka paralajmëruan profetët! Po a nuk u desh që Mesia t’i pësojë të gjitha e kështu të hyjë në lavdinë e vet?» (Lk 24,25-26) – Takime (“të zgjeruara”) me çifte të ndryshme për “të ndriçuar” krizat.

Takimet individuale, me secilin çift, mund të pasohen me takime në grup, gjatë të cilave njëri nga çiftet shoqëruesh mund të tregojë përvojën e vet dhe krizat që ka përjetuar, duke nxjerrë në pah “gjërat e reja”, që janë përvetësuar në momentet e vështirësisë dhe sprovës së martesës. Mund të jepet edhe një mësim i shkurtër me leximin dhe komentimin e pjesëve të përshtatshme të zgjedhura nga *Amoris laetitia*, ose të pjesëve të shkëputura nga shkrimet e bashkëshortëve shenjtër që kanë kaluar momente të vështira sprovash bashkëshortore. Qëllimi është të vihet në dukje se “krizat”, nëse pranohen, kuptohen, jetojnë së bashku dhe përballohen me ndihmën e Zotit, mund të rezultojnë momente hiri dhe rritjeje për çiftin. Krizat, në fund të fundit, nuk janë “anomali”, por ngjarje “normale” të jetës martesore. Madje edhe krizat për shkak të brishtësisë dhe mëkateve personale. Edhe ato mund të bëhen “vuajtjet e Krishtit”, i pranishëm mes bashkëshortëve, i cili lëndohet nga mëkatet e tyre dhe vuan me ta, duke hyrë me ta në lavdinë (krh. Lk 24,26) e një marrëdhënieje të shëruar e të “shëlbuar”. Në këto takime, siç është nënvizuar tashmë në itinerarin katekumenal të martesës, nuk duhet të mungojë kumtimi *kerigmatik*: Zoti është i pranishëm dhe i gjallë! Së bashku me Të, edhe “vdekja” e një krize mund të shndërrohet në një ngjallje për një jetë të re!

- «E që nga Moisiu e të gjithë profetët, u shtjelloi krejt çka flitet në Shkrimin Shenjt për të» (Lk 24,27) – Takime (“në grup që kanë në qendër Shkrimin e Shenjtë.

- Takimet e mëparshme të “katekezës” mund të pasohen nga takime të tjera në grup në të cilat kremtohet së bashku një Liturgji e Fjalës: shpallet një pjesë e shkëputur nga Bibla, e ndjekur nga një kohë meditimi dhe një kohë bashkëndarjeje, e drejtuar nga disa pyetje, duke përfunduar me një reflektim të fundit që parashtrohet nga shoqëruesit. Do të tregohet kujdes për të zgjedhur tekste biblike në lidhje me temat, si: afërsia e Hyjit në sprova, falja e marrë nga Hyji dhe e dhuruar, hiri që vepron në dobësi, bashkimi i zemrave fryt i Shpirtit Shenjt, thirrja për në shenjtëri, sakramenti i Martesës, etj.

- «Rri me ne se u bë natë e dita po shkon në të sosur» (Lk 24,29) – Adhurimi eukaristik dhe sakramenti i Pajtimit.

Çifteve që po ndjekin ecjen mund t’u propozohet një “mbrëmje eukaristike” (ose edhe më shumë se një). Pas takimeve të ndryshme që kanë ndriçuar krizat e ndryshme që po përjetohej, shpesh e gjejnë veten të pafuqishëm për t’i kapërcyer ato. Vështirësitë duken se shkojnë përtej forcave të tyre. Ky mund të jetë momenti për ta sjellë krizën në praninë e Zotit të pranishëm në të Shenjtërueshmin Sakrament, për t’ia “paraqitur” dhe “vënë” te këmbët e tij, që Ai të lyejë plagët dhe të shërojë zemrat. Kjo paraqitje e krizës para Zotit mund të përjetohej nëpërmjet një gjesti konkret të çiftit përballë Sakramentit Tejet të Shenjtë (vendosja e një objekti, një simboli), gjatë një çasti të thjeshtë liturgjik.

Një mënyrë tjetër me të cilën çiftet mund ta jetojnë përvojën e Zotit që “qëndron me ne” është një kremtim pendestar. Është shumë e rëndësishme që, në momentet e krizës, t’i afrohemi sakramentit të Pajtimit. Asgjë nuk ndihmon më shumë në shërimin e plagëve dhe faljen e bashkëshortit/es sesa falja e marrë nga Zoti. Sakramenti pastaj zbraz në shpirt hire të veçanta pajtimi: pajtim me Hyjin, me veten dhe me të kaluarën përkatëse, me të afërmin. E gjithë kjo ndihmon për të shëruar përçarjet dhe largimin “e brendshëm” mes bashkëshortëve, me balsamin e pajtimit dhe të faljes.

- «Mori bukën, u falënderua, e theu dhe ua dha» (Lk 24,30) – Kremtimi eukaristik.

Çifteve mund t’iu propozohen një ose më shumë kremtime eukaristike për t’i ndihmuar që të përjetojnë se si Jezusi është i gjallë dhe i pranishëm edhe në mes të krizës. Është Ai që bëhet çdo herë “bukë e thyer për ne”, i cili ka përjetuar vuajtjen e mospranimit dhe keqkuptimit, dhe e ktheu në mundësi për të dashur dhe për t’u dhuruar për të gjithë. Ky është hiri që edhe çiftet mund të marrin: të mos qëndrojnë të mbyllur në vuajtjen e tyre, por ta shndërrojnë atë në mundësi për t’u rritur në dashuri dhe për ripërtëritjen e dhurimit të ndërsjellë.

- «Atëherë iu hapën sytë dhe e njohën. [...] U çuan menjëherë, u kthyen në Jerusalem» (Lk 24, 31-33) – Përmbyllja e rrugëtimit.

Çifteve mund t’iu propozohen edhe momente çlodhëse dhe festimi së bashku. Edhe në kriza nuk duhet ta humbasim kurrë shpresën dhe nuk duhet t’i dorëzohemi

një këndvështrimi negativ të jetës. Mbi të gjitha, zbulimi i pranisë së vëllezërve në fe të cilët na gjenden pranë dhe na mbështesin, mund të ringjallë besimin dhe gëzimin në zemër.

Takimet përmyllëse të rrugëtimit mund t'i ndihmojnë çiftet që të "rikthehen në Jerusalem", domethënë të vazhdojnë jetën martesore me një urti të re të fituar përmes krizës, duke shfrytëzuar çka u mësua dhe duke u bërë edhe dëshmitarë për çiftet e tjera për çka u përjetua dhe për takimin e tyre me Jezusin e gjallë.

Nuk bëhet fjalë, pra, për një përshëndetje përfundimtare. Jeta paraqet gjithnjë sfida të reja dhe krizat mund të mos kapërcehen plotësisht. Është mirë, prandaj, që shoqëruesit t'ua sigurojnë çifteve gatishmërinë e tyre të vazhdueshme për t'i mirëpritur, dëgjuar dhe mbështetur edhe në të ardhmen. Aty ku është krijuar një klimë mirëbesimi, çiftet mund të vazhdojnë të kenë dikë të cilit mund t'i drejtohen në rast nevojë. Shoqëruesit duhet t'i bëjnë çiftet të ndiejnë se Kisha është gjithmonë aty për ta, si një nënë që është gjithmonë e gatshme të mirëpresë bijtë e vet.

Është me dobi të përsëritet se, gjatë gjithë kohëzgjatjes së rrugëtimit, përveç takimeve në grup, mund të jetë e nevojshme të vazhdohet me mbajtjen e takimeve individuale me secilin çift. Nëse, në të vërtetë, është ndihmë dhe inkurajim i madh të dëgjosh përvojat e të tjerëve – siç mund të ndodhë në momentet e bashkëndarjeve – në raste të tjera çiftet mund të ndiejnë nevojën për një përballje më personale dhe më mirëbesuese në mënyrë që të ndihen të lirë të flasin për vështirësitë e tyre.

92. Modeli i propozuar deri tani është vetëm një shembull për të treguar se si edhe ky rrugëtim shoqërimi i çifteve në krizë mund të rigjurmohet stilin e itinerarit katekumenal në përgatitjen për martesën që u përshkrua më sipër. Edhe në këtë rast, metodologjia nuk duhet të kufizohet në propozimin e "konferencave" dhe përcimin e nocioneve, por duhet të bëjë të mundur një përvojë të afërsisë njerëzore dhe shpirtërore, me përfshirjen e bashkësisë së krishterë, duke alternuar momente thellimi të fesë dhe momente takimi, lutjeje, dëgjimi, bashkëndarjeje, me gjeeste rituale, kremtimi të sakramenteve, të shënuara nga etapa progresive rritjeje, duke ftuar për të bërë dallim, duke bërë të pranishëm një kumtim *kerigmatik*, etj. Secila Kishë vendore, pra, mund të përpunojë rrugëtimin e vet, me metodat e veta të zhvillimit ose duke u frymëzuar nga të tjera "modele biblike", përkundrejt atij që u propozua këtu: për shembull, takimi i samaritanit me njeriun e plagosur (*Lk 10,25-37*), djali i humbur që kthehet tek i ati (*Lk 15,11-32*), vera e shteruar që bëhet sërish e bollshme gjatë dasmës në Kanë (*Gjn 2,1-12*), takimi i samaritanes me Jezusin dhe zbulimi i një uji të ri që shuan çdo etje (*Gjn 4,1-43*), etj.

93. Pavarësisht mbështetjes që Kisha mund t'iu ofrojë çifteve në krizë, sidoqoftë ka situata në të cilat ndarja është e pashmangshme. «Ndonjëherë mund të bëhet edhe moralisht e nevojshme, kur është fjala pikërisht për të shpëtuar bashkëshortin më të dobët, apo fëmijët e vegjël, nga plagët më të rënda të shkaktuara nga arroganca dhe dhuna, nga poshtërimet dhe shfrytëzimi, nga të qenurit i huaj dhe indiferenca». Në çdo rast, «duhet të çmohet si një zgjidhje ekstreme, pasi të gjitha

përpyjekjet e tjera të arsyeshme të kenë rezultuar të kota».¹⁰⁹

Në këto raste, «një dallim i veçantë është i domosdoshëm për të shoqëruar në mënyrë baritore [edhe] të ndarët, të divorcuarit, të braktisurit. Mbi të gjitha duhet mirëpritur dhe vlerësuar vuajtja e atyre që kanë pësuar padrejtësisht ndarjen, divorcin apo braktisjen, apo janë detyruar prej keqtrajtimit të bashkëshortit/es të prishin bashkëjetesën. Falja e padrejtësisë së pësuar nuk është e lehtë, por është një ecje që hiri e bën të mundur. Prej këtej lind nevoja për një baritore të pajtimit dhe ndërmjetësimit edhe nëpërmjet qendrave të specializuara të dëgjimit që duhet të krijohen në dioqeza».¹¹⁰

94. Në të njëjtën kohë, «personat e divorcuar, jo të rimartuar, që shpesh janë dëshmitarë të besnikërisë martesore, duhet të nxiten që të gjejnë në Eukaristi ushqimin që i mbështet në gjendjen e tyre. Bashkësia vendore dhe Barinjtë duhet t'i shoqërojnë këta persona me kujdes, sidomos kur kanë fëmijë».¹¹¹ Janë të pakta vendet ku u kushtohet atyre vëmendje baritore. Situata e tyre e veçantë, e ushqyer nga dhurata e besnikërisë ndaj sakramentit të Martesës, nga ana tjetër, mund të jetë dëshmi dhe shembull për çiftet e reja, por edhe për meshtarët, të cilët mund të zbulojnë dhe të "shohin" në jetën e këtyre njerëzve praninë e vazhdueshme të Krishtit Dhëndër, besnik edhe në vetmi dhe braktisje: një vetmi e "banuar", e karakterizuar nga intimiteti me Zotin dhe nga lidhja me Kishën dhe bashkësinë, që bëhet e pranishme dhe shok/qe udhëtimi. Dimensionin martesor i dy thirrjeve – Urdhri shenjti dhe Martesa – dëftohet në këto raste, edhe një herë, me gjithë bukurinë dhe përplotësinë e vet. Në këtë kuptim, është gjithashtu e nevojshme të zbulohet brenda Kishës protagonizmi baritor i besimtarëve të ndarë, të cilët mund të luajnë role të rëndësishme në bashkësi dhe të jenë ndihmë për të tjerët.

¹⁰⁹ *Amoris laetitia*, 241.

¹¹⁰ *Amoris laetitia*, 242.

¹¹¹ *Ibid.*

PËRFUNDIMI

“Udhëzimet baritore” të propozuara këtu, duke qenë të vetëdijshëm se nuk janë shteruese, synojnë të jenë ndihmë dhe stimul për dioqezat/eparkitë dhe famullitë në përpunimin e “itinerareve katekumenale të jetës martesore” përkatëse, sipas sugjerimeve të Atit të Shenjtë Françeskut. Prandaj është e dobishme, si përfundim, të rikujtojmë disa linja baritore që kanë frymëzuar shtrirjen e këtij dokumenti dhe që duhet të jenë edhe baza e dokumenteve analoge për t’u zbatuar në Kishat vendore.

Në origjinën e këtij dokumenti qëndron, para së gjithash, dëshira për t’iu ofruar çifteve një përgatitje më të mirë dhe më të thelluar për martesën, me anë të një itinerari, mjaftueshëm të gjerë, të frymëzuar nga katekumenati pagëzimor, i cili u lejon atyre të marrin formimin e duhur për jetën bashkëshortore të krishterë duke u nisur nga një përvojë feje dhe takimi me Jezusin; që nuk kufizohet, pra, në pak takime në prag të kremtimit, por që bën të perceptohet karakteri pothuajse “i përhershëm” i baritores së jetës bashkëshortore që Kisha synon të çojë përpara.

E gjithë bashkësia kishtare duhet të përfshihet në detyrën e shoqërimit të çifteve në një ecje të bashkëndarë, mes meshtarëve, bashkëshortëve të krishterë dhe punëtorëve baritorë, që shoh si protagonistë mbi të gjitha çiftet e martuara – të ndryshme në moshë dhe vite të jetës martesore – që e vënë përvojën e tyre në shërbim të atyre që marrin pjesë në itinerarin katekumenal. Me këtë qëllim, është e nevojshme një punë formimi dhe përditësimi, që u drejtohet të gjithëve, por veçanërisht presbiterëve, në mënyrë që të perceptohet përplotësia dhe bashkëpërgjegjësia e domosdoshme e laikëve dhe e meshtarëve/rregulltarëve në shërbimin baritor familjar.

Një itinerar martesor i tipit katekumenal duhet të çmohet si një “mjet baritor” që duhet përdorur me dallim, urti dhe me gjykimin e shëndoshë të nevojshëm, në mënyrë që të përshtatet me fleksibilitet – për sa i përket mënyrave dhe kohëve të zbatimit – me situatat konkrete të çifteve që kanë përballë dhe mbi bazën e mundësive konkrete të punëtorëve baritorë të Kishës vendore.

Itinerari nuk kufizohet vetëm në komunikimin e përmbajtjeve doktrimore dhe synon të shkojë përtej tipologjisë klasike të “kurseve martesore”; për këtë arsye përdor jo vetëm metodën e katekezës, por edhe bashkëbisedimet me çiftet, takimet e individualizuara, momentet liturgjike të lutjes dhe kremtimit të sakramenteve, ritet, përballjen mes vetë çifteve që marrin pjesë në itinerar, ndërhyrjen e ekspertëve të jashtëm, tërheqjet shpirtërore, ndërveprimin me krejt bashkësinë kishtare që mbështet dhe merr pjesë në procesin e gjatë të përgatitjes së çifteve.

Itinerari ruan gjithmonë, gjatë gjithë kohëzgjatjes së vet, një karakter *kerigmatik*; pothuajse në çdo fazë të re, rikthehet, si “me valë të njëpasnjëshme”, te shpallja e parë e fesë dhe vetë sakramenti i Martesës paraqitet si “lajm i mirë”, domethënë si një dhuratë e Hyjit për çiftet që dëshirojnë të jetojnë në plotësi dashurinë e tyre.

Në çdo fazë të itinerarit, mbahen gjithmonë së bashku rrugëtimi i rritjes njerëzore (formimi i një personaliteti harmonik dhe i qëndrueshëm, tejkalimi i papjekurisë, i

mbylljeve dhe frikës, dinamikat e marrëdhënieve të përgjithshme dhe në çift, aftësitë e komunikimit dhe dialogut, etj.) dhe rrugëtimi i rritjes shpirtërore (pranimi i dashurisë së Hyjit, kthimi personal dhe tejkalimi i limiteve morale, jeta e lutjes, kuptimi i dimensionit konstitutiv bashkësior dhe kishtar të fesë, frekuentimi i sakramenteve, etj.).

Itinerari katekumenal i të rinjve dhe i çifteve dëshiron të futet në realitetin aktual konkret dhe nuk ka frikë të trajtojë tema dhe çështje që paraqesin sfida sociale dhe kulturore: edukimi në dashurinë autentike që nuk kufizohet në përvojat e brishta emocionale, njohja e pasurisë dhe e përplotësimit të natyrës mashkullore dhe femërore, edukimi ndaj afektivitetit dhe seksualitetit, vlera e zgjedhjeve përfundimtare, vlera njerëzore, shpirtërore dhe sociale e familjes, çështjet bioetike, etj. Në këtë mënyrë bashkëpunon për në formimin e një ndërgjegjeje morale personale dhe në formulimin e një plani të jetës familjare.

Fazat e rritjes që propozon itinerari shënjohe nga rituale – aty ku për arsye kulturore nuk është e papërshtatshme apo problematike propozimi i tyre për shkak të interpretimit të paqartë që mund t’u jepet këtyre rritjeve – të cilat shënojnë ecjen që po përshkohet; dhe që përcjellin vetëdijen psikologjike se gjenden çdo herë në një pikë kthese që thërret për të hedhur një hap të ri përpara, në nivelin e pjekurisë njerëzore e shpirtërore dhe në atë vendimmarrës, në funksion të qëllimit të jetës bashkëshortore të krishterë.

Itinerari ndahet në tri faza kryesore: faza e përgatitjes së hershme, e cila përfshin kujdesin baritor të fëmijëve dhe të rinjve; faza e ndërmjetme e pranimit; faza e mirëfilltë katekumenale, e cila prej anës së saj parashikon tri etapa të dalluara. Një etapë e parë e përgatitjes së afërt, më e gjatë, me kohëzgjatje të ndryshueshme; një etapë e dytë e përgatitjes së menjëhershme, më e shkurtër, dhe një etapë e tretë e shoqërimit të çifteve në vitet e para të jetës martesore, e cila përmbyllet me përfshirjen e çiftit në baritoren e zakonshme familjare të famullisë dhe dioqezës/eparkisë.

Itinerari synon të ndërthurë, që nga fëmijëria, zbulimin e fesë së krishterë dhe hyrjen në sakramente në zbulimin e thirrjes martesore ose meshtarake/rregulltare.

Megjithatë, prania tashmë e përhapur e çifteve që bashkëjetojnë e që kanë fëmijë, të cilat kërkojnë të martohen në Kishë, kërkon, paralelisht me baritoren thirrrore evolutive që propozohet këtu, prekjen e rrugëtimeve vendore të përqendruara në realitetin konkret të këtyre çifteve, të cilat pa dyshim që kanë nevojë për kujdes të veçantë dhe vëmendje krahasuar me çiftet e fejuara që në një farë mënyre tashmë jetojnë një përvojë jete të krishterë.

Duke u nisur nga përvoja e një shoqërimi baritor të personalizuar, bazuar mbi të gjitha në dëshminë e shoqëruesve dhe çifteve të tjera të martuara të përfshirë në rrugëtim, synimi, në çdo rast, është që të çohen drejt një dallimi serioz personal dhe në çift, në mënyrë që krenimi i martesës dhe jeta martesore të jetë fryt i një vendimi të vetëdijshëm, të lirë dhe të përqaftuar me gëzim, dhe jo thjesht përshtatje pasive me një traditë kulturore apo me një formalitet shoqëror.

Itinerari, ndërkohë që përgatit çiftet për sakramentin e Martesës, i përuddh njëkohësisht për në jetën kishtare dhe i ndihmon që të gjejnë në Kishë vendin ku mund të ushqejnë, veçanërisht nëpërmjet sakramenteve, lidhjen martesore; dhe ku të vazhdojnë të rriten gjatë gjithë jetës në thirrjen dhe shërbimin ndaj të tjerëve, duke arritur kështu në zhvillimin e plotë të identitetit të tyre bashkëshortor dhe të misionit kishtar.

Një vëmendje e veçantë, pastaj, do t'i kushtohet shoqërimit të çifteve të martuara që po përjetojnë krizë. Njëmend, ekziston si nevojë urgjente përgatitja e një shërbimi baritor, në çdo realitet vendor, që u kushtohet atyre, marrëdhënia martesore e të cilëve është prishur ose është në vështirësi të madhe, edhe me mbështetjen e një baritoreje të pajtimit dhe ndërmjetësimit për të ruajtur lidhjen dhe për të parandaluar, ku është e mundur, ndarjen.

Sado që ndërmarrja për të nisur një rrugëtim formues kaq afatgjatë mund të duket e përealizueshme, i nxisim Kishat vendore që të kenë guxim dhe të kenë një qëndrim të drejtë feje, duke e ditur se, siç na mëson Jezusi, veprat e Mbretërisë fillojnë gjithmonë si një farë e vogël sinapi, por me kalimin e kohës mund të bëhen një pemë e madhe që ofron strehë dhe mbrojtje për ata që janë në kërkim dhe në nevojë. Duke u vënë në dispozicion brezave të rinj rrugëtime rritjeje të tipit katekumenal në funksion të martesës, i dalim para njëres prej nevojave më urgjente të Kishës sot, përkatësisht nevojës për t'i shoqëruar të rinjtë drejt realizimit të plotë të asaj që mbetet ende një nga "ëndrrat e tyre" më të mëdha dhe mes objektivave kryesorë që synojnë të arrijnë në jetë: të krijojnë një marrëdhënie të qëndrueshme me personin e dashur dhe mbi këtë marrëdhënie të ndërtojnë një familje.

Ia besojmë këtë vepër ndërmjetësimit të Shën Jozefit, Fatit të Virgjërës dhe Mbrojtësit të Shëlbuesit, dhe Marisë Tejet të Shenjtë, Nënës së Jezusit dhe Nënës së Kishës, që të rrënjosin në ne dashurinë për të gjitha familjet e botës dhe zellin e pashtershëm për të punuar në shërbimin e tyre.

TREGUESI

Paraqitje	3
Parathënie e Atit të Shenjtë Françeskut	5
Propozimi i Atit të Shenjtë Françeskut për një “katekumenat martesor”	8
I. TREGUES TË PËRGJITHSHËM	10
Përse një katekumenat	10
Kujt i takon kjo detyrë	11
Për një baritore të përtërirë të jetës bashkëshortore	14
II. NJË PROPOZIM KONKRET	16
Modaliteti	16
Faza dhe etapa	19
Dy saktësime	19
A. Faza para-katekumenale: përgatitja e hershme	20
B. Faza e ndërmjetme: pranimi i kandidatëve	24
C. Faza katekumenale	29
Etapa e parë: përgatitja e afërt	30
Etapa e dytë: përgatitja e menjëhershme	37
Etapa e tretë: shoqërimi në vitet e para të martesës.....	42
PËRFUNDIMI	55